

TABELA E PËRMBAJTJES

Hapat për marrjen e shërbimeve	3
Përgjigje për pyetjet e bëra shpesh	
Kërkesa për ndihmë.....	10
Rekomandimi.....	10
Njoftime	11
Prindërit zëvendësues	12
Miratimi	12
Vlerësimi	15
Rivlerësimi	17
Vlerësimi i pavarur edukativ	18
Programi edukativ i individualizuar (IEP).....	20
Shërbimet e vitit shkollor të zgjatur	25
Transferimi i nxënësit	25
Tranzicioni	26
Dokumentacioni	29
Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve	31
Ndërmjetësimi	33
Arbitrimi i IEP-së.....	35
Procedurat e ankesave.....	35
Procesi i rregullt ligjor	39
Disiplina	50
Shkollat jopublike	57
Shtojcë	
Përkufizime	60
Përkufizimet e termave të paaftësisë	67
Formularët e bashkëngjitur	70
Kërkesa e drejtpërdrejtë për ndërmjetësim	
Formulari i ankesave	
Ankesa e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor	
Tërheqje nga kërkesa dhe/ose procesi i rregullt ligjor	

SHËNIM: Ky udhëzues për prindërit përmbledh rregullat shtetërore të edukimit special në kapitullin 3301-51 të kodit administrativ, *Standardet vepruese për agjencitë edukative të shtetit Ohio, të cilat u shërbejnë fëmijëve me paaftësi*. Ky udhëzues nuk i përfshin të gjitha klauzolat e rregullave dhe nuk siguron këshillë ligjore ose interpretim ligjor të rregullave. Referojuni standardeve vepruese që janë shënuar në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio (Ohio Department of Education – ODE), www.ode.state.oh.us, kërkimi me fjalët kyçe: *Operating Standards Disabilities (standardet vepruese, paaftësi)* për rregullat e plota. Gjithashtu konsultohuni me avokatin tuaj për këshillë ligjore ose interpretime ligjore. Standardet vepruese bazohen në ligjin shtetëror (kapitulli 3323 i kodit të ripunuar), në ligjin federal (Ligji i vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi) dhe rregullat federale (34 Kodi i rregullave federale (Code of Federal Regulations - C.F.R.) Pjesa 300) për edukimin e fëmijëve me paaftësi. Këto burime ndihmëse janë shënuar gjithashtu në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio (ODE).

PARATHËNIE

Nëse jeni prind i një fëmije që ka paaftësi, e cila pengon edukimin e tij apo të saj, ose nëse dyshohet se fëmija juaj ka një paaftësi të tillë, ky manual do të shërbejë si burim i vlefshëm për edukimin e fëmijës suaj.

Edicioni i 2008-ës i manualit “E kujt është kjo IDEA?” përmbledh gjuhën e ligjit të vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (Individuals with Disabilities Education Improvement Act of 2004 - IDEA) në pika kryesore, të cilat do t’ju ndihmojnë për t’u bërë një partner efektiv në edukimin e fëmijës suaj. Ky udhëzues është përgatitur nga Zyra për Fëmijët e Veçantë e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio (Ohio Department of Education’s Office for Exceptional Children - ODE/OEC).

Faqet e mëposhtme ju tregojnë se si mund të punoni me distriktin lokal të shkollës dhe agjenci të tjera publike për të përcaktuar nëse fëmija juaj ka ndonjë paaftësi. Ju tregohen gjithashtu hapat e mëtejshëm për të përcaktuar nëse kjo paaftësi e kualifikon fëmijën tuaj për edukim special dhe për shërbime përkatëse.

Gjithashtu, ky botim, i cili njihet gjithashtu si “njoftimi i masave mbrojtëse procedurale” ju jep të drejtën për një “edukim publik të përshtatshëm falas” (Free Appropriate Public Education - FAPE) për një fëmijë me paaftësi kualifikuese sipas ligjit të edukimit special. Aty tregohet se si sigurohen shërbimet e edukimit special dhe gjithashtu shënohen burimet e ndihmës që mund të kontaktoni për ndihmë.

Meqenëse të drejtat dhe procedurat që përfshihen në këtë udhëzues u përvijuan në fillim me ligj federal, mund të shikoni terma ligjore që janë të reja për ju. Në mënyrë që informacioni të kuptohet dhe përdoret më lehtësisht, ne e kemi thjeshtësuar këtë gjuhë ligjore kudo ku ishte e mundur. Çfarëdolloj termash që vazhdojnë të përdoren shpjegohen plotësisht në pjesën e udhëzuesit që titullohet “Përkufizime” dhe kudo nëpër tekst ku është e mundur. Megjithatë, ndoshta do të dëshironit të kalonit disa minuta për t’u familjarizuar me këto terma, para se të filloni. Do t’i gjeni ato në pjesën “Përkufizime” që fillon në faqen 60.

ÇFARË NDODH NËSE FËMIJA IM KA VËSHIRËSI PËR TË MËSUAR NË SHKOLLË?

Ligji federal, të cilit zakonisht i referohemi si "IDEA" ka krijuar një proces për përcaktimin e nevojave edukative të fëmijës suaj dhe për marrjen e shërbimeve të edukimit special, nëse paaftësia e fëmijës suaj i kërkon ato. Më poshtë është përshkruar në vija të përgjithshme procesi dhe mënyra se si do të kryhet ai:

1. **Kërkesa për ndihmë** - Ky hap ju ndihmon që të filloni një marrëdhënie me distriktin e shkollës suaj, në mënyrë që së bashku të adresoni çdo shenjë paralajmëruese të hershme se fëmija juaj mund të ketë vështirësi në shkollë.
2. **Kërkesa për vlerësim** – Distriktet e shkollave kanë përvojë të madhe në përcaktimin se sa mirë mësojnë dhe funksionojnë fëmijët në shkollë. Për shkak të kësaj, ato mund të sjellin burime ndihmëse të vlefshme në detyrën e vlerësimit të fëmijës suaj.
3. **Vlerësimi** – Ky është hapi që lejon distriktin shkollor ta gjejë me saktësi nëse fëmija juaj ka ndonjë paaftësi që do të kërkojë shërbime të edukimit special (pasi jo të gjitha paaftësitë i kërkojnë ato). Vlerësimi do të sugjerojë se për çfarë lloje shërbimesh të edukimit special do të ketë nevojë fëmija juaj ose do të konfirmojë se fëmija juaj do të jetë në gjendje që të mësojë në klasën e edukimit të përgjithshëm me nxënësit e tjerë. Vlerësimi nuk është diçka që "i bëhet" fëmijës suaj nga ekspertë indiferentë. Ju do të jeni partner në procesin e vlerësimit dhe anëtar i ekipit të vlerësimit të fëmijës suaj.
4. **Krijimi i programit edukativ të individualizuar (Individualized Education Program - IEP)** – Nëse vlerësimi zbulon se fëmija juaj ka një paaftësi që kërkon edukim special, ky program i përshtatur do të synojë që të caktojë qëllime për të mësuarin e fëmijës suaj dhe do ta mbajë fëmijën tuaj brenda parametrave të duhur.
5. **Rishikimi vjetor** – Çdo vit distrikti i shkollave publike do të rishikojë se sa mirë po funksionon programi edukativ i individualizuar i fëmijës suaj dhe do të jetë i përgatitur që ta përshtatë planin për t'u siguruar që fëmija juaj po bën përparimin e duhur.
6. **Rivlerësimi** – Ligji IDEA siguron që fëmija juaj të vlerësohet përsëri çdo tre vjet për të zbuluar ndonjë ndryshim të rëndësishëm në aftësitë e tij apo të saj për të mësuar. Ky "rivlerësim" gjithashtu ju tregon juve dhe distriktit shkollor nëse ndihmat dhe shërbimet që po merr fëmija juaj janë ato që duhen. Më pas distrikti shkollor merr masat e duhura.
7. **Vlerësimi i pavarur edukativ (Independent educational evaluation - IEE)** – Nëse nuk jeni plotësisht i sigurt se vlerësimi i fëmijës suaj nga distrikti shkollor është i saktë, mund të organizoni një vlerësim të fëmijës suaj nga një profesionist i kualifikuar, i cili nuk është i punësuar nga distrikti shkollor. Në raste të caktuara, kjo mund të bëhet me shpenzimet e distriktit shkollor.

HAPAT PËR MARRJEN E SHËRBIMEVE

Tabelat e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje të shkurtër të shtatë hapave, të shënuar në faqen e mëparshme, për të marrë shërbime edukative për fëmijën tuaj me paaftësi. Do të gjeni më shumë informata të hollësishme në lidhje me shumicën e këtyre hapave në formë pyetje-përgjigje, në pjesën e mbetur të këtij udhëzuesi. Përgatituni që të merrni pjesë aktive në këtë proces duke bërë pyetje, duke dhënë informacion dhe duke ndihmuar në marrjen e vendimeve në lidhje me edukimin e fëmijës suaj.

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
KËRKESA PËR NDIHMË	<ul style="list-style-type: none"> * Kontakton mësuesin për të diskutuar ndonjë shqetësim se fëmija mund të ketë ndonjë paaftësi. * Jep informacion që mund të jetë i dobishëm në lidhje me fëmijën. * I kërkon ndihmë distriktit shkollor. * Ndhmon distriktin që të përcaktojë nëse fëmija ka ndonjë paaftësi. 	<ul style="list-style-type: none"> ★ Kontakton prindërit për informacion, nëse dyshon se fëmija ka ndonjë paaftësi. ★ Provon strategji të ndryshme mësimore për të ndihmuar fëmijën që të mësojë dhe dokumenton rezultatet. ★ Kontakton prindërit që të marrin pjesë në një mbledhje, për të vendosur nëse fëmija duhet të vlerësohet për shërbime të edukimit special. <input type="checkbox"/> Përdor një “ekip ndihmës të ndërhyrjes” për të sugjeruar metoda të reja mësimore dhe dokumenton rezultatet. (Shihni pjesën “Përkufizime” për <i>ekipin ndihmës të ndërhyrjes</i>).
KËRKESA PËR VLERËSIM	<ul style="list-style-type: none"> * Kërkon që fëmija të vlerësohet ose me gojë, ose me shkrim për atë paaftësi për të cilën dyshohet. Rekomandohet që kërkesa juaj për vlerësim të jetë me shkrim, në mënyrë që të jetë e dokumentuar se në ç’kohë janë dhënë përgjigjet e distriktit shkollor. * Kërkon informacion në lidhje me grupet përkrahëse për prindërit. * Jep miratim (leje) me shkrim që fëmija të vlerësohet. <i>Dhënia e miratimit do të thotë që jeni informuar plotësisht për të gjithë informacionin e nevojshëm në lidhje me vlerësimin e fëmijës suaj.</i> Kur jepni miratimin tuaj që fëmija të vlerësohet, ju nuk po jepni miratimin që distrikti shkollor të fillojë t’i sigurojë fëmijës suaj shërbime të edukimit special. 	<ul style="list-style-type: none"> ★ Fillon procesin e vlerësimit. ★ Kontakton prindërit, shpjegon procesin e kërkesës (rekomandimit) dhe ofron një kopje të “<i>E kujt është kjo IDEA?</i>” ★ U jep prindërve një kopje të një njoftimi të mëparshëm me shkrim. (Distrikti ua dërgon prindërve këtë njoftim para se të propozojë ndonjë veprim që ka lidhje me kualifikimin e fëmijës suaj ose marrjen e shërbimeve të edukimit special. Distrikti gjithashtu u dërgon prindërve formularin e njoftimit të mëparshëm me shkrim kur refuzon ndonjë veprim që ka lidhje me kualifikimin e fëmijës suaj ose marrjen e shërbimeve të edukimit special. (Shihni më shumë hollësi në pjesën “Njoftime”). ★ U kërkon prindërve miratim me shkrim që të vlerësojë fëmijën, nëse distrikti dyshon se fëmija ka ndonjë paaftësi. ★ Merr miratimin me shkrim të prindërve për vlerësim.
* Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	★ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
VLERËSIMI	<ul style="list-style-type: none"> * Merr pjesë në aktivitetet e ekipit të vlerësimit, të cilat përfshijnë përcaktimin nëse fëmija juaj i përmbush kushtet për shërbime të edukimit special. * Ofron informacion për procesin e vlerësimit (si p.sh. historinë mjekësore, familjare dhe edukative, si dhe pikëpamjen tuaj në lidhje me pikat e forta dhe nevojat e fëmijës). <p>Nëse përcaktohet që fëmija juaj nuk i plotëson kushtet për edukim special dhe shërbimet përkatëse dhe ju nuk bini dakord me këtë, atëherë ju mund:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Të kërkonti një “vlerësim të pavarur edukativ”. (Ky është një vlerësim që bëhet nga dikush që nuk është i punësuar nga distrikti shkollor. Për më shumë hollësi, shihni “Përkufizime”). * Të kërkonti një “seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor” (Kjo është një formë seance dëgjimore për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Për më shumë hollësi, shihni “Përkufizime”). 	<ul style="list-style-type: none"> ★ Kontakton prindërit që të marrin pjesë në procesin e vlerësimit. ★ Punon së bashku me prindërit për të krijuar një plan vlerësimi që do të përmbledhet në një raport të ekipit të vlerësimit. ★ U jep prindërve njoftimin paraprak me shkrim, i cili përfshin një përshtatje të vlerësimit të planifikuar. ★ Mbledh informacion në lidhje me fëmijën nga prindërit, mësuesit dhe të tjerë. ★ Përfundon vlerësimin brenda 60 ditëve nga marrja e miratimit të prindërve për vlerësim. ★ Drejton një mbledhje të ekipit të vlerësimit, ku janë ftuar prindërit. ★ Përmbledh dhe interpreton rezultatet e vlerësimit. ★ Përcakton përmbushjen e kushteve nga fëmija për shërbimet e edukimit special. Nëse fëmija juaj i përmbush kushtet, një program edukativ i individualizuar, IEP-ja do të përfundohet brenda 120 ditëve nga rekomandimi për vlerësim ose brenda 90 ditëve nga miratimi juaj i nënshkruar. Pjesëmarrësit e mbledhjes njihen si “ekipi i IEP-së” (shihni “Përkufizime”). ★ U jep prindërve një kopje të raportit të ekipit të vlerësimit brenda 14 ditëve nga mbledhja e ekipit të vlerësimit ose para mbledhjes së ekipit të programit edukativ të individualizuar, cilado të ndodhë më parë nga këto të dyja. <p>Nëse fëmija juaj nuk i plotëson kushtet për shërbime të edukimit special, atëherë distrikti shkollor:</p> <ul style="list-style-type: none"> ★ U jep prindërve një kopje të raportit të ekipit të vlerësimit. ★ Përcakton ndryshime dhe “ndërrhyrje” (mënyra ndihme) të tjera të përshtatshme për të ndihmuar fëmijën. ★ Konsideron nëse fëmija juaj i përmbush kushtet për shërbime sipas një ligji tjetër federal, paragrafi 504 i ligjit për rehabilitim i vitit 1973.
★ Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	★ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
PARA MBLEDHJES SË IEP-së	<ul style="list-style-type: none"> * Kërkon një kopje të sugjerimeve të distriktit për programin edukativ të individualizuar. * Nëse dëshirohet, i kërkon një anëtar të familjes, miku ose këshilltari të marrë pjesë në mbledhje me ju. * Nëse del nevoja, fton një ose më shumë persona që kanë ekspertizë ose njohuri të veçantë mbi fëmijën tuaj për të marrë pjesë në mbledhje me ju. * Përgatit me shkrim të gjitha shqetësimet, pyetjet ose sugjerimet në lidhje me programin edukativ të individualizuar dhe i shkëmben ato me distriktin shkollor para mbledhjes së IEP-së. 	<ul style="list-style-type: none"> ★ Njofton prindërit dhe/ose nxënësin në lidhje me mbledhjen e IEP-së dhe se kush do të marrë pjesë. (Shihni pjesën “Njoftime” për hollësi). ★ Përcakton kohën dhe vendin e mbledhjes për të cilën kanë rënë dakord të gjithë. <input type="checkbox"/> Përgatit dhe shkëmben paraprakisht me prindërit, me shkrim, të gjitha shqetësimet, pyetjet dhe sugjerimet për programin edukativ të individualizuar. ★ Fton fëmijën tuaj në mbledhjen e IEP-së atëherë kur është e përshtatshme dhe e fton gjithmonë kur diskutohet tranzicioni i fëmijës suaj nga shkolla e mesme. (Shihni “Përkufizime” për fjalën <i>tranzicion</i>).
* Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	★ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
GJATË MBLEDHJES SË IEP-së	<p>★ Merr pjesë në aktivitetet e mbledhjes së IEP-së, duke përfshirë:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Shkëmbimin e informacionit në lidhje me pikat e forta dhe nevojat e fëmijës suaj; ○ Ndhimën për të krijuar pikësynime vjetore dhe objektiva afatshkurtra; ose standarde që mund të maten; ○ Përcaktimin së bashku me distriktin shkollor të edukimit special të duhur dhe shërbimet përkatëse që do të marrë fëmija juaj. <p>★ Jep miratim që fëmija të marrë edukim special dhe shërbime përkatëse që e aftësojnë fëmijën të marrë pjesë dhe përparojë në programin e përgjithshëm mësimor (që do të thotë programin që ndjekin nxënësit e një klase të caktuar të studimit të përgjithshëm), ose nuk e jep këtë miratim.</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Nëse refuzoni që të miratoni <i>një</i> shërbim, distrikti nuk mund të mohojë përfitimin nga shërbime të tjera për fëmijën tuaj. ○ Nëse refuzoni miratimin për <i>të gjitha</i> shërbimet, distrikti nuk është i detyruar të sigurojë “edukim publik të përshtatshëm falas” (FAPE) dhe fëmija juaj nuk gëzon asnjëherë nga mbrojtjet e IDEA-s. (Shihni “Përkufizime”). 	<p>★ Së bashku me prindërit, rishikon rezultatet e vlerësimit dhe çështjen nëse fëmija juaj i përmbush kushtet apo jo.</p> <p>★ Nëse fëmija juaj i plotëson kushtet, krijon një program edukativ të individualizuar që përvijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> ○ Pikat e forta dhe nevojat e fëmijës suaj; ○ Pikësynimet vjetore të matshme dhe objektivat ose arritjet standardet matëse afatshkurtra; ○ Edukimin e duhur special dhe shërbimet përkatëse për fëmijën tuaj që do të përfshihen si dhe përparimin në programin mësimor të përgjithshëm; ○ Konsiderata të tjera në bazë të nevojave të fëmijës suaj. <p>★ U jep prindërve njoftimin paraprak me shkrim të qëllimit të distriktit shkollor për të siguruar shërbime të edukimit special. Nëse prindi refuzon që të miratojë <i>një</i> lloj shërbimi, distrikti nuk mund të mohojë përfitimin nga shërbime të tjera për fëmijën tuaj.</p> <p>★ U jep prindërve një kopje përfundimtare të programit edukativ të individualizuar jo më vonë se 30 ditë mbas mbledhjes së IEP-së.</p> <p>★ Siguron që programi edukativ i individualizuar i fëmijës suaj është i mundshëm për t’u përdorur nga çdo mësues i edukimit të rregullt, nga çdo mësues i edukimit special dhe çdo ofrues tjetër i shërbimit që ka përgjegjësi për të mësuar fëmijën tuaj.</p>
★ Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	★ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
RISHIKIMI VJETOR	<ul style="list-style-type: none"> ★ Kërkon një kopje të sugjerimeve të distriktit për programin edukativ të individualizuar. ★ Mbledh detyrat e shkollës së fëmijës dhe të gjitha informatat e tjera që mund të jenë të dobishme në mbledhje. ★ Sjell një ose më shumë persona përkrahës në mbledhje, nëse dëshirohet kjo gjë. ★ Rishikon programin e tanishëm edukativ të individualizuar. ★ Përgatit dhe ndan paraprakisht me distriktin shkollor, me shkrim, shqetësimet, pyetjet dhe sugjerimet për programin edukativ të individualizuar. <input type="checkbox"/> Jep leje me shkrim nëse fëmija juaj duhet të dërgohet në një vendndodhje të re për edukim special ose shërbime përkatëse. Leja juaj nuk është e detyrueshme nëse fëmija juaj po dërgohet diku tjetër meqë ai apo ajo po disiplinohet për thyerjen e rregullave të shkollës dhe dërgimi diku tjetër është pjesë e disiplinës së distriktit shkollor. 	<ul style="list-style-type: none"> ★ Kontakton prindërit për të marrë pjesë në rishikimin vjetor në të njëjtën mënyrë si mbledhja fillestare (e parë) e IEP-së. ★ Mbledh informacion mbi përparimin e fëmijës suaj. <input type="checkbox"/> Përgatit me shkrim dhe shkëmben paraprakisht me prindërit, shqetësimet, pyetjet dhe sugjerimet për programin edukativ të individualizuar. ★ Në mbledhje, rishikon programin e tanishëm edukativ të individualizuar dhe e ripunon atë, nëse është e përshtatshme. ★ Nëse, mbas mbledhjes së IEP-së, jo të gjithë bien dakord me gjithçka që është në programin edukativ të individualizuar, distrikti u jep prindërve një njoftim paraprak me shkrim në lidhje me rishikimin vjetor. ★ U jep prindërve një kopje përfundimtare të programit edukativ të individualizuar të fëmijës jo më vonë se 30 ditë mbas mbledhjes. ★ Siguron që programi edukativ i individualizuar i fëmijës suaj mund të përdoret nga çdo mësues i edukimit të rregullt, nga çdo mësues i edukimit special, nga ofruesi i shërbimeve përkatëse dhe nga çdo ofrues tjetër i shërbimit që ka përgjegjësi për të mësuar fëmijën tuaj.
★ Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	★ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
RIVLERËSIMI	<ul style="list-style-type: none"> * Merr pjesë në rishikimin e informacionit ekzistues për fëmijën tuaj. * Merr pjesë në procesin e rivlerësimit. * Mund të kërkojë vlerësim shtesë. Vlerësimi përbëhet nga aktivitete të fazave të ndryshme për të matur arritjet, përparimin, paaftësinë e fëmijës suaj ose përbushjen e kushteve. (Shihni “Përkufizime” për më shumë hollësi në lidhje me vlerësimet). * Jep miratim me shkrim ose nuk jep miratim për vlerësime të mëtejshme. * Ndhmon që të përcaktohet nëse fëmija vazhdon t’i përbushë kushtet për shërbimet e edukimit special. * Kërkon vlerësimin më shpejt se periudha kohore e zakonshme prej tri vitesh nëse ka ndonjë ndryshim në nevojat e fëmijës. 	<ul style="list-style-type: none"> ★ Fton prindërit që të marrin pjesë në procesin e rivlerësimit. ★ Shpjegon procesin e rivlerësimit, duke përfshirë të drejtën e prindërve për vlerësim shtesë, në mënyrë që të përcaktohet nëse fëmija vazhdon t’i përbushë kushtet. ★ U jep prindërve njoftim paraprak me shkrim për rivlerësimin e fëmijës. ★ Merr miratimin tuaj me shkrim për rivlerësim nëse vlerësimet shtesë janë të nevojshme, ose nëse ju i kërkon ato. ★ U jep prindërve informacion për anëtarët e personelit që do të kryejnë vlerësimin e fëmijës dhe të gjitha llojet e vlerësimit, nëse do të kryhet ndonjë, të cilat do të përdoren për rivlerësim. ★ Kryen një mbledhje të ekipit të IEP-së, ku janë ftuar prindërit. ★ U ofron prindërve mundësinë për të ndihmuar që të përcaktohet nëse fëmija vazhdon t’i përbushë kushtet për shërbimet e edukimit special dhe ato përkatëse. ★ U jep prindërve një kopje të raportit të ekipit të vlerësimit brenda 14 ditëve nga mbledhja e prindërve me distriktin e shkollës për të diskutuar raportin.
* Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	★ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

	PRINDI	DISTRIKTI SHKOLLOR
VLERËSIMI I PAVARUR EDUKATIV	<ul style="list-style-type: none"> * Informon shkollën për çdo gjë që nuk është dakord në lidhje me vlerësimin e distriktit. * Mund të kërkojë një listë të vlerësuesve të pavarur dhe të kriterëve (kërkesave) të distriktit shkollor për vlerësimet edukative të pavarura. Këto kërkesa përfshijnë gjëra të tilla si vendndodhja dhe kostoja e vlerësimit, si dhe trajnimi dhe kualifikimet e personit që bën vlerësimin. * Mund të bëjë një vlerësim edukativ të pavarur për fëmijën, përveç rastit kur distrikti shkollor paraqet ankesë të procesit të rregullt ligjor për të treguar se vlerësimi i vet është i përshtatshëm. Ankesa e procesit të rregullt ligjor është një ankesë që ka lidhje me kualifikimin e fëmijës për shërbimet e edukimit special ose me marrjen e shërbimeve të edukimit special. (Shihni "Përkufizime" për ankesën e procesit të rregullt ligjor dhe seancën dëgjimore). 	<ul style="list-style-type: none"> ☆ Informon prindërit për të drejtën e një vlerësimi edukativ të pavarur nëse prindërit nuk bien dakord me vlerësimin e distriktit shkollor. <input type="checkbox"/> Kërkon arsyen pse prindërit e kundërshtojnë vlerësimin e distriktit. (Nuk jeni i detyruar t'i përgjigjeni kësaj kërkesë.) ☆ Jep informacion se ku mund të bëhet vlerësimi edukativ i pavarur. ☆ Ofron vlerësimin edukativ të pavarur ose në vend të tij, u jep prindërve njoftim paraprak me shkrim. Ky njoftim i informon prindërit që distrikti po kërkon një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, pasi distrikti shkollor mendon se vlerësimi i vet është i saktë.
* Veprim i prindit	<input type="checkbox"/> Veprim i distriktit shkollor	☆ Kërkesë e detyrueshme e distriktit shkollor

PËRGJIGJE NDAJ PYETJEVE QË BËHEN SHPESH

KËRKESA PËR NDIHMË

Çfarë duhet të bëj nëse fëmija im ka vështirësi mësimore në shkollë?

Ju:

- Mund të kontaktoni mësuesin për të diskutuar shqetësimet tuaja dhe për të dhënë informacion që mund të jetë i dobishëm;
- Mund të kërkoni ndihmë; dhe
- Mund të merrni pjesë në një mbledhje që të ndihmoni për të përcaktuar nëse dyshohet se fëmija juaj ka ndonjë paaftësi.

Çfarë duhet të bëj nëse mësuesi raporton se fëmija im ka vështirësi mësimore në shkollë?

Distrikti shkollor:

- Mund t'ju kontaktojë për informacion;
- Mund të provojë strategji të ndryshme për të mësuar fëmijën tuaj dhe dokumenton rezultatet;
- Mund të përdorë një ekip ndihme të ndërhyrjes për të krijuar ide shtesë për të mësuar fëmijën tuaj dhe dokumenton rezultatet; dhe/ose
- Mund t'ju kontaktojë që të merrni pjesë në një mbledhje që të përcaktohet nëse dyshohet se fëmija juaj ka ndonjë paaftësi.

Sa herë që dyshoni se fëmija juaj ka ndonjë paaftësi, mund të kërkoni që fëmija të vlerësohet. Kjo kërkesë për vlerësim quhet "rekomandim".

Vlerësimi përmban mënyra të ndryshme për mbledhjen e informacionit se si po zhvillohet fëmija juaj dhe se si mëson e funksionon ai.

REKOMANDIMI

Kush mund të bëjë rekomandim (kërkesë për vlerësim)?

Nëse ju ose dikush tjetër mendoni se fëmija juaj mund të ketë ndonjë paaftësi dhe mund të ketë nevojë për shërbime të edukimit special apo përkatëse, atëherë rekomandimi për vlerësim mund të bëhet nga:

- Ju, prindi;
- Personeli shkollor; ose
- Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio ose nga ndonjë agjenci tjetër publike.

Nëse ju, prindi, bëni rekomandimin:

- Mund të kërkoni që fëmija juaj të vlerësohet ose me gojë ose me shkrim për atë paaftësi për të cilën dyshohet. Rekomandohet që kërkesa juaj për vlerësim të jetë me shkrim, në mënyrë që të jetë e dokumentuar se në ç'kohë janë dhënë përgjigjet nga distrikti shkollor.

Nëse personeli shkollor, Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio ose ndonjë agjenci tjetër publike bën rekomandimin:

- Dikush nga distrikti shkollor do t'ju kontaktojë.

Mbasi të bëhet rekomandimi dhe para se të fillojë vlerësimi:

- Duhet t'ju jepet "njoftim paraprak me shkrim" brenda 30 ditëve nga data e rekomandimit. Njoftimi paraprak me shkrim ju tregon që distrikti shkollor ose po propozon për të ndërmarrë disa veprime në lidhje me çështjen e fëmijës suaj për t'u kualifikuar ose për të marrë shërbimet e edukimit special; ose që distrikti shkollor po refuzon që të ndërmarrë ndonjë veprim në lidhje me këtë çështje, dhe në të dyja rastet shpjegon vendimin e distriktit.
- Nëse distrikti shkollor dyshon që fëmija mund të ketë ndonjë paaftësi dhe ka nevojë për vlerësim, distrikti duhet të marrë miratimin tuaj me shkrim për të vlerësuar fëmijën tuaj.
- Kur refuzoni që të jepni miratimin tuaj që fëmija juaj të vlerësohet, distrikti shkollor mund të përdorë procedurat e "ndërmjetësimit" ose "procesit të rregullt ligjor" që të marrë miratimin për të vlerësuar fëmijën tuaj. (Shihni shpjegimin e këtyre termave në pjesën "Përkufizime").

Kërkesat që një fëmijë t'i përmbushë kushtet për edukim special dhe shërbime përkatëse janë krijuar për çdo paaftësi të njohur me anë të ligjeve federale dhe shtetërore. Paaftësitë përcaktohen në pjesën e këtij dokumenti që titullohet: "Përkufizimet e termave të paaftësisë".

NJOFTIME

Çfarë është njoftimi i masave mbrojtëse procedurale?

Ligji kërkon që një "njoftim i masave mbrojtëse procedurale" t'u jepet prindërve në kohë të caktuar. Ky njoftim përvijon të drejtat tuaja për një edukim të duhur publik falas për fëmijën tuaj që ka paaftësi dhe ju udhëzon se si t'i ushtroni këto të drejta. Udhëzuesi që po mbani në dorë "E kujt është kjo IDEA?" shërben si njoftim i masave mbrojtëse procedurale. Ky udhëzues gjithashtu përmban burime ndihme që mund të kontaktoni për të marrë ndihmë. (Gjithashtu shihni pjesën "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve").

Kur duhet të ma japë njoftimin e masave mbrojtëse procedurale distrikti shkollor?

Distrikti shkollor duhet t'ju japë një kopje të "E kujt është kjo IDEA?" vetëm një herë në vit. Duhet t'ju ofrohet një kopje shtesë në secilin nga rastet e mëposhtme:

- Mbas rekomandimit të parë, shpesh të quajtur "fillestar" ose mbas kërkesës suaj për vlerësim;
- Herën e parë gjatë një viti shkollor kur ju paraqisni ankesë te Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio (Shihni pjesën "Ankesat");
- Mbas paraqitjes së ankesës suaj të procesit të rregullt ligjor gjatë një viti shkollor;
- Mbas një ndryshimi në vendndodhjen e edukimit të fëmijës suaj (e quajtur shpesh "vendosja" e fëmijës suaj), për shkak të masave disiplinore të marra kundër fëmijës suaj; dhe
- Me kërkesën tuaj.

Distrikti shkollor mund të vendosë një kopje të "E kujt është kjo IDEA?" në faqen e vet të internetit, nëse e ka këtë faqe. Por distrikti shkollor duhet të vazhdojë t'ju japë prindërve një kopje të printuar të njoftimit të masave mbrojtëse procedurale gjatë afateve të shënuara më sipër.

Çfarë është njoftimi paraprak me shkrim?

Ju duhet të merrni informacion, me shkrim, brenda një periudhe të arsyeshme para se distrikti shkollor të propozojë ndonjë veprim që ka lidhje me kualifikimin e fëmijës suaj dhe marrjen e shërbimeve të edukimit special. Ju gjithashtu do të merrni informacion, kur distrikti

refuzon të ndërmarrë veprime në lidhje me kualifikimin e fëmijës suaj për shërbime të edukimit special dhe marrjen e shërbimeve të edukimit special. Ky informacion quhet njoftimi paraprak me shkrim.

Distrikti shkollor gjithashtu duhet t'ju japë njoftim paraprak me shkrim:

- Brenda 30 ditëve nga dita e rekomandimit; ose
- Para se të ndryshohet vendosja e fëmijës suaj, për shkak të ndonjë mase disiplinore.

IEP-ja e fëmijës suaj do të shërbejë si njoftim paraprak me shkrim, përveç rastit kur ju nuk bini dakord me IEP-në. Nëse nuk bini dakord me IEP-në, distrikti shkollor duhet t'ju japë njoftim paraprak me shkrim më vete, para se të zbatohet IEP-ja e fëmijës suaj.

Njoftimi paraprak me shkrim duhet:

- Të përshkruajë veprimin që distrikti shkollor po propozon ose po refuzon ta ndërmarrë;
- Të shpjegojë pse distrikti ose agjencia po propozon ose po refuzon të ndërmarrë veprim;
- Të përshkruajë mundësi të tjera që ekipi i IEP-së mori në konsideratë dhe arsyet pse ato mundësi u hodhën poshtë;
- Të bëjë një përshkrim të çdo procedure vlerësimi, të çdo vlerësimi, të dokumenteve ose raporteve të distriktit shkollor, të cilat u përdorën për të marrë vendimin e tij;
- Të bëjë një përshkrim të faktorëve të tjerë që çuan në vendimin e distriktit shkollor;
- Të përfshijë informacion duke thënë që të drejtat e prindërve mbrohen nga masat mbrojtëse procedurale. (Nëse njoftimi paraprak me shkrim nuk është rekomandimi i parë për vlerësimin e fëmijës suaj, distrikti shkollor nuk është i detyruar që t'ju japë një kopje shtesë të njoftimit të masave mbrojtëse procedurale, "E kujt është kjo IDEA?"). Megjithatë, distrikti do t'ju tregojë se si të merrni një kopje të udhëzuesit; dhe
- Të identifikojë burimet ndihmëse që mund të kontaktoni për t'ju ndihmuar të kuptoni të drejtat tuaja në lidhje me njoftimin paraprak me shkrim.

Njoftimi paraprak me shkrim për prindërit duhet të shkruhet në një gjuhë të kuptueshme për publikun e përgjithshëm. Distrikti duhet t'ju japë njoftimin në gjuhën tuaj amtare ose në mënyra të tjera komunikimi që përdorni ju, përveç rastit

kur është e qartë se kjo gjë nuk është praktike për t'u bërë. Nëse gjuha juaj amtare ose mënyra tjetër e komunikimit nuk është gjuhë e shkrueshme, distrikti shkollor duhet të marrë masa që njoftimi të përkthehet gojarisht ose me mënyra të tjera, në mënyrë që ju ta kuptoni atë. Distrikti shkollor duhet të mbajë dokumentim me shkrim që i ka marrë këto masa.

Nëse nuk jeni dakord me distriktin shkollor në lidhje me ndonjë nga informatat e dhëna në njoftimin paraprak me shkrim, për udhëzim shihni pjesën "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve".

A mund të vendos që t'i marr njoftimet e detyrueshme nga distrikti shkollor nëpërmjet postës elektronike (email)?

Po, ju mund të vendosni që t'i merrni njoftimet e detyrueshme me email, nëse distrikti shkollor e vë në dispozicion këtë mundësi.

PRINDËRIT ZËVENDËSUES

Çfarë është prindi zëvendësues?

Prindi zëvendësues është një individ që mund të përfaqësojë një fëmijë me paaftësi në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kualifikimin për shërbime të edukimit special ose marrjen e shërbimeve të edukimit special.

Distrikti shkollor cakton një prind zëvendësues sa herë që ndodh njëra nga gjërat e mëposhtme:

- Prindi nuk mund të identifikohet;
- Distrikti shkollor, mbas përpjekjeve të arsyeshme nuk mund ta gjejë prindin;
- Fëmija është një i pastrehë i pashoqëruar; ose
- Fëmija është nën tutelën e shtetit.

SHËNIM: Prindi zëvendësues për fëmijën që është nën tutelën e shtetit mund të caktohet nga gjykatësi që mbikëqyr kujdesin e fëmijës dhe jo nga distrikti shkollor, për aq kohë sa prindi zëvendësues i plotëson kërkesat e përshkruara në pikën e parë dhe të katërt në listën e mëposhtme:

Prindi zëvendësues duhet të jetë dikush që:

- Nuk është punonjës i distriktit shkollor, i Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio ose i ndonjë agjencie tjetër të përfshirë në edukimin ose kujdesin e fëmijës, duke

përfshirë agjencitë publike të shërbimit të fëmijëve. (Ekzistojnë disa përjashtime të veçanta për këtë kërkesë kur prindër zëvendësues të përkohshëm caktohen për një të ri të pastrehë të pashoqëruar);

- Nuk ka interes personal ose profesional që bie në konflikt me interesat e fëmijës që po përfaqësohet;
- Ka njohuritë dhe aftësitë për të përfaqësuar siç duhet fëmijën; dhe
- Ka përfunduar me sukses trajnimin e miratuar nga shteti për të qenë prind zëvendësues.

Një fëmijë që ka mbushur 18 vjeç mund të bëjë kërkesë për prind zëvendësues.

Prindi zëvendësues mund ta përfaqësojë fëmijën në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kualifikimin për shërbime të edukimit special dhe marrjen e shërbimeve të edukimit special. Prindi zëvendësues duhet të caktohet sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 30 ditë nga data kur merret vendimi që fëmija ka nevojë për prind zëvendësues.

Distrikti shkollor i fëmijës, këshilli i rrethit për personat me të meta mendore dhe paaftësi në zhvillim, ose ndonjë agjenci tjetër edukative mund ta caktojë prindin zëvendësues nëse distrikti shkollor e kërkon këtë dhe nëse të gjitha palët bien dakord.

MIRATIMI

Çfarë do të thotë miratim?

Miratim do të thotë që:

- Ju jeni informuar plotësisht për **të gjithë** informacionin e nevojshëm për të marrë vendim në lidhje me një aktivitet të propozuar. Ky informacion duhet t'ju jepet në gjuhën tuaj amtare ose në mënyrat e tjera të komunikimit që përdorni ju.
- Ju e kuptoni dhe bini dakord me shkrim me aktivitetin e propozuar. Miratimi që ju nënshkruani duhet të përshkruajë aktivitetin e propozuar dhe të shënojë të gjithë dokumentacionin e fëmijës që do të bëhet i njohur. Gjithashtu duhet të shënojë se kush do t'i marrë këto dokumente.
- Ju e kuptoni se dhënia e miratimit tuaj bëhet në mënyrë vullnetare dhe se mund ta anuloni miratimin në çdo kohë.

- Ju e kuptoni se nëse e anuloni miratimin tuaj, ai anulim nuk e kthen mbrapsht atë veprim që ndodhi mbasi e dhatë miratimin, por para se ta anuloni miratimin.

Kur duhet që distrikti shkollor të marrë miratimin tim me shkrim?

Distrikti shkollor duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme që të marrë miratimin tuaj:

- Para se të fillojë vlerësimi i parë;
 - Para se edukimi special dhe shërbimet përkatëse të jepen për herë të parë;
 - Para se të fillojë rivlerësimi, nëse testimi i ri do të kryhet si pjesë e vlerësimit; dhe
 - Para se të ndodhë një ndryshim në vendndodhjen e shërbimeve (për hollësi shihni “Vazhdim i mundësive alternative të vendosjes” në pjesën “Përkufizime”).
- Ekziston një përjashtim: Distrikti nuk është i detyruar të marrë miratimin tuaj nëse fëmija juaj po hiqet nga vendndodhja e tij apo e saj për arsye disiplinore (shihni pjesën “Disiplina”).

Distrikti shkollor duhet të dokumentojë të gjitha përpjekjet e tij për të marrë miratimin tuaj.

Kur jepni miratimin tuaj për vlerësimin e parë të fëmijës suaj, ju *nuk* po jepni miratim që distrikti të fillojë t’i japë fëmijës suaj shërbime të edukimit special dhe shërbime përkatëse.

Çfarë ndodh nëse nuk jap miratim për vlerësimin e parë të fëmijës tim?

Distrikti shkollor duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme që të marrë miratimin tuaj për vlerësimin e parë, për të përcaktuar nëse “fëmija juaj është fëmijë me paaftësi”. (“Fëmija është fëmijë me paaftësi” është gjuhë ligjore që thjesht do të thotë që një fëmijë ka një paaftësi, e cila bën që ai ose ajo të ketë nevojë për shërbime të edukimit special për të mësuar. Jo të gjithë fëmijët me paaftësi kanë nevojë ose kualifikohen për shërbime të edukimit special ose shërbime përkatëse).

Kur nuk jepni miratim për vlerësimin e parë të fëmijës ose nuk i përgjigjeni kërkesës për të dhënë miratimin, atëherë distrikti shkollor mundet që:

- Të paraqesë kundër jush një “ankesë të procesit të rregullt ligjor (shihni pjesën “Përkufizime”);

- Të kërkojë që ju të vini në një seancë ndërmjetësuese me distriktin shkollor, të ofruar nga Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio. Qëllimi i ndërmjetësimit është që distrikti shkollor dhe ju të bini dakord për atë çka duhet të ndodhë, në mënyrë që fëmija juaj të ndihmohet në të mësuar; ose
- Të vendosë që të mos kryhet vlerësimi. Në këtë rast, distrikti mund ta konsiderojë fëmijën tuaj të pakualifikueshëm për shërbime të edukimit special ose shërbime përkatëse.

Çfarë ndodh nëse nuk miratoj që distrikti shkollor ose agjencitë e tjera publike t’i sigurojnë shërbime të edukimit special dhe shërbime përkatëse fëmijës tim?

Nëse vlerësimi i parë tregon që fëmija juaj është fëmijë me paaftësi, distrikti do të flasë me ju në lidhje me dhënien e edukimit special dhe shërbimeve përkatëse për fëmijën tuaj. Distrikti shkollor duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme që të marrë miratimin tuaj për sigurimin e këtyre shërbimeve të edukimit special dhe shërbimeve përkatëse.

Nëse nuk përgjigjeni, ose nëse në këtë fazë refuzoni të jepni miratimin tuaj që distrikti të sigurojë shërbime të edukimit special ose shërbime përkatëse për fëmijën tuaj, distrikti shkollor mund të mos paraqesë ankesë për një seancë të procesit të rregullt ligjor kundër jush. Gjithashtu distrikti mund të mos ju kërkojë që të merrni pjesë me distriktin shkollor në një ndërmjetësim në shkallë shtetërore për të marrë miratimin tuaj për sigurimin e shërbimeve të edukimit special dhe shërbimeve përkatëse.

Nëse refuzoni të miratoni që distrikti të sigurojë shërbime të edukimit special dhe përkatëse ose nëse nuk i përgjigjeni kërkesës për të dhënë miratimin tuaj, distrikti shkollor nuk është i detyruar që t’i sigurojë fëmijës suaj edukim të përshtatshëm publik falas. Gjithashtu distrikti nuk është i detyruar t’i sigurojë fëmijës suaj një program edukativ të individualizuar (të cilit zakonisht i referohemi si “IEP”-ja). Për më tepër:

- Distrikti shkollor nuk po e shkel kërkesën për të vënë në dispozicion të fëmijës suaj edukim publik të përshtatshëm falas nëse ai nuk i siguron fëmijës suaj shërbime të edukimit special ose përkatëse; dhe
- Distrikti shkollor nuk është i detyruar që të organizojë mbledhjen e ekipit të IEP-së ose

July 1, 2008

Faqja 13

të krijojë një program edukativ të individualizuar për fëmijën tuaj për shërbimet e edukimit special dhe ato përkatëse.

Çfarë ndodh nëse refuzoj të miratoj një nga shërbimet ose aktivitetet, por bie dakord për disa shërbime të tjera të programit edukativ të individualizuar?

Distrikti shkollor ose ndonjë agjenci tjetër publike nuk duhet ta përdorë refuzimin tuaj për miratimin e një prej shërbimeve ose aktiviteteve, në mënyrë që t'ju mohojë juve ose fëmijës suaj ndonjë nga shërbimet ose aktivitetet e tjera për të cilat kualifikohet fëmija juaj.

Çfarë ndodh nëse nuk jap miratim për rivlerësimin e fëmijës tim?

Distrikti shkollor që ka përgjegjësi të vërë edukimin publik të përshtatshëm falas në dispozicion të fëmijës suaj me paaftësi, duhet që gjithashtu të bëjë përpjekje të arsyeshme për të marrë miratimin tuaj kur fëmija ka nevojë për rivlerësim. (Ky koncept shpjegohet më plotësisht në pjesën "Rivlerësimi").

Nëse nuk përgjigjeni ose nëse refuzoni që të jepni miratim që fëmija juaj të rivlerësohet, distrikti shkollor mund të bëjë njërën nga gjërat e mëposhtme:

- Ta kryejë rivlerësimin, duke rishikuar informacionin që distrikti shkollor ka tashmë për fëmijën tuaj dhe të mos bëjë asnjë testim të ri;
- T'ju kërkojë që të vini në ndërmjetësim me një ndërmjetës të caktuar nga shteti, në përpjekje për ta zgjidhur çështjen;
- Të kërkojë një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, ku një administrator i seancës dëgjimore vendos nëse fëmija juaj ka nevojë të rivlerësohet apo jo; ose
- Të vendosë që të mos e kryejë rivlerësimin. Në këtë rast, distrikti mund ta konsiderojë fëmijën tuaj si të pakualifikueshëm për shërbimet.

Cilat janë kërkesat për të marrë miratim për të miturit nën tutelën e shtetit?

- *Vetëm për vlerësimet e para:* Nëse fëmija është nën tutelën e shtetit dhe nuk jeton me prindërit, distrikti shkollor nuk është i detyruar të marrë nga prindërit miratim për

vlerësimin e parë, në mënyrë që të përcaktohet nëse fëmija është fëmijë me paaftësi, nëse:

- Mbas përpjekjeve të arsyeshme, distrikti shkollor nuk mund të gjejë prindërit e fëmijës;
- Në bazë të ligjit të shtetit, prindërve u janë hequr të drejtat e tyre mbi fëmijën;
- Në bazë të ligjit të shtetit, gjykatësi u ka hequr prindërve të drejtat e tyre për të marrë vendime edukative për fëmijën dhe ia ka dhënë një personi tjetër të drejtën e miratimit për vlerësim.

Kur nuk ka nevojë të jepet miratimi im në procesin e vlerësimit ose të rivlerësimit?

Miratimi juaj nuk kërkohet:

- Kur distrikti shkollor po rishikon informacionin që tashmë është mbledhur si pjesë e vlerësimit ose rivlerësimit; ose
- Kur distrikti shkollor po u bën test ose vlerësim të gjithë fëmijëve, përveç rastit kur kërkohet miratim për të gjithë.

Çfarë ndodh nëse unë e mësoj fëmijën tim në shtëpi dhe jo në shkollë ose nëse e kam futur fëmijën tim në një shkollë private me shpenzimet e mia dhe më pas unë:

- **Nuk jap miratim për një vlerësim të parë ose rivlerësim të fëmijës tim; ose**
- **Nuk i përgjigjem kërkesës për të dhënë miratim?**

Nëse e mësoni fëmijën tuaj në shtëpi dhe jo në shkollë ose nëse e keni futur fëmijën në një shkollë private me shpenzimet tuaja, atëherë distrikti shkollor:

- Mund të mos paraqesë ankesë për një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor kundër jush ose mos t'ju kërkojë që të vini në ndërmjetësimin e distriktit shkollor të koordinuar nga shteti që ju të bini dakord që fëmija juaj të vlerësohet ose rivlerësohet;
- Nuk është i detyruar që ta konsiderojë fëmijën tuaj të kualifikueshëm për shërbimet;
- Duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të marrë miratimin tuaj dhe duhet të dokumentojë përpjekjet e tij për të marrë miratimin tuaj;
- Nuk është i detyruar që ta konsiderojë fëmijën tuaj si të kualifikueshëm për shërbimet; dhe

- Duhet të bëjë përpjekje të arsyeshme për të marrë miratimin tuaj dhe duhet të dokumentojë përpjekjet e tij për të marrë miratimin tuaj.

përbush kushtet për edukim special dhe shërbime përkatëse, si dhe për të përcaktuar nëse shërbimet që fëmija po i merr tani janë të përshtatshme.

VLERËSIMI

Çfarë është vlerësimi?

Vlerësimi është një proces që përdoret për të mbledhur informacion që do të ndihmojë për të përcaktuar nëse fëmija juaj është fëmijë me paaftësi. Gjithashtu do të ndihmojë në përcaktimin e nevojave edukative të fëmijës suaj.

Arsyeja për vlerësimin e fëmijës suaj është që:

- Të formohet një ide e plotë e aftësive të fëmijës suaj, si pikë fillestare për planifikimin e shërbimeve edukative. Kjo përfshin një pamje të përgjithshme se si po shkon fëmija juaj me mësim dhe se si po zhvillohet fëmija juaj;
- Të bëjë rekomandime për mënyrat e plotësimit të nevojave edukative të fëmijës suaj; dhe
- Të përcaktojë nëse fëmija juaj ka nevojë për edukim special dhe shërbime përkatëse.

Kush mund të kërkojë vlerësim fillestar për të përcaktuar nëse fëmija im është fëmijë me paaftësi?

Ju prindi, Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio ose ndonjë agjenci tjetër publike mund të kërkojë vlerësim fillestar për të përcaktuar nëse fëmija juaj është fëmijë me paaftësi.

Brenda 30 ditëve nga marrja e kërkesës për një vlerësim të parë, distrikti shkollor i vendbanimit ose:

- Do të marrë miratimin tuaj për vlerësim të parë; ose
- Do t'ju dërgojë njoftim paraprak me shkrim, ku thuhet se distrikti shkollor nuk dyshon se fëmija ka paaftësi dhe nuk do ta kryejë vlerësimin.

Kur ka nevojë për vlerësim fëmija im?

Fëmija juaj ka nevojë për vlerësim kur distrikti shkollor i vendbanimit dyshon që fëmija juaj ka paaftësi.

Nëse fëmija juaj tashmë po merr edukim special dhe shërbime përkatëse, distrikti bën një rivlerësim për t'u siguruar që fëmija juaj ende i

Cilët janë hapat për plotësimin e vlerësimit?

Distrikti shkollor do marrë miratimin tuaj për të bërë vlerësimin dhe vlerësimi do të plotësohet jo më vonë se 60 ditë kalendarike nga dita kur i keni dhënë miratimin tuaj distriktit shkollor.

Mbasi të keni dhënë miratimin, ju dhe distrikti shkollor do të krijoni një plan vlerësimi.

Vlerësimi i fëmijës suaj duhet:

- Të përdorë një shumëllojshmëri aktivitetesh dhe metodash vlerësimi për të mbledhur informacion se si po zhvillohet, po mëson dhe po funksionon fëmija juaj. Një nga këto metoda do të jetë përdorimi i informacionit të dhënë prej jush.
- Të mos përdorë vetëm një masë ose vlerësim të vetëm si arsye të vetme për të përcaktuar nëse fëmija është fëmijë me paaftësi dhe për të përcaktuar një program të duhur edukativ për fëmijën tuaj;
- Të përdorë teste dhe vlerësime të besueshme që tregojnë se sa kontribuon intelekti, sjellja, gjendja fizike dhe niveli i zhvillimit të fëmijës suaj në paaftësinë e tij.
- Të përdorë mjete vlerësimi që janë në gjuhën amtare të fëmijës tuaj ose mënyra të tjera komunikimi dhe që jepen në atë mënyrë që ka më shumë gjasa për të dhënë informacion të saktë në lidhje me faktin se si po zhvillohet, po mëson dhe po funksionon fëmija juaj (përveç rastit kur është e qartë që kjo gjë nuk është praktike për t'u bërë);
- Të përdorë mjete vlerësimi që janë të paanshme: me fjalë të tjera, të përdoren në mënyrë të tillë që të mos diskriminojnë kundër fëmijës suaj, pavarësisht nga mjedisi kulturor, raca ose paaftësia e fëmijës suaj;
- Të përdorë informacionin e formimit kulturor të dhënë nga ju, prindi. Kjo mund të përfshijë çfarëdolloj raportesh nga profesionistë të jashtëm, që nuk punojnë për distriktin shkollor.
- Të mbledhë informacion të dobishëm për të ndihmuar përparimin e fëmijës suaj në programin e përgjithshëm mësimor, ose që fëmijët parashkollorë të marrin pjesë në aktivitetet tipike për atë grup moshe;

- Të përfshijë materiale që kanë qëllim të tregojnë nevojat e edukimit special dhe jo thjesht për të matur zgjuarsinë.
- Të përdorë teste dhe vlerësime vetëm për qëllimet e synuara dhe që konsiderohen të besueshme; dhe
- Të përfshijë teste dhe vlerësime të dhëna nga një profesionist i trajnuar duke përdorur udhëzimet e dhëna nga autorët e testeve.

Vlerësimi duhet që të çmojë të gjitha fushat që kanë të bëjnë me paaftësinë e dyshuar të fëmijës suaj, duke përfshirë, nëse është e përshtatshme, gjërat e mëposhtme:

- Shëndetin;
- Shikimin;
- Dëgjimin;
- Zhvillimin social dhe emocional;
- Zgjuarsinë e përgjithshme;
- Përparimin në mësim;
- Aftësitë komunikuese (të dëgjuarin, të folurën dhe shkrimin);
- Aftësitë motorike (aftësitë që kërkojnë lëvizje dhe koordinim); ose
- Prirjet, nivelin e arritjeve ose faktorë të tjerë kur fëmija juaj ka kufizime që ndikojnë në ndjesi, koordinim ose të folur.

Gjithashtu mund të kërkontë që të vlerësohen fusha të tjera si pjesë përbërëse e vlerësimit të fëmijës suaj.

Të gjitha pjesët e vlerësimit për të cilat keni rënë dakord ju dhe distrikti shkollor në planin e vlerësimit, duke përfshirë edhe vlerësimet mjekësore, sigurohen nga distrikti shkollor, pa asnjë lloj kostoje për ju. Nëse ju dhe distrikti shkollor nuk mund të bini dakord për të gjitha pjesët e planit të vlerësimit, mund të filloni të ndërmerri hapa për të zgjidhur konfliktin me distriktin shkollor. (Shihni pjesën “Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve”).

Çfarë ndodh kur përfundon vlerësimi?

Kur të kenë përfunduar të gjitha pjesët e vlerësimit, ekipi i IEP-së dhe profesionistët e tjerë të kualifikuar, atëherë kur është e përshtatshme, duhet që:

- Të rishikojnë rezultatet e vlerësimit; dhe
- Të përgatisin një raport të ekipit të vlerësimit. Raporti duhet të përmbledhë informacionin e grumbulluar gjatë procesit të vlerësimit.

Një grup profesionistësh të kualifikuar dhe ju, prindi, do të përcaktoni nëse fëmija juaj është fëmijë me paaftësi.

Nëse grupi përcakton se fëmija juaj është fëmijë me paaftësi, ekipi i IEP-së do të krijojë një program edukativ të individualizuar për fëmijën tuaj.

Nëse fëmija im ka vështirësi në lexim ose matematikë, a konsiderohet fëmija im si fëmijë me paaftësi?

Grupi nuk do ta konsiderojë fëmijën tuaj si fëmijë me paaftësi nëse e vetmja arsye pse fëmija ka vështirësi është që fëmija:

- Nuk ka pasur mësimdhënie bazë të përshtatshme në lexim;
- Nuk ka pasur mësimdhënie të përshtatshme në matematikë; ose
- Ka aftësi të kufizuar në përdorimin e gjuhës angleze. Kjo gjithashtu quhet “aftësi e kufizuar e anglishtes” (Limited English Proficiency – LEP).

Si do ta përcaktojë grupi nëse fëmija im ka një paaftësi të veçantë në të mësuar?

Kur përcakton nëse fëmija juaj ka një paaftësi të veçantë në të mësuar, grupi:

- Mund të përdorë një proces të bazuar në reagimin e fëmijës suaj ndaj mënyrave të caktuara të mësimdhënies, që studimet kanë treguar se janë të suksesshme me fëmijët e moshës dhe klasës së fëmijës suaj.
- Mund të përdorë procedura të tjera që studimet kanë treguar se janë të suksesshme; dhe
- Nuk e ka të detyrueshme që të marrë në konsideratë nëse ka ndonjë ndryshim të madh midis zgjuarsisë dhe arritjeve të fëmijës suaj në mendimet e shprehura me gojë, në mendimet e shprehura me shkrim, në lexim, në të kuptuarin e asaj çka dëgjon dhe lexon, si dhe në zgjidhjen e problemave matematikore.

Cili është afati për të përcaktuar nëse fëmija im është fëmijë me paaftësi?

Vlerësimi i parë: Vlerësimi i parë duhet:

- Të kryhet brenda 60 ditëve nga marrja e miratimit tuaj për vlerësim; dhe
- Të përfshijë aktivitete që përcaktojnë nëse fëmija juaj është fëmijë me

paaftësi dhe që përcaktojnë nevojat edukative të fëmijës suaj.

PËRJASHTIM: Vlerësimi i parë nuk është i detyruar të kryhet brenda 60 ditëve nëse:

- Ju në mënyrë të vazhdueshme nuk e sillni fëmijën për vlerësim; ose
- Fëmija juaj regjistrohet në një distrikt të ri shkollor të vendbanimit brenda 60 ditëve mbasi keni dhënë miratim dhe distrikti shkollor i mëparshëm i fëmijës suaj ende nuk e ka vendosur nëse fëmija juaj është fëmijë me paaftësi. Kjo do të ndodhë vetëm nëse:

1. Distrikti i ri shkollor po bën përparim të pranueshëm në drejtim të përfundimit të vlerësimit; dhe
2. Ju dhe distrikti i ri shkollor bini dakord për një kohë të caktuar se kur do të përfundojë vlerësimi.

Referojuni pjesës “Transferimet” për informacion të mëtejshëm.

Ekzaminimi fillestar. Ekzaminimi fillestar i thjeshtë i një nxënësi nga një mësues ose specialist për të përcaktuar strategjitë e duhura për t'i mësuar fëmijës suaj programin mësimor nuk do të konsiderohet vlerësim për të përcaktuar nëse fëmija juaj i përmbush kushtet për edukim special dhe shërbime përkatëse.

Raporti i ekipit të vlerësimit. Distrikti shkollor do t'ju japë një kopje të raportit të ekipit të vlerësimit para mbledhjes së programit edukativ të individualizuar, por jo më vonë se 14 ditë nga data kur është gjetur se fëmija juaj i përmbush kushtet.

RIVLERËSIMI

Cili është qëllimi i rivlerësimit?

Qëllimi i rivlerësimit është që të përcaktohet nëse fëmija juaj vazhdon të ketë paaftësi dhe të përcaktohen nevojat edukative të fëmijës suaj.

Informacioni që mblidhet do të rishikohet dhe do të përdoret për të vendosur:

- Nëse fëmija juaj vazhdon të ketë nevojë për edukim special dhe shërbime përkatëse; dhe
- Nëse janë të nevojshme shtesa apo ndryshime në edukimin special dhe shërbimet përkatëse, për t'i dhënë mundësi fëmijës suaj që:

1. Të arrijë qëllimet vjetore të matshme, të caktuara në programin edukativ të individualizuar; dhe
2. Të marrë pjesë në programin mësimor të përgjithshëm, atëherë kur është e përshtatshme.

Kur duhet të bëhet rivlerësimi?

Rivlerësimi duhet të kryhet:

- Nëse distrikti shkollor përcakton që shërbimet edukative ose përkatëse të fëmijës suaj e bëjnë të domosdoshëm rivlerësimin;
- Nëse ju ose mësuesi i fëmijës suaj kërkon rivlerësim;
- Kur fëmija juaj kalon nga shërbimet e edukimit special parashkollor në shërbimet e edukimit special të moshës shkollorë;
- Për të bërë një ndryshim në kategorinë e paaftësisë së fëmijës suaj; ose
- Përpara se të përcaktohet se fëmija juaj nuk është më fëmijë me paaftësi.

SHËNIM: Rivlerësimi nuk është i detyrueshëm nëse fëmija juaj nuk i përmbush më kushtet për shkak se përfundoi shkollën e mesme me diplomë të rregullt ose për shkak se fëmija juaj ka mbushur moshën 22 vjeç.

Rivlerësimi:

- Nuk mund të kërkohet prej jush më shpesh se një herë në vit, përveç rastit kur ju dhe distrikti bini dakord për një gjë të tillë; dhe
- Duhet të bëhet të paktën një herë në tri vjet, përveç rastit kur ju dhe distrikti shkollor bini dakord që rivlerësimi nuk është i nevojshëm.

Çfarë ndodh kur vjen koha për rivlerësimin e fëmijës tim për shërbime të edukimit special?

Distrikti shkollor:

- Do t'ju ftojë që të merrni pjesë në procesin e rivlerësimit;
- Do të shpjegojë procesin e rivlerësimit, duke përfshirë të drejtën tuaj për të kërkuar vlerësim për të përcaktuar nëse fëmija juaj vazhdon të jetë fëmijë me paaftësi dhe për të përcaktuar nevojat edukative të fëmijës suaj;
- Do t'ju japë një njoftim paraprak me shkrim; dhe

- Do të marrë miratimin tuaj me shkrim nëse vlerësime të reja janë të nevojshme, ose nëse ju i kërkon ato.

Procesi i rivlerësimit, duke përfshirë testet ose vlerësimet e reja, mund të vazhdohet më tej nëse distrikti shkollor tregon dhe dokumenton përpjekje të arsyeshme për të marrë miratimin tuaj dhe ju nuk përgjigjeni. Kjo përfshin telefonatat, njoftimet me shkrim ose vizitat në shtëpinë tuaj.

Çfarë ndodh gjatë rivlerësimit?

Gjatë rivlerësimit, ekipi i programit edukativ të individualizuar (ku përfshihen ju) dhe profesionistët e tjerë të kualifikuar, rishikon, atëherë kur është e përshtatshme, informacionin nga vlerësimi i mëparshëm i fëmijës suaj dhe:

- Përcakton nëse vlerësimet dhe informacionet shtesë (të dhëna nga distrikti shkollor) janë të nevojshme për të përcaktuar nëse fëmija juaj vazhdon t'i përmbushë kushtet dhe nëse ka nevojë për ndryshim të shërbimeve; ose
- Përcakton se asnjë informacion shtesë nuk është i nevojshëm që fëmija juaj të vazhdojë t'i përmbushë kushtet dhe që distrikti ka informacion të mjaftueshëm për të përcaktuar se për çfarë shërbimesh ka nevojë fëmija juaj. Nëse ekipi përcakton se nuk ka nevojë për informacion shtesë për rivlerësim, ju do të merrni njoftim paraprak me shkrim nga distrikti, ku ju tregohen arsyet pse nuk është i nevojshëm informacioni i mëtejshëm dhe se fëmija juaj vazhdon që t'i përmbushë kushtet për edukim special dhe shërbime përkatëse.

Nëse ekipi i programit edukativ të individualizuar dhe profesionistët e tjerë të kualifikuar përcaktojnë se nuk nevojitet asnjë informacion shtesë, distrikti duhet t'ju njoftojë se keni të drejtë të kërkon vlerësim për të përcaktuar nëse fëmija juaj vazhdon të jetë fëmijë me paaftësi dhe për të përcaktuar nevojat edukative të fëmijës suaj.

Çfarë ndodh nëse nuk jam dakord me vlerësimin e distriktit shkollor?

Nëse nuk jeni dakord me vlerësimin e distriktit shkollor, ju mund:

- Të kërkon një vlerësim të pavarur edukativ (Independent Educational Evaluation – IEE); ose

- Të ndërmerri hapa për të zgjidhur mosmarrëveshjen me distriktin e shkollës. (Shihni pjesën “Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve”).

VLERËSIMI I PAVARUR EDUKATIV

Çfarë është vlerësimi i pavarur edukativ?

Vlerësimi edukativ i pavarur (IEE) është një vlerësim që kryhet nga një ekzaminues i kualifikuar, i cili nuk është i punësuar nga distrikti shkollor i fëmijës suaj.

Nëse nuk jeni dakord me vlerësimin e fëmijës tuaj nga distrikti shkollor, në kushte të caktuara mund të merrni një vlerësim edukativ të pavarur të fëmijës suaj me shpenzime publike (pra pa asnjë shpenzim nga ana juaj).

Çfarë kushtesh duhet të plotësojë fëmija im në mënyrë që vlerësimi i pavarur edukativ të bëhet me shpenzime publike?

Mund të kryeni një vlerësim të pavarur edukativ të fëmijës suaj me shpenzime publike kur nuk bini dakord me vlerësimin e distriktit dhe kur vlerësimi i pavarur edukativ që kryeni plotëson të njëjtat kërkesa që përdor distrikti kur kryen vlerësimet. Këto kërkesa do të përfshinin, për shembull, vendndodhjen e vlerësimit dhe kualifikimet e ekzaminuesit. Përveç këtyre dhe standardeve të tjera të rëndësishme, distrikti shkollor nuk mund të imponojë kushte ose afate për vlerësimin e pavarur edukativ të fëmijës suaj.

Si mund të kryej një vlerësim të pavarur edukativ?

Me kërkesën tuaj, distrikti shkollor duhet t'ju japë informacion se ku mund të kryeni një vlerësim të pavarur edukativ për fëmijën tuaj, si dhe informacion për kërkesat e distriktit shkollor për kryerjen e vlerësimit të pavarur edukativ.

Ju ose mund të zgjidhni një vlerësues nga lista e mbajtur nga distrikti, ose të zgjidhni vlerësuesin tuaj, i cili i plotëson kërkesat e distriktit.

Sa vlerësime të pavarura edukative mund të bëj?

Ju keni të drejtë vetëm për një vlerësim të pavarur me shpenzimet e publikut, sa herë që distrikti kryen një vlerësim me të cilin ju nuk bini dakord.

A më duhet të shpjegoj pse po kërkoj vlerësim të pavarur edukativ?

Nëse kërkon vlerësim të pavarur edukativ, distrikti shkollor mund t'ju kërkojë që të thoni arsyen pse e kundërshtoni vlerësimin e distriktit. Nuk jeni i detyruar ta shpjegoni, nëse nuk dëshironi.

Çfarë do të ndodhë nëse kërkoj vlerësim të pavarur edukativ?

Nëse kërkon vlerësim të pavarur edukativ me shpenzime publike, distrikti shkollor i vendbanimit duhet, pa vonesë të panevojshme, që ose:

- Të sigurojë një vlerësim të pavarur edukativ për fëmijën tuaj me shpenzime publike; ose
- Të paraqesë një ankesë për një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor për të treguar se vlerësimi i distriktit është i saktë.

Çfarë do të ndodhë nëse nuk i tregoj distriktit që po kryej një vlerësim të pavarur edukativ të fëmijës tim, por vetëm u them që nuk jam dakord me vlerësimin e distriktit?

Për aq kohë sa vlerësimi i pavarur edukativ që kryeni i plotëson kërkesat e distriktit për vlerësimet e pavarura edukative, distrikti, me marrjen e kopjes së vlerësimit, ose:

- Do të paguajë koston e vlerësimit të pavarur edukativ; ose
- Do të paraqesë një ankesë të procesit të rregullt ligjor për një seancë dëgjimore, për të treguar se vlerësuesi i pavarur që zgjidhni ju nuk i përmbush kërkesat e distriktit ose për të treguar se vlerësimi i distriktit është i saktë.

A mundet që dikush tjetër të kërkojë vlerësim të pavarur edukativ?

Po, nëse kërkon seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor meqenëse nuk bini dakord me vlerësimin e distriktit shkollor, administratori i seancës dëgjimore mund të kërkojë një vlerësim edukativ të pavarur si pjesë e seancës dëgjimore. Në këtë rast, vlerësimi i pavarur edukativ duhet të bëhet me shpenzime publike.

Çfarë ndodh nëse administratori i seancës dëgjimore vendos se vlerësimi i distriktit shkollor është i përshtatshëm?

Nëse administratori i seancës dëgjimore vendos që vlerësimi i distriktit është i saktë ose i

July 1, 2008

përshtatshëm, ju vazhdoni të keni të drejtën për një vlerësim të pavarur edukativ me shpenzimet tuaja.

A do ta marrë në konsideratë distrikti shkollor vlerësimin e pavarur edukativ që kam kryer për fëmijën tim?

Nëse kryeni një vlerësim të pavarur edukativ me shpenzime publike ose nëse i jepni distriktit shkollor një vlerësim që e kryet me shpenzimet tuaja, atëherë rezultatet e vlerësimit të pavarur edukativ:

- Duhet të merren në konsideratë nga distrikti shkollor, nëse i plotësojnë kërkesat e distriktit, në çdo vendim që ai merr në lidhje me sigurimin e edukimit publik falas të përshtatshëm për fëmijën tuaj.
- Mund të paraqiten nga cilado palë si fakte në seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor në lidhje me fëmijën tuaj.

PROGRAMI EDUKATIV I INDIVIDUALIZUAR (IEP)

Çfarë është programi edukativ i individualizuar?

Programi edukativ i individualizuar (IEP) është një deklaratë me shkrim për fëmijën me paaftësi, ku përvijohen qëllimet dhe objektivat edukative për të cilat do të punojë fëmija juaj në vitin e ardhshëm. Ai gjithashtu përvijon ndihmat dhe shërbimet për të cilat fëmija ka nevojë që të plotësojë qëllimet e deklaruara në programin edukativ të individualizuar.

Rregullat federale dhe shtetërore kërkojnë që programi edukativ i individualizuar të krijohet, rishikohet dhe të ripunohet në një mbledhje të individëve të kualifikuar, ku përfshihen dhe ju, prindi.

Kur duhet të kryhet mbledhja e programit edukativ të individualizuar?

Mbledhja për të krijuar një program edukativ të individualizuar duhet të kryhet brenda 30 ditëve nga vendimi se fëmija ka nevojë për shërbime të edukimit special dhe ato përkatëse. Programi edukativ i individualizuar duhet vënë në veprim sa më shpejt që të jetë e mundur, mbas mbledhjes së programit edukativ të individualizuar.

Kur duhet të përfundojë dhe të hyjë në fuqi programi edukativ i individualizuar?

- Programi edukativ i individualizuar fillestar (i parë ose origjinal) duhet të krijohet brenda njëres prej periudhave të mëposhtme që është më e shkurtra:
 - brenda 30 ditëve kalendarike nga vendimi se fëmija ka nevojë për shërbime të edukimit special ose përkatëse;
 - brenda 90 ditëve kalendarike nga marrja e miratimit të prindërve për vlerësim; ose
 - brenda 120 ditëve kalendarike nga dita kur prindi ose distrikti shkollor bën kërkesë për vlerësim.
- Programi edukativ i individualizuar duhet të ketë hyrë në fuqi brenda ditëlindjes së tretë të fëmijës dhe në fillim të çdo viti shkollor që pason atë.

Çfarë përfshin programi edukativ i individualizuar?

Programi edukativ i individualizuar përfshin:

- Informacion për të ardhmen e fëmijës suaj;
- Informacion se si fëmija juaj po mëson dhe funksionon tani.
 - Ky informacion duhet t'ju tregojë se si paaftësia e fëmijës suaj ndikon në pjesëmarrjen dhe përparimin e tij apo të saj në programin e përgjithshëm mësimor (në të njëjtin program mësimor që u mësohet fëmijëve pa paaftësi).
 - Për fëmijët parashkollorë (3 – 5 vjeç) ky informacion duhet t'ju tregojë se si paaftësia ndikon në pjesëmarrjen e fëmijës suaj në aktivitetet shkollore që janë të përshtatshme për fëmijët parashkollorë;
- Një deklaratë të qëllimeve që mund të maten çdo vit, duke përfshirë qëllimet se sa shumë mëson fëmija juaj dhe sa mirë funksionon fëmija juaj;
- Informacioni duhet të përfshijë gjithashtu standarde matëse ose objektiva afatshkurtra që kanë të bëjnë me të mësuarin dhe funksionimin, të cilat synojnë që:
 - Të plotësojnë nevojat e fëmijës që rezultojnë nga paaftësia e tij ose e saj, në mënyrë që fëmija juaj të marrë pjesë dhe të përparojë në programin e përgjithshëm mësimor edukativ; dhe
 - Të plotësojnë nevojat e tjera edukative të fëmijës, të cilat rezultojnë nga paaftësia;
- Një përkthim:
 - Se si do të matet përparimi i fëmijës tuaj në drejtim të plotësimit të qëllimeve vjetore; dhe
 - Se kur do të jepen raportet e rregullta mbi përparimin që po arrin fëmija juaj në drejtim të plotësimit të qëllimeve vjetore. Këto mund të jenë çdo tre muaj ose raporte të tjera të rregullta të lëshuara në të njëjtën kohë me kartat e raportimit të notave.
- Një deklaratë të edukimit special e shërbimeve përkatëse dhe të ndihmave dhe shërbimeve suplementare (shitesë) që do t'i sigurohen fëmijës suaj, si dhe një deklaratë të modifikimit ose ndihmave të programit për personelin e shkollës që do të sigurohen për t'i dhënë mundësi fëmijës tuaj që:
 - Të përparojë drejt arritjes së qëllimeve vjetore;

- Të marrë pjesë dhe të përparojë në programin mësimor të përgjithshëm dhe të marrë pjesë në aktivitetet jashtëshkollore, nëse është e përshtatshme; dhe
- Të mësojë dhe të marrë pjesë në aktivitetet shkollore me fëmijët e tjerë që kanë dhe nuk kanë paaftësi.
- Një shpjegim se deri në cilën shkallë, nëse ka ndonjë, fëmija juaj nuk do të marrë pjesë me fëmijët që nuk kanë paaftësi në klasat e rregullta dhe në aktivitetet e tjera shkollore;
- Një deklaratë të çdo përshtatjeje individuale, që është e nevojshme për të matur se si ka dalë fëmija në vlerësimet në bazë shteti dhe distrikti. Nëse ekipi i programit edukativ të individualizuar përcakton se fëmijës tuaj do t'i bëhet një vlerësim ndryshe në një test të veçantë, të rregullt të kontrollit të arritjeve në bazë shteti ose distrikti, atëherë del e nevojshme të paraqitet një deklaratë pse fëmija juaj nuk mund të marrë pjesë në testin e rregullt; dhe pse është i përshtatshëm vlerësimi i ndryshëm që është zgjedhur për fëmijën tuaj.
- Datën që distrikti shkollor planifikon të fillojë shërbimet dhe modifikimet e përshkruara në programin edukativ të individualizuar dhe vendi ku, sa shpesh dhe për sa kohë janë të nevojshme këto shërbime dhe përshtatje (shihni *modifikimet* në pjesën "Përkufizime"); dhe
- Duke filluar të paktën një vit para se fëmija të mbushë moshën e të rriturit sipas ligjit të shtetit (18 vjeç në Ohio), një deklaratë ku thuhet që fëmija juaj është informuar në lidhje me të drejtat brenda për brenda IDEA-s, që do t'i transferohen atij ose asaj në moshën 18 vjeç.

Çfarë duhet të marrë në konsideratë ekipi i programit edukativ të individualizuar kur krijon një program edukativ të individualizuar?

Ekipi i programit edukativ të individualizuar duhet të marrë në konsideratë:

- Pikat e forta të fëmijës suaj;
- Shqetësimet tuaja për të përmirësuar edukimin e fëmijës suaj;
- Rezultatet e vlerësimit të parë ose më të fundit të fëmijës suaj;
- Rezultatet e përparimit të fëmijës suaj në të gjitha vlerësimet në bazë shteti ose distrikti; dhe

- Për çfarë ka nevojë fëmija juaj që të mësojë, të zhvillohet dhe të funksionojë ashtu siç duhet.

Çfarë gjëje tjetër merr në konsideratë ekipi i programit edukativ të individualizuar?

Ekipi i programit edukativ të individualizuar duhet që gjithashtu të rishikojë dhe të marrë në konsideratë faktorët e veçantë të mëposhtëm:

- Tranzicionin ose kalimin e fëmijës suaj nga shërbimet e edukimit special parashkollor (3 - 5 vjeç) në shërbimet e edukimit special të moshës shkollore (6 – 21 vjeç);
- Duke filluar në moshën 14 vjeç (ose më të vogël, nëse ekipi i programit edukativ të individualizuar vendos se është e nevojshme), një deklaratë e shërbimeve për të cilat do të ketë nevojë fëmija për kalimin nga shkolla e mesme në jetën e rritur. Kjo deklaratë tranzitore në moshën 14 vjeç përqendrohet në kurset e studimit të fëmijës suaj (si p.sh. në kurset e përparuara ose në një program edukativ profesional). Kjo deklaratë duhet të rifreskohet çdo vit;
- Duke filluar në moshën 16 vjeç, një deklaratë e rifreskuar çdo vit, e:
 - Qëllimeve të përshtatshme për fëmijën tuaj, bazuar në vlerësimet, që kanë të bëjnë me trajnimin dhe edukimin që do ta përgatisin fëmijën për punësim dhe, nëse është e përshtatshme, për jetesën e pavarur mbas përfundimit të shkollës; dhe
 - Shërbime tranzitore (duke përfshirë kurset e studimit) që janë të nevojshme për ta ndihmuar fëmijën në arritjen e këtyre qëllimeve;
- Nëse sjellja e fëmijës suaj pengon të mësuarin e tij/saj ose të të tjerëve, përdorim i mënyrave pozitive për të nxitur sjelljen pozitive dhe strategji të tjera për ta adresuar këtë sjellje;
- Programet e edukimit fizik që adresojnë nevojat individuale të fëmijës suaj;
- Nevojat e fëmijës suaj për shërbime të vitit shkollor të zgjatur (shërbime të ofruara përtej vitit shkollor tradicional 180 ditor);
- Nevojën për udhëzime në gjuhën Braj të të verbërve, nëse fëmija juaj ka dëmtime pamore;
- Nevojat e komunikimit të fëmijës suaj, duke përfshirë të dëgjuarin, të folurin, leximin dhe shkrimin. Nëse fëmija juaj është i shurdhër ose ka vështirësi dëgjimi, ekipi i programit

edukativ të individualizuar duhet të marrë në konsideratë gjuhën dhe nevojat e komunikimit të fëmijës suaj. Duhet të marrë në konsideratë se çfarë mundësish do të ketë fëmija juaj për komunikim të drejtpërdrejtë me shokët e klasës, mësuesit dhe mjekët e terapisë në gjuhën dhe mënyrën e komunikimit të fëmijës suaj, nivelin mësimor dhe gamën e plotë të nevojave. Kjo përfshin mundësinë për mësimdhënien një me një në gjuhën dhe mënyrën e komunikimit të fëmijës suaj;

- Nevojat gjuhësore të fëmijës suaj bazuar në programin edukativ të individualizuar, nëse aftësia e fëmijës suaj për të përdorur anglishten është e kufizuar (fëmija juaj tregon aftësi të kufizuar të anglishtes (LEP)); dhe
- Nevojën e fëmijës suaj për pajisje dhe shërbime të teknologjisë ndihmëse.

Cilat janë përgatitjet për një program edukativ të individualizuar?

Mbledhja e IEP-së përgatitet nga distrikti shkollor, sipas sa më poshtë vijon:

- Ju dhe/ose fëmija juaj do të njoftoheni për mbledhjen duke ju dhënë kohë të mjaftueshme, për t'u siguruar që do të keni mundësi të vini.
- Mbledhja do të caktohet në një kohë dhe vend për të cilat kanë rënë dakord të gjithë.
- Njoftimi i mbledhjes duhet të përfshijë qëllimin, kohën dhe vendin e mbledhjes, si dhe kush do të marrë pjesë.
- Nëse nuk mund të merrni dot pjesë, distrikti shkollor duhet të përdorë metoda të tjera për t'ju lejuar që të merrni pjesë në mbledhje, si telefonatë individuale ose telefonatë konferencë.
- Mbledhja mund të zhvillohet pa ju nëse distrikti shkollor nuk është në gjendje që t'ju bindë se duhet të merrni pjesë.
- Distrikti shkollor duhet të dokumentojë të gjitha përpjekjet e tij për t'ju kontaktuar.
- Distrikti shkollor duhet të marrë çdo masë që është e nevojshme për t'u siguruar që ju e kuptoni se çfarë do të ndodhë në mbledhjen e ekipit të programit edukativ të individualizuar, duke përfshirë gjetjen e një përkthyesi nëse keni vështirësi dëgjimi ose nëse nuk kuptoni anglisht.
- Distrikti shkollor duhet t'ju japë një kopje falas të programit të përfunduar edukativ të individualizuar për fëmijën tuaj brenda 30

ditëve nga përfundimi i mbledhjes së programit edukativ të individualizuar.

Çfarë ndodh nëse distrikti dhe unë nuk bini dakord për çka duhet të përmbajë programi edukativ i individualizuar?

Nëse ju dhe distrikti nuk bini dakord për çka duhet të përmbajë programi edukativ i individualizuar, atëherë ju mund:

- Të kërkonit "arbitrimin e programit edukativ të individualizuar";
- Të kërkonit ndërmjetësim; ose
- Të merrni pjesë në mënyra të tjera për zgjidhjen e konfliktit. (Shihni pjesën "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve").

Kush duhet të jetë anëtar i ekipit të programit edukativ të individualizuar?

Distrikti shkollor duhet të sigurojë që ekipi i programit edukativ të individualizuar për çdo fëmijë të përfshijë:

- Ju, prindin;
- Fëmijën tuaj, sa herë që është e përshtatshme;
- Të paktën njërin nga mësuesit e edukimit të rregullt të fëmijës (nëse fëmija juaj po merr pjesë ose mundet të marrë pjesë në mjedisin e edukimit të rregullt);
- Të paktën një mësues të edukimit special, ose, nëse është e përshtatshme, të paktën një nga ofruesit e edukimit special të fëmijës suaj (për shembull, një terapist të sëmundjeve profesionale apo një patolog për të folurit-gjuhën);
- Një përfaqësues të distriktit shkollor që është i kualifikuar për të siguruar ose mbikëqyrur mësimdhënien që është përpiluar në mënyrë specifike për plotësimin e nevojave unike të fëmijëve me paaftësi. Përfaqësuesi i distriktit duhet të ketë njohuri për programin e përgjithshëm mësimor dhe disponueshmërinë e burimeve të distriktit shkollor;
- Një person që mund të shpjegojë se si rezultatet e vlerësimit do të ndikojnë në mësimdhënie. Ky person mund të jetë një nga anëtarët e ekipit që përshkruhet në pikën e mësipërme;
- Në varësi të dëshirës suaj ose të distriktit shkollor, individë të tjerë që kanë njohuri ose ekspertizë të veçantë në lidhje me fëmijën tuaj, duke përfshirë personelin e shërbimeve përkatëse kur është e përshtatshme;

- Distrikti shkollor duhet ta ftojë fëmijën tuaj me paaftësi që të marrë pjesë në mbledhjen e ekipit të programit edukativ të individualizuar nëse njëri nga pikësynimet e mbledhjes do të jetë që të merren në konsideratë qëllimet e fëmijës mbas përfundimit të shkollës dhe shërbimet tranzitore, të cilat do të jenë të nevojshme për ta ndihmuar fëmijën që t'i arrijë këto qëllime; dhe
- Distrikti shkollor duhet të ftojë një përfaqësues të çfarëdo agjencie pjesëmarrëse që mund të sigurojë ose paguajë për shërbimet tranzitore në shkollën e duhur, me miratimin e prindërve ose fëmijës që ka mbushur 18 vjeç.

Kur nuk është i detyruar një anëtar i ekipit të programit edukativ të individualizuar që të marrë pjesë në mbledhjen e programit edukativ të individualizuar? Si mundet që një anëtar i ekipit të programit edukativ të individualizuar të lejohet që të mos marrë pjesë në mbledhjen e programit edukativ të individualizuar?

- Një anëtar i ekipit të programit edukativ të individualizuar nuk është i detyruar që të marrë pjesë në ndonjë seancë të një mbledhjeje të programit edukativ të individualizuar në qoftë se prindi dhe distrikti shkollor bien dakord me shkrim që pjesëmarrja e anëtarit nuk është e nevojshme. Kjo do të ndodhte vetëm për shkakun se fusha e programit mësimor (lënda) e anëtarit ose e shërbimeve përkatëse nuk po ndryshohen ose diskutohen në mbledhje.
- Një anëtar i ekipit të programit edukativ të individualizuar mund të lejohet që të mos marrë pjesë në ndonjë seancë të një mbledhjeje të programit edukativ të individualizuar kur mbledhja përfshin ndonjë ndryshim ose diskutim të fushës së programit mësimor ose të shërbimeve përkatëse të anëtarit, në këto kushte:
 1. Edhe prindi, edhe distrikti shkollor bien dakord me shkrim që anëtarit t'i jepet leje për të mos marrë pjesë; dhe
 2. Anëtar i ekipit të programit edukativ të individualizuar e jep mendimin e tij për zhvillimin e programit edukativ të individualizuar para mbledhjes. Mendimi i tij duhet të jetë me shkrim, edhe për prindin, edhe për ekipin e IEP-së;

- Nëse fëmija juaj ka marrë shërbime të mëparshme sipas pjesës C të IDEA-s (për fëmijët nga lindja deri në 2 vjeç), një ftesë në mbledhjen e programit edukativ të individualizuar fillestar duhet, me kërkesën tuaj, t'i dërgohet koordinatorit të shërbimit të pjesës C ose përfaqësuesve të tjerë të sistemit të pjesës C për të ndihmuar me tranzicionin e lehtë të shërbimeve.

Si mund të trajtohen ndryshimet në programet edukative të individualizuara dhe mbledhjet e ngjashme të programit edukativ të individualizuar?

Ndryshimet në programet edukative të individualizuara dhe mbledhjet që janë të nevojshme për t'i bërë këto ndryshime mund të trajtohen si më poshtë vijon:

- Kur bëhen ndryshime në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj mbas mbledhjes vjetore të ekipit të programit edukativ të individualizuar për vitin shkollor, ju dhe distrikti shkollor mund të bini dakord që të mos bëni mbledhje të ekipit të programit edukativ të individualizuar për t'i bërë këto ndryshime. Në vend të kësaj, ju dhe distrikti shkollor mund të përcaktoni se çfarë ndryshimesh janë të nevojshme dhe t'i dokumentoni ato me shkrim. Nëse bëni ndryshime në këtë mënyrë, distrikti shkollor duhet të sigurojë që ekipi i programit edukativ të individualizuar të fëmijës suaj të informohet për këto ndryshime.
- Në atë shkallë që është e mundur, distrikti shkollor duhet të përpiqet të kombinojë mbledhjet e rivlerësimit dhe llojet e tjera të mbledhjeve të ekipit të programit edukativ të individualizuar për fëmijën tuaj.
- Mbasi të bihet dakord për ndryshimet në programin edukativ të individualizuar, ose nga ekipi i programit edukativ të individualizuar, ose nga prindi dhe distrikti shkollor, këto ndryshime mund të bëhen pjesë e programit edukativ të individualizuar në tri mënyra:
 - Në dokumentin origjinal të programit edukativ të individualizuar mund të shënohen ndryshimet për të cilat është rënë dakord;
 - Ndryshimet e reja me shkrim mund të bashkëngjiten në programin origjinal edukativ të individualizuar; ose

- o Mund të shkruhet një program i ri edukativ i individualizuar, me ndryshimet e reflektuara në të.

Me kërkesën tuaj, mundësia e tretë duhet kryer nga distrikti shkollor. Distrikti shkollor duhet t'ju dërgojë çdo version të programit të ndryshuar edukativ të individualizuar brenda 30 ditëve nga ndryshimi.

Kur distrikti shkollor dhe unë duhet që të takohemi, a duhet të takohemi personalisht?

Jo. Ju dhe distrikti shkollor mund të bini dakord të përdorni mënyra të ndryshme dhe vende të ndryshme për t'i mbajtur mbledhjet. Për shembull, mund të zgjidhni të mbani një konferencë me video dhe telefonatë konferencë ku përfshihen të gjitha palët. Çdonjëra nga çështjet e mëposhtme mund të diskutohet në këto mënyra:

- Vlerësimet;
- Përcaktimet nëse fëmija juaj i përmbush kushtet;
- Programet edukative të individualizuara;
- Vendosjet edukative (vendndodhjet ku do të mësojë fëmija juaj);
- Masat mbrojtëse procedurale, të tilla si ndërmjetësimi dhe sesionet e zgjidhjes së problemeve; dhe
- Kryerja e çështjeve administrative sipas masave mbrojtëse procedurale të IDEA-s (të tilla si planifikimi, shkëmbimi i listave të dëshmitarëve dhe konferencat e statusit).

Çfarë përgjegjësie ka ekipi i IEP-së?

Pjesëmarrësit e mbledhjes së programit edukativ të individualizuar duhet të plotësojnë aktivitetet e mëposhtme sipas kësaj radhe:

Hapi 1: Diskutimi i planifikimit të ardhshëm.

Çdo njeri ka ëndrra për të ardhmen, të cilat udhëheqin veprimet, mendimet dhe planet. Shprehja e ëndrrave me fjalë është pjesë e planifikimit të vazhdueshëm, afatgjatë për fëmijën tuaj me paaftësi. Si pjesë e kësaj përpjekjeje, ekipi i programit edukativ të individualizuar do të diskutojë parapëlqimet dhe interesat e fëmijës suaj, si dhe qëllimet afatgjata të familjes për fëmijën tuaj. Këto mund të përfshijnë kursin e karrierës së fëmijës suaj, kushtet e jetesës dhe trajnimin e specializuar.

Hapi 2: Diskutimi i niveleve të tanishme të arritjeve mësimore dhe aftësive të përditshme të jetesës.

Ekipi i programit edukativ të individualizuar do të rishikojë informacionin përkatës për fëmijën tuaj, duke përfshirë arritjet e tanishme mësimore dhe aftësitë e përditshme të jetesës së fëmijës suaj. Ky informacion përfshin përparimin që ka arritur fëmija juaj në programin e tanishëm edukativ të individualizuar, raportin e ekipit të vlerësimit, mendimet e mësuesve të fëmijës dhe personelit shkollor që punojnë me fëmijën tuaj dhe, nëse është me vend, mendimet tuaja dhe të fëmijës suaj. Ky informacion jep një "pasqyrë" të fëmijës suaj, duke përfshirë pikat e forta dhe nevojat e fëmijës suaj.

Hapi 3: Identifikimi i qëllimeve vjetore, duke përfshirë qëllimet mësimore dhe të aftësive jetike, si dhe standardet ose objektivat afatshkurtra që mund të maten.

Ekipi i programit edukativ të individualizuar do të krijojë qëllime të matshme vjetore, duke përfshirë qëllimet mësimore dhe të aftësive jetike, si dhe standardet matëse ose objektivat afatshkurtra me procedura përkatëse vlerësimi. Këto do t'i japin mundësi fëmijës tuaj që të marrë pjesë dhe të përparojë në programin mësimor të përgjithshëm. Më pas ekipi përcakton se çfarë shërbimesh janë të nevojshme për të plotësuar nevojat e fëmijës suaj.

Hapi 4: Identifikimi i shërbimeve të nevojshme.

Ekipi i programit edukativ të individualizuar vendos se çfarë edukimi special dhe shërbime përkatëse do t'i sigurojë distrikti fëmijës suaj, sa shpesh dhe kush do t'i sigurojë ato. Kjo pjesë e programit edukativ të individualizuar duhet të përfshijë, kur konsiderohet e përshtatshme, vendndodhjen, ndryshimet, pajisjet dhe shërbimet ndihmëse teknologjike, si dhe një deklaratë se çfarë lloj ndihmash do të nevojiten për personelin shkollor. Ndihamat dhe shërbimet e shënuara në programin edukativ të individualizuar duhet të bazohen në kërkime shkencore që tregojnë se çfarë lloj ndihmash dhe shërbimesh në të vërtetë ndihmojnë fëmijët me paaftësi që të marrin pjesë dhe të përparojnë në programin e përgjithshëm mësimor dhe në aktivitete të tjera jashtëshkollore.

Hapi 5: Përcaktimi i mjedisit sa më pak kufizues (Least Restrictive Environment - LRE)

Ligji konsideron që vendi i mësimi për fëmijën tuaj është në fillim klasa e rregullt e mësimi ose mjedis tjetër i edukimit të përgjithshëm. Nëse ekipi përcakton se një mjedis tjetër është i nevojshëm për ndonjë shërbim që merr fëmija juaj, ekipi do t'ju tregojë pse fëmija juaj nuk mund të marrë pjesë në mjedisin e edukimit të përgjithshëm dhe se si mjedisi dhe aktivitetet e fëmijës suaj janë të ndryshme nga ato të fëmijëve pa paaftësi.

Si rishikohet dhe/ose ripunohet programi edukativ i individualizuar i fëmijës tim?

Ekipi i programit edukativ të individualizuar duhet ta rishikojë rregullisht programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj (të paktën një herë në vit), për të përcaktuar nëse fëmija juaj po i arrin qëllimet vjetore.

Ekipi i programit edukativ të individualizuar duhet ta rishikojë programin edukativ të individualizuar për:

- Ndonjë mangësi në përparimin e parashikuar për plotësimin e qëllimeve vjetore dhe në programin e përgjithshëm mësimor, nëse është e përshtatshme;
- Rezultatet e çdo rivlerësimi;
- Informacion për fëmijën tuaj që ju është dhënë juve ose është dhënë prej jush;
- Nevojat e parashikuara të fëmijës suaj; ose
- Çdo çështje tjetër që mund të dalë.

Çfarë ndodh para se fëmija im të mbushë moshën e rritur (18 vjeç në Ohio)?

Të paktën një vit para se fëmija të mbushë 18 vjeç, programi edukativ i individualizuar i fëmijës suaj duhet të përfshijë një deklaratë që thotë se fëmija juaj është informuar se të gjitha të drejtat do të transferohen nga ju tek ai ose ajo në moshën 18 vjeç.

SHËRBIMET E VITIT SHKOLLOR TË ZGJATUR

Çfarë janë shërbimet e vitit shkollor të zgjatur?

Shërbimet e vitit shkollor të zgjatur (Extended school year - ESY) janë shërbime të edukimit special dhe shërbime përkatëse që fëmija juaj me paaftësi mund t'i marrë mbas mbarimit të vitit normal shkollor 180-ditor.

Shërbimet e vitit shkollor të zgjatur ofrohen:

- Mbas mbarimit të vitit normal shkollor të distriktit shkollor;
- Në përputhje me edukimin special dhe shërbimet përkatëse të shënuara në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj;
- Pa pagesë për ju, prindin;
- Në përputhje me kërkesat e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio për shërbimet e vitit shkollor të zgjatur.

Kur duhet që distrikti shkollor t'i sigurojë fëmijës tim shërbime të vitit shkollor të zgjatur?

Distrikti shkollor duhet t'i vërë në dispozicion të fëmijës suaj shërbimet e vitit shkollor të zgjatur nëse ekipi i programit edukativ të individualizuar të fëmijës suaj vendos që shërbimet e vitit shkollor të zgjatur janë të nevojshme për të siguruar edukim publik falas të përshtatshëm për fëmijën tuaj.

Ekipi i programit edukativ të individualizuar duhet të marrë në konsideratë gjërat e mëposhtme kur merr vendimin e tij:

- A janë shërbimet e vitit shkollor të zgjatur të nevojshme në mënyrë që fëmija juaj të mos pësojë një humbje të madhe të aftësive ose humbje të madhe të njohurive?
- Kjo humbje e aftësive ose njohurive a do të ndikonte seriozisht në përparimin e fëmijës suaj drejt përmbushjes së qëllimeve të tij ose të saj edukative?
- A janë shërbimet e vitit shkollor të zgjatur të nevojshme për të shmangur humbjen e aftësive ose njohurive deri në atë masë sa fëmija juaj nuk mund t'i rifitojë ato në mënyrë të mjaftueshme?

Shërbimet e vitit shkollor të zgjatur mund të jenë të njëjta ose të ndryshme nga shërbimet e vitit shkollor të rregullt të fëmijës suaj. Kjo do të përcaktohet nga ekipi i programit edukativ të individualizuar. Disponueshmëria e shërbimeve të vitit shkollor të zgjatur nuk është automatike, vit mbas viti.

TRANSFERIMI I NXËNËSIT

Cilat janë kërkesat kur fëmija im transferohet nga njëri distrikt shkollor në tjetrin?

Kërkesat kur fëmija juaj transferohet nga njëri distrikt shkollor në një tjetër janë si më poshtë vijon:

Transferimi brenda shtetit Ohio:

Nëse fëmija juaj me paaftësi (që ka pasur një program edukativ të individualizuar, i cili ishte në fuqi në një distrikt të mëparshëm shkollor në Ohio)

- Transferohet në një distrikt të ri shkollor të vendbanimit në Ohio; dhe
- Regjistrohet në një shkollë të re brenda të njëjtit vit shkollor:

distrikti i ri shkollor i vendbanimit, në diskutime me ju, duhet të sigurojë një edukim publik falas të përshtatshëm (FAPE) për fëmijën tuaj (duke përfshirë shërbime përkatëse me ato të përshkruara në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj nga distrikti i mëparshëm shkollor) derisa distrikti i ri shkollor ose:

- Adopton programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj nga distrikti i mëparshëm shkollor; ose
- Krijon dhe vë në zbatim një program të ri edukativ të individualizuar që plotëson kërkesat e ligjit federal dhe shtetëror. Nëse distrikti i ri shkollor kryen një vlerësim, ky vlerësim konsiderohet si rivlerësim.

Transferimi nga jashtë shtetit Ohio:

Nëse fëmija juaj me paaftësi ka pasur një program edukativ të individualizuar në fuqi në një shtet tjetër dhe më pas:

- Transferohet në një distrikt të ri shkollor të vendbanimit në Ohio; dhe
- Regjistrohet në një shkollë të re brenda të njëjtit vit shkollor:

Distrikti i ri shkollor i vendbanimit, në diskutim me ju, duhet të sigurojë një edukim publik falas të përshtatshëm për fëmijën tuaj (duke përfshirë shërbime përkatëse me ato të përshkruara në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj nga distrikti i mëparshëm shkollor) derisa distrikti i ri shkollor:

- Kryen një vlerësim, nëse është e nevojshme; dhe
- Krijon dhe vë në zbatim një program të ri edukativ të individualizuar, nëse është e nevojshme, i cili plotëson kërkesat federale dhe shtetërore. Nëse distrikti shkollor kryen një vlerësim, ky vlerësim konsiderohet si vlerësim fillestar.

Kalimi (transferimi) i dokumentacionit nga distrikti shkollor i mëparshëm tek ai i ri:

Për të ndihmuar në ndryshimin e shkollës së fëmijës suaj:

- Shkolla e re ku regjistrohet fëmija juaj duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshme për t'i marrë shpejt dokumentet shkollore të fëmijës suaj nga shkolla e mëparshme e fëmijës; dhe
- Shkolla e mëparshme ku ishte regjistruar fëmija juaj duhet të ndërmarrë hapa të arsyeshme për t'iu përgjigjur në mënyrë të shpejtë kërkesës nga shkolla e re.
- Dokumentacioni që duhet transferuar duhet të përfshijë programin edukativ të individualizuar dhe dokumentet mbështetëse, si dhe të gjitha dokumentet e tjera të nevojshme për të siguruar edukim special ose shërbime përkatëse për fëmijën tuaj.

Nëse ju keni tarifa të papaguara në distriktin shkollor të mëparshëm, distrikti mund të mos ju japë notat dhe kreditet e fëmijës derisa të paguani tarifat. Megjithatë, distrikti i mëparshëm mund të mos i mbajë dokumentet e edukimit special të fëmijës suaj, duke përfshirë vlerësimin aktual dhe programin edukativ të individualizuar.

Çfarë ndodh nëse fëmija im transferohet në një distrikt të ri shkollor kur është në vlerësim e sipër?

Nëse fëmija juaj transferohet nga një distrikt shkollor në një tjetër gjatë të njëjtit vit shkollor, duhet t'i tregoni distriktit të ri shkollor që fëmija juaj po vlerësohej për një paaftësi të dyshuar në distriktin e vjetër shkollor dhe se ju dëshironi që ai vlerësim të vazhdojë të kryhet edhe këtu.

Distrikti i ri shkollor ose do të vazhdojë vlerësimin, ose do t'ju japë një njoftim paraprak me shkrim ku thuhet se nuk dyshon për ndonjë paaftësi dhe nuk do ta vazhdojë testimin.

Nëse nuk jeni dakord me vendimin e distriktit të ri shkollor, ju mund të filloni hapat e zgjidhjes së konfliktit me distriktin. (Shihni pjesën "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve").

TRANZICIONI

Çfarë do të thotë "tranzicion"?

Tranzicioni është procesi i aktiviteteve të planifikuara që mund të rezultojë në ndryshime të shërbimeve dhe personelit që i siguron këto shërbime. Aktivitetet e tranzicionit duhet të

ndodhin të paktën tri herë gjatë karrierës edukative të fëmijës:

- Kur fëmija kalon nga shërbimet e ndërhyrjes së hershme (lindja-2 vjeç) te shërbimet e edukimit special parashkollor (3-5 vjeç);
- Kur fëmija kalon nga shërbimet e edukimit special parashkollor në shërbimet e edukimit special të moshës shkollore (6-21 vjeç); dhe
- Kur fëmija kalon nga shërbimet e edukimit special të moshës shkollore në jetën e komunitetit (22 vjeç e lart).

(Shihni *Shërbimet e tranzicionit* në pjesën "Përkufizime").

Kalimi nga shërbimet e ndërhyrjes së hershme në shërbimet e edukimit special parashkollor.

Nëse fëmija juaj po merr shërbime të ndërhyrjes së hershme (në dispozicion për fëmijët nga lindja deri në 2 vjeç) dhe dikush dyshon se fëmija juaj mund të ketë një paaftësi dhe mund t'i përmbushë kushtet për shërbime të edukimit special parashkollor, atëherë duhet të ndodhin aktivitetet e mëposhtme:

- 120 ditë para ditëlindjes së tretë të fëmijës suaj, koordinatori i shërbimeve të ndërhyrjes së hershme të fëmijës suaj duhet të caktojë një mbledhje me ju për të diskutuar shërbimet e edukimit special parashkollor. Kërkohet miratimi juaj për t'i dhënë informacionin distriktit shkollor që ofron shërbime të edukimit special parashkollor.
- Nëse bini dakord që t'i jepni distriktit shkollor informacionin për fëmijën tuaj, ju dhe pjesëmarrësit e tjerë në mbledhje (ofruesit e shërbimeve të ndërhyrjes së hershme dhe personeli i distriktit shkollor) do të shqyrtoni dokumentacionin e fëmijës suaj dhe do të përcaktoni nëse dyshoni apo jo se fëmija juaj ka paaftësi.

Nëse dikush dyshon se fëmija juaj ka paaftësi, atëherë distrikti shkollor:

- Do t'ju informojë për të drejtat tuaja edukative dhe veprimet që mund të ndërmerri për t'i mbrojtur këto të drejta;
- Do të shkëmbejë informacion për shërbimet e edukimit special parashkollor;
- Do të marrë miratimin tuaj për të vlerësuar fëmijën tuaj;
- Do të përcaktojë nëse nevojitet informacion shtesë për vlerësimin; dhe
- Do të planifikojë vlerësimin e fëmijës suaj.

July 1, 2008

Vlerësimi fillestar (i parë) duhet të kryhet brenda 60 ditëve kalendarike mbasi t'i keni dhënë distriktit miratimin tuaj për vlerësim dhe programi i parë edukativ i individualizuar duhet të përfundohet 90 ditë mbasi t'i keni dhënë distriktit miratimin tuaj për të bërë vlerësimin. Nëse fëmija juaj i plotëson kushtet për shërbime parashkollore të edukimit special, programi edukativ i individualizuar duhet të jetë përpiluar brenda ditëlindjes së tretë të fëmijës.

Çfarë ndodh nëse fëmija im nuk i përmbush kushtet për shërbime të edukimit special parashkollor?

Nëse, mbas përfundimit të vlerësimit të ri, ekipi i IEP-së përcakton që fëmija juaj nuk ka nevojë për shërbime parashkollore të edukimit special, atëherë, me lejen tuaj, distrikti mund t'ju rekomandojë shërbime dhe programe të tjera të komunitetit që mund ta ndihmojnë fëmijën tuaj. Distrikti gjithashtu do t'ju dërgojë një njoftim paraprak me shkrim, ku përshkruhet e drejta juaj për të kundërshtuar vendimin e ekipit të IEP-së, nëpërmjet një ndërmjetësimi ose një ankese të procesit të rregullt ligjor dhe kërkesës për seancë dëgjimore. (Shihni pjesën e titulluar "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve").

Edhe nëse fëmija juaj nuk i plotëson kushtet për shërbime të edukimit special, në qoftë se fëmija juaj ka nevojë për njëfarë ndihme në klasën e rregullt, distrikti shkollor mund t'ia sigurojë këtë ndihmë. Një shembull do të ishte afrimi i tavolinës së fëmijës në krye të klasës nëse fëmija e ka të vështirë të përqendrohet.

Kalimi nga shërbimet e edukimit special parashkollor në shërbimet e edukimit special të moshës shkollore.

Nëse fëmija juaj ka marrë shërbime të edukimit special parashkollor dhe po mbush 6 vjeç, ekipi i programit edukativ të individualizuar do të kryejë një rivlerësim, i cili do të përfshijë:

- Një mbledhje për të përcaktuar shërbimet edukative të përshtatshme të moshës shkollore;
- Rishikimin e informacionit aktual nga programi edukativ i fëmijës suaj; dhe
- Rekomandimin e strategjive të mësimdhënies, të cilat do ta ndihmojnë fëmijën tuaj që të ketë sukses në programin e përgjithshëm mësimor.

Faqja 27

Nëse ekipi i programit edukativ të individualizuar përcakton se fëmija juaj ka nevojë për shërbime të edukimit special të moshës shkollore, atëherë ekipi i programit edukativ të individualizuar:

- Do të rishikojë të dhënat aktuale të vlerësimit (informacion që është më pak se një vit i vjetër);
- Do të përcaktojë dhe rekomandojë se çfarë informacion shtesë për vlerësimin do të jetë i nevojshëm, sipas rregullave të edukimit special të moshës shkollore; dhe
- Do të krijojë programin edukativ të individualizuar.

Nëse, mbas përfundimit të vlerësimit të ri, ekipi i IEP-së përcakton që fëmija juaj nuk ka nevojë për shërbime të edukimit special të moshës shkollore, atëherë, me lejen tuaj, distrikti mund t'ju rekomandojë shërbime dhe programe të tjera të komunitetit që mund ta ndihmojnë fëmijën tuaj. Distrikti gjithashtu do t'ju dërgojë një njoftim paraprak me shkrim, ku përshkruhet e drejta juaj për të kundërshtuar vendimin e ekipit të IEP-së, nëpërmjet një ndërmjetësimi ose një ankese të procesit të rregullt ligjor dhe kërkesës për seancë dëgjimore. (Shihni pjesën e titulluar "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve").

Edhe nëse fëmija juaj nuk i plotëson kushtet për shërbime të edukimit special, në qoftë se fëmija juaj ka nevojë për njëfarë ndihme në klasën e rregullt, distrikti shkollor mund t'ia sigurojë këtë ndihmë. Një shembull do të ishte afrimi i tavolinës së fëmijës në krye të klasës nëse fëmija juaj e ka të vështirë të përqendrohet.

Kalimi nga shërbimet e edukimit special të moshës shkollore në jetën e komunitetit.

Duke filluar nga periudha kur fëmija juaj është 14 vjeç (ose më i vogël nëse ekipi i programit edukativ të individualizuar përcakton se fëmija juaj ka nevojë për të), programi edukativ i individualizuar duhet të përfshijë:

- Informacion për nevojat e shërbimeve tranzitore, të cilat përqendrohen në kurset e studimit të fëmijës suaj (si p.sh. ndjekja e kurseve të përparuara ose e një programi edukativ profesional).

Duke filluar nga mosha 16 vjeç (ose më e vogël nëse ekipi i IEP-së përcakton se fëmija juaj ka nevojë për të), programi edukativ i individualizuar duhet të përfshijë:

- Qëllime të përshtatshme për fëmijën tuaj, bazuar në testimet dhe vlerësimet që kanë të bëjnë me trajnimin dhe edukimin që do t'i nevojiten fëmijës suaj për punësim dhe ndoshta për jetesë të pavarur mbas përfundimit të shkollës; dhe
- Shërbime tranzitore (duke përfshirë kurset e studimit) që janë të nevojshme për të ndihmuar fëmijën tuaj në arritjen e këtyre qëllimeve.

Aktivitetet tranzitore përfshijnë:

- Mësimdhënie;
- Shërbimet përkatëse;
- Përvojat e komunitetit;
- Krijimin e qëllimeve për punësim dhe aspekte të tjera të jetës passhkollore; dhe
- Nëse është e përshtatshme, fitimin e aftësive të jetës së përditshme dhe një vlerësim funksional profesional, një proces që vëren karakteristikat e punës së fëmijës suaj dhe nevojat për trajnim. (Shihni pjesën "Përkufizime").

Çfarë ndodh kur fëmija im merr diplomën e shkollës së mesme ose mbush moshën 22 vjeç?

Nëse fëmija juaj mbaron shkollën e mesme me diplomë të rregullt ose mbush moshën 22 vjeç, distrikti shkollor nuk është më i detyruar që të vërë në dispozicion të fëmijës suaj një edukim publik falas të përshtatshëm.

Mbarimi i shkollës së mesme me diplomë të rregullt ose mbushja e moshës 22 vjeçare konsiderohet si një ndryshim në vendosje (me fjalë të tjera, ndryshim në vendndodhjen e fëmijës suaj). Prandaj, distrikti shkollor duhet:

- T'ju japë juve ose fëmijës suaj një njoftim paraprak me shkrim; dhe
- T'i japë fëmijës suaj një përmbledhje të përparimit të tij apo të saj mësimor dhe të arritjeve funksionale. Kjo përmbledhje duhet të përfshijë rekomandime se si mund ta ndihmoni fëmijën tuaj që të arrijë qëllimet që janë vënë për periudhën mbas shkollës së mesme dhe që janë të përfshira në programin edukativ të individualizuar.

SHËNIM: Termi "diplomë e rregullt e shkollës së mesme" nuk përfshin diplomën alternative, si p.sh. certifikatën ose diplomën ekuivalente GED (General Education Development - Zhvillimi i përgjithshëm edukativ) që nuk i përmbush

plotësisht standardet mësimore të shtetit Ohio. GED-ja e shtetit Ohio nuk i përmbush plotësisht standardet e përmbajtjes mësimore. Prandaj, fëmija juaj me paaftësi, që ka marrë diplomën ekuivalente GED mund të rikthehet në shkollë për të marrë diplomën e rregullt të shkollës së mesme deri sa fëmija të mbushë moshën 22 vjeç.

DOKUMENTACIONI

A mund ta shikoj dokumentacionin shkollor të fëmijës tim?

Ju keni të drejtë të shikoni të gjithë dokumentacionin shkollor që ka të bëjë me fëmijën tuaj, që është mbledhur, ruajtur ose përdorur gjatë periudhës shkollore të fëmijës suaj nga:

- Distrikti shkollor; ose
- Çdo agjenci ose institucion tjetër pjesëmarrës (referuar në këtë pjesë si “agjencia”) (“Agjenci pjesëmarrës” do të thotë çdo agjenci ose institucion që mbledh, ruan ose përdor informacion që identifikon personin, ose prej së cilës është marrë informacion, sipas pjesës B të IDEA-s. Pjesa B ka të bëjë me fëmijët me paaftësi që janë 3-21 vjeç).

Kjo përfshin të gjithë dokumentacionin shkollor që ka të bëjë me fëmijën tuaj në lidhje me kualifikimin për shërbime të edukimit special dhe marrjen e shërbimeve të edukimit special dhe që ka të bëjë me sigurimin e edukimit publik të përshtatshëm falas për fëmijën tuaj.

Kur duhet të bjerë dakord distrikti shkollor ose agjencia me kërkesën time për të parë dokumentacionin shkollor të fëmijës tim?

Distrikti shkollor ose agjencia duhet të bjerë dakord me kërkesën tuaj për të parë dokumentacionin shkollor të fëmijës tuaj:

- Pa vonesë të panevojshme;
- Para ndonjë mbledhjeje për programin edukativ të individualizuar ose ndonjë seance dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose para mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; dhe
- Asnjëherë më vonë se 45 ditë mbas bërjes së kërkesës nga ana juaj.

Cilat janë të drejtat e mia specifike në lidhje me dokumentacionin shkollor të fëmijës tim?

July 1, 2008

E kujt është kjo IDEA? Udhëzues për prindërit në lidhje me ligjin e vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi

Të drejtat tuaja për të inspektuar dhe rishikuar dokumentacionin shkollor të fëmijës suaj përfshijnë sa më poshtë vijon:

- Ju keni të drejtë të merrni përgjigje nga distrikti shkollor ose agjencia në lidhje me kërkesa të arsyeshme për shpjegime të dokumentacionit;
- Ju keni të drejtën që përfaqësuesi juaj të inspektojë dhe rishikojë dokumentacionin shkollor; dhe
- Ju keni të drejtë të merrni kopje të dokumentacionit shkollor nëse mospasja e kopjeve do t’ju pengonte në inspektimin dhe rishikimin e dokumentacionit shkollor (për shembull, nëse jetoni larg nga shkolla ose nuk mund të shkoni atje personalisht).

Distrikti duhet të marrë miratimin tuaj para se t’u japë informacion personal të fëmijës suaj palëve të tjera që nuk janë zyrtarë të distrikteve shkollore ose agjencive, përveçse kur ka marrë lejen për ta bërë këtë pa miratimin tuaj, sipas ligjit 34 CFR pjesa 99, ligji për të drejtat edukative familjare dhe privatësinë (Family Educational Rights and Privacy Act - FERPA).

Miratimi prindëror, ose miratimi nga një fëmijë që i përmbush kushtet, i cili e ka mbushur moshën 18 vjeç, është i detyrueshëm në rastet e mëposhtme:

- Para se informacioni personal t’u jepet zyrtarëve të agjencive që sigurojnë ose paguajnë për shërbimet tranzitore; dhe
- Nëse fëmija juaj është regjistruar ose do të regjistrohet në një shkollë jopublike që nuk ndodhet në distriktin shkollor të vendbanimit, ju duhet të jepni miratimin tuaj para se informacioni personal nga dokumentacioni i fëmijës të shkëmbehet midis zyrtarëve në distriktin shkollor ku ndodhet shkolla jopublike dhe zyrtarëve në distriktin shkollor të vendbanimit. Ju gjithashtu duhet të jepni miratimin tuaj para se distrikti shkollor i vendbanimit ose distrikti shkollor ku ndodhet shkolla jopublike t’i japë informacion personal shkollës jopublike.

Informacioni personal përfshin, por nuk kufizohet vetëm tek:

- Emri i fëmijës suaj, emri juaj ose emri i një anëtarit tjetër të familjes;
- Adresa e fëmijës suaj;
- Një identifikues personal, si numri i sigurimeve shoqërore ose numri i nxënësit; dhe

Faqja 29

- Një listë e karakteristikave personale ose informacion tjetër që do të bënte të mundur që dikush ta identifikojë fëmijën tuaj me siguri të arsyeshme.

Distrikti shkollor ose agjencia mund të presupozojë se ju, prindi, keni autoritetin të inspektoni dhe shqyrtoni dokumentacionin e fëmijës suaj, përveç rastit kur distrikti shkollor ose agjencia është informuar që nuk keni autoritet sipas ligjit të shtetit Ohio, që mbulon çështje të tilla si kujdestaria, ndarja dhe divorci.

Nëse ndonjë pjesë e dokumentacionit shkollor përfshin informacion për më shumë se një fëmijë, ju keni të drejtë të inspektoni dhe shqyrtoni vetëm informacionin që ka lidhje me fëmijën tuaj ose të informoheni për atë informacion specifik.

Me kërkesën tuaj, distrikti shkollor ose agjencia duhet t'ju tregojë një listë të llojeve dhe vendndodhjeve të dokumentacionit shkollor të mbledhur, ruajtur ose përdorur nga distrikti ose agjencia.

Cila është përgjegjësia e përgjithshme e distriktit shkollor ose e agjencisë për mbrojtjen e dokumentacionit shkollor të fëmijës tim?

Distrikti shkollor ose agjencia duhet të mbrojë privatësinë e informacionit personal të fëmijës suaj gjatë gjithë kohës që ai mblidhet, ruhet, shkëmbehet me të tjerët ose shkatërrohet.

Përgjegjësia për sigurimin e privatësisë së këtij informacioni duhet t'i jepet një zyrtari të distriktit shkollor ose agjencisë. Distrikti shkollor ose agjencia duhet që gjithashtu të sigurojë trajnim mbi politikat dhe procedurat e shtetit për të gjithë personelin që mbledh ose përdor informacionin. Çdo distrikt ose agjenci duhet të ruajë për inspektim publik një listë aktuale të emrave dhe posteve të atyre punonjësve të distriktit ose agjencisë që mund të kenë kontakt me informacionin personal të nxënësit.

Distrikti shkollor ose agjencia duhet të dokumentojë se kush lejohet të shikojë dokumentacionin shkollor (përveç prindërve dhe punonjësve të autorizuar të distriktit shkollor ose të agjencisë). Ky dokumentim duhet të përfshijë emrin e palës, datën që pala u lejua të shikojë dokumentacionin dhe qëllimin për të cilin pala u lejua të përdorte dokumentacionin.

Cilat janë të drejtat e mia në lidhje me shkatërrimin e dokumentacionit ose informacionit shkollor?

Distrikti shkollor ose agjencia duhet t'ju informojë kur informacioni personal i fëmijës suaj nuk nevojitet më për t'i siguruar fëmijës suaj shërbime edukative.

Distrikti ose agjencia mund ta shkatërrojë informacionin personal të fëmijës suaj mbasi t'ju ketë informuar për këtë. Po ashtu, distrikti ose agjencia duhet ta shkatërrojë informacionin me kërkesën tuaj. Megjithatë, distrikti ose agjencia mund të mbajë pa kufizim kohor një dokumentim të përhershëm të emrit, adresës, numrit të telefonit, notave, regjistrimit të frekuentimit të nxënësit, klasat që ndoqi ai, klasën që ka përfunduar dhe vitin kur e përfundoi.

Si mund ta bëj korigjimin e dokumentacionit shkollor të fëmijës sim?

Nëse besoni se ndonjë informacion në dokumentacionin shkollor të fëmijës suaj është i pasaktë, mashtrues ose që shkel të drejtat e fëmijës suaj, mund t'i kërkonit distriktit shkollor ose agjencisë që mban informacionin që ta ndryshojë atë. Distrikti shkollor ose agjencia duhet të vendosë nëse do ta ndryshojë informacionin brenda një kohe të arsyeshme, mbas kërkesës suaj.

Çfarë është seanca dëgjimore për dokumentacionin?

Nëse distrikti shkollor ose agjencia refuzon ta ndryshojë informacionin sipas kërkesës suaj, ato duhet t'ju informojnë për këtë dhe gjithashtu t'ju informojnë se keni të drejtën e një seance dëgjimore për dokumentacionin. Seanca dëgjimore për dokumentacionin është një mbledhje ku ju jepet mundësia për të kundërshtuar informacionin në dokumentacionin shkollor të fëmijës suaj, nëse mendoni se nuk është i saktë, është mashtrues ose shkel privatësinë apo të drejtat e tjera të fëmijës suaj.

Mbas seancës dëgjimore për dokumentacionin, nëse distrikti shkollor ose agjencia bien dakord me ju, ato duhet ta ndryshojnë informacionin dhe t'ju njoftojnë me shkrim. Nëse distrikti shkollor ose agjencia nuk bien dakord me ju, ato duhet t'ju informojnë se ju keni të drejtë të fusni një deklaratë në dokumentacion. Deklarata përmban komentet tuaja për informacionin dhe

arsyet përse nuk jeni dakord me vendimin e distriktit shkollor ose agjencisë.

Kjo deklaratë do të vendoset në dokumentacionin shkollor të fëmijës suaj dhe distrikti shkollor ose agjencia duhet ta mbajë këtë deklaratë për aq kohë sa të mbahet dokumentacioni ose pjesa e dokumentacionit me të cilën nuk jeni dakord. Sa herë që dokumentacioni i fëmijës suaj ose pjesa me të cilën nuk bini dakord u jepet të tjerëve nga distrikti shkollor ose agjencia, atëherë aty duhet të përfshihet edhe deklarata juaj.

Cila është kostoja për rishikimin e dokumentacionit shkollor të fëmijës sim?

Distrikti shkollor ose agjencia nuk duhet t'ju kërkojë pagesë për kërkimin ose nxjerrjen e informacionit. Ata mund t'ju kërkojnë që të paguani një tarifë për kopje të dokumentacionit, përderisa tarifa nuk ju pengon që të jeni në gjendje të ushtroni të drejtën tuaj për të inspektuar dhe shqyrtuar dokumentacionin e fëmijës suaj.

Të drejtat e mia për të parë dokumentacionin e fëmijës tim a i transferohen fëmijës tim më vonë?

Kur fëmija juaj të mbushë 18 vjeç, distrikti shkollor do të sigurojë që të gjitha të drejtat në lidhje me dokumentacionin shkollor të transferohen nga ju te fëmija juaj. Këto të drejta nuk do t'i transferohen fëmijës suaj nëse fëmija është përcaktuar si jokompetent në bazë të ligjit shtetëror. (Kjo do të thotë që fëmija nuk kualifikohet që të kujdeset për veten). Ju dhe fëmija juaj duhet të njoftoheni për çdo transferim të të drejtave.

Megjithatë, nëse distrikti shkollor mëson se gjykata ka caktuar një kujdestar ligjor për fëmijën tuaj me paaftësi, atëherë distrikti e emëron kujdestarin që të përfaqësojë interesat edukative të fëmijës suaj derisa fëmija të mbushë 22 vjeç, nëse fëmija juaj nuk është nën tutelën e shtetit.

SHËNIM: Edhe mbasi të drejtat tuaja prindërore i janë transferuar fëmijës suaj, distrikti shkollor duhet të vazhdojë t'ju japë të njëjtat njoftime të masave mbrojtëse procedurale që duhet t'i japë fëmijës suaj. Kjo përfshin një kopje të këtij udhëzuesi "E kujt është kjo IDEA/"; njoftim paraprak me shkrim; dhe të gjitha njoftimet e

July 1, 2008

ankesave të procesit të rregullt ligjor që kanë të bëjnë me fëmijën tuaj.

ZGJIDHJA E KONFLIKTEVE DHE SHQETËSIMEVE

Nëse kam pyetje ose shqetësime për edukimin e fëmijës tim, kë duhet të kontaktoj?

Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio ka përgjegjësi për të siguruar që fëmijët me paaftësi të marrin një edukim publik falas të përshtatshëm (FAPE) në mjedis sa më pak kufizues, siç kërkohet nga Ligji i vitit 2004 për përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (IDEA) dhe nga rregullat federale, ligji shtetëror dhe rregullat shtetërore përkatëse.

"Mjedisi sa më pak kufizues" do të thotë që sa herë që të jetë e mundur, distrikti ose agjencia do ta edukojë fëmijën tuaj në klasën e rregullt ose në mjedisin e përgjithshëm edukativ.

Nëse keni ndonjë pyetje ose shqetësim në lidhje me edukimin e fëmijës suaj me paaftësi ose dyshoni se fëmija juaj mund të ketë paaftësi, në fillim duhet të kontaktoni distriktin lokal shkollor ku ndjek shkollën fëmija juaj. Diskutojini shqetësimet tuaja me mësuesin e fëmijës, drejtorin e shkollës dhe anëtarin e personelit që ka përgjegjësi për edukimin special.

Organizatat e tjera që mund t'ju ndihmojnë janë:

- Ekipet e Ndihmës të Shtetit Ohio (Ohio's State Support Teams – SST)
Distrikti juaj shkollor lokal ka adresën dhe numrin e telefonit të SST-së më afër jush.
- Koalicioni i Shtetit Ohio për Edukimin e Fëmijëve me Paaftësi (Ohio Coalition for the Education of Children with Disabilities)
Bank One Building
165 W. Center Street, Suite 302
Marion, OH 43302-3741
(800) 374-2806
- Ohio Legal Rights Service (Shërbimet për të Drejtat Ligjore të Shtetit Ohio)
50 W. Broad Street, Suite 1400
Columbus, OH 43215-5923
(800) 282-9181 ose (614) 466-7264
- (Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio)
Procedural Safeguards Section (Sektori i Masave Mbrojtëse Procedurale)
Office for Exceptional Children (Zyra për Fëmijët e Veçantë)
25 South Front St., Mail Stop 202

Faqja 31

Columbus, Ohio 43215-4183
Telefon (614) 466-2650
Telefon falas i ODE-së (Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio): (877) 644-6338
Faks: (614) 728-1097

Çfarë ndodh nëse distrikti shkollor dhe unë nuk biem dakord në lidhje me kualifikimin e fëmijës tim për shërbime të edukimit special ose marrjen e shërbimeve të edukimit special?

Shumë mosmarrëveshje mund të zgjidhen nëpërmjet komunikimit me mësuesin e fëmijës, drejtorin e shkollës ose personel tjetër të distriktit shkollor.

Gjithashtu ekzistojnë procedura për "zgjidhjen e mosmarrëveshjeve" të vendosura nga ligji federal ose shtetëror për t'ju ndihmuar që shqetësimet tuaja t'ia adresoni distriktit shkollor. Këto procedura janë shënuar në pikat e mëposhtme dhe secila nga procedurat përcaktohet dhe shpjegohet në faqet e mëposhtme.

- Konferenca e çështjes
- Rishikimi administrativ
- Ndërmjetësimi
- Arbitrimi i programit edukativ të individualizuar (IEP)
- Procedurat e ankesave shtetërore
- Seanca dëgjimore e paanshme e procesit të rregullt ligjor; dhe
- Arbitrimi i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, para seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor

Është më mirë që në fillim të bëhen përpjekje për t'i zgjidhur mosmarrëveshjet në nivel distrikti duke i diskutuar shqetësimet tuaja me anëtarët e personelit të distriktit në konferencat e çështjes dhe rishikimet administrative (diskutime me një anëtar të personelit shkollor ose me shefin e distriktit tuaj shkollor).

Megjithatë, mund të vendosni që të shkoni direkt te procedurat e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në shkallë shteti, si p.sh. ndërmjetësimi, arbitrimi i IEP-së, ankesa shtetërore, seanca dëgjimore e paanshme e procesit të rregullt ligjor ose arbitrimi i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Këto mundësi në nivel lokal dhe shtetëror mund t'i përdorë edhe distrikti shkollor.

Kush mund të paraqesë ankesë ose kërkesë për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor? Çfarë çështjesh mund të ngrihen dhe të zgjidhen nga paraqitja e ankesës dhe çfarë çështjesh mund të ngrihen dhe të zgjidhen nga kërkesa për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor?

Ndryshimet janë si më poshtë vijon:

Ankesat:

- Çdo palë (duke përfshirë prindërit dhe distriktin shkollor ose agjencinë) mund të paraqesë ankesë zyrtare me shkrim.
- Çdo palë mund të pretendojë se është bërë shkelje sipas ligjeve ose rregullave të IDEA-s ose ligjeve të edukimit special të shtetit Ohio.
- Çdo palë mund të ngrejë shqetësime në lidhje me kualifikimin e një fëmije të veçantë për shërbime të edukimit special ose marrjen e shërbimeve të edukimit special sipas ligjit ose rregullave të IDEA-s ose ligjeve të edukimit special të shtetit Ohio. Çështjet mund të ngrihen në një ankesë për një sistem edukimi special që ndikon në më shumë se një fëmijë me paaftësi.

Seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor:

- Prindi ose agjencia publike mund të bëjë kërkesë për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor.
- Prindi ose agjencia publike (duke përfshirë distriktin shkollor) mund të pretendojë se është bërë shkelje sipas ligjit të IDEA-s ose ligjit të edukimit special të shtetit Ohio.
- Prindi ose agjencia publike mund të ngrenë shqetësime në lidhje me kualifikimin e një fëmije për shërbime të edukimit special ose marrjen e shërbimeve të edukimit special sipas ligjit të IDEA-s ose ligjit të edukimit special të shtetit Ohio.
- Prindi mund të ngrejë shqetësime vetëm për fëmijën e vet, por nuk mund të ngrejë shqetësime në lidhje me praktikatat e sistemit të edukimit special që përfshijnë fëmijë të tjerë.
- Agjencia publike mund të ngrejë shqetësime për një fëmijë të veçantë, por nuk mund të ngrejë shqetësime në lidhje me praktikatat e sistemit të edukimit special që përfshijnë fëmijë të tjerë.

Konferenca e çështjes

Konferenca e çështjes është një bisedë jozyrtare që ju jep juve dhe distriktit shkollor mundësinë

për të diskutuar dhe zgjidhur çështje në lidhje me sigurimin e shërbimeve të përshtatshme edukative për fëmijën tuaj. Nëse dëshironi të bëni një konferencë çështjesh me mësuesin e fëmijës suaj ose me anëtarët e tjerë të personelit shkollor, telefononi drejtorin e shkollës ku është regjistruar fëmija juaj.

Rishikimi administrativ

Ju keni të drejtë të paraqisni ankesa te shefi i distriktit shkollor në lidhje me vlerësimin dhe vendosjen e fëmijës suaj, si dhe në lidhje me marrjen e shërbimeve të përshtatshme edukative për fëmijën tuaj. Rishikimi administrativ përfshin procesin e mëposhtëm:

- *Brenda 20 ditëve nga marrja e ankesës suaj:* shefi (ose dikush që cakton shefi): 1) do të drejtojë rishikimin pa vonesë të panevojshme; 2) mund të mbajë një seancë dëgjimore administrative; dhe 3) do të njoftojë me shkrim të gjitha palët në lidhje me vendimin.
- Rishikimi do të kryhet në një kohë dhe vend të përshtatshëm për të gjitha palët.
- Shefi duhet ta kryejë rishikimin dhe mund të mbajë një seancë dëgjimore administrative.
- Duhet bërë çdo përpjekje për zgjidhjen e çfarëdolloj mosmarrëveshjeje në rishikimin administrativ.
- Ju dhe distrikti shkollor keni të drejtë të ftoni persona të tjerë për të marrë pjesë në rishikimin administrativ, duke përfshirë avokatët tuaj.

NDËRMJETËSIMI

Çfarë është ndërmjetësimi?

Ndërmjetësimi është një proces vullnetar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis dy palëve. Në mënyrë që të ndodhë ndërmjetësimi, të dyja palët duhet të bien dakord për të bërë marrëveshje ose për të zgjidhur shqetësimet e tyre. Procesi i ndërmjetësimit drejtohet nga një palë e tretë asnjënjëse, e trajnuar, e quajtur ndërmjetës, i cili i ndihmon palët e tjera të ngrenë shqetësimet e tyre dhe të arrijnë një zgjidhje që është e pranueshme nga të dyja palët.

Cilat janë përfitimet e ndërmjetësimit?

- Prindërit dhe drejtuesit e distriktit shkollor e krijojnë së bashku marrëveshjen

përfundimtare në vend që t'i lihet në dorë një individ të jashtëm.

- Palët punojnë së bashku dhe janë në kontroll të rezultateve.
- Marrëveshja e arritur nga të dyja palët rezulton në kënaqësi më të madhe për të gjitha palët.
- Ndërmjetësimi u jep mundësi palëve që t'i kuptojnë pikëpamjet e ndryshme.
- Ndërmjetësimi kushton më pak dhe mosmarrëveshjet zgjidhen më shpejt në këtë mënyrë se sa nëpërmjet seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose nëpërmjet procedurave të gjykatës.
- Shpesh kur marrëveshjet me shkrim arrihen nëpërmjet ndërmjetësimit, ka më shumë të ngjarë që palët ta zbatojnë marrëveshjen.

Kur është në dispozicion ndërmjetësimi?

Ndërmjetësimi është në dispozicion në situatat e mëposhtme:

- Sa herë që ju ose distrikti shkollor keni shqetësime në lidhje me sigurimin e edukimit special dhe shërbimeve përkatëse për fëmijën tuaj. Mund të kërkonti ndërmjetësim menjëherë pa paraqitur ankesë zyrtare me shkrim dhe pa paraqitur kërkesë për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor.
- Kur paraqisni ankesë zyrtare me shkrim ose kërkesë për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Zyra për Fëmijët e Veçantë do të ofrojë ndërmjetësim për të dyja palët.
- Ndërmjetësimi sigurohet falas për të dyja palët. Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio paguan për procesin e ndërmjetësimit, duke përfshirë kostot e mbledhjeve dhe kohën e ndërmjetësit. Megjithatë, palët paguajnë çdo kosto individuale, duke përfshirë kostot e ndonjë avokati që vendosin të përdorin.
- Kur të dyja palët kanë rënë dakord që të marrin pjesë në ndërmjetësim, Zyra për Fëmijët e Veçantë u jep palëve mundësinë që të zgjedhin një ndërmjetës.
- Mbasi të zgjidhet ndërmjetësi, ai do të kontaktojë të dyja palët për të caktuar datën, kohën dhe vendin e ndërmjetësimit.

Çfarë duhet të di në lidhje me ndërmjetësimin?

Pikat e mëposhtme në lidhje me ndërmjetësimin kanë rëndësi që të dihen:

- Pjesëmarrja në ndërmjetësim bëhet në baza vullnetare për të dyja palët.
- Ndërmjetësimi nuk mund të përdoret për të mohuar ose vonuar të drejtën tuaj për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose për ndonjë të drejtë tjetër sipas IDEA-s.
- Diskutimet që mbajnë palët gjatë procesit të ndërmjetësimit duhet të mbahen private dhe nuk duhet të përdoren si fakte në ndonjë seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose në veprimet e gjykatës që mund të pasojnë ndërmjetësimin.
- Asnjë pjesë e ndërmjetësimit nuk mund të regjistrohet në mënyrë elektronike.
- Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio mban një listë të ndërmjetësve të kualifikuar, të cilët kanë njohuri të ligjeve dhe rregullave në lidhje me sigurimin e edukimit special dhe shërbimeve përkatëse.
- Ndërmjetësi nuk duhet të jetë punonjës i Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio ose i distriktit shkollor që është i përfshirë në edukimin ose kujdesin e fëmijës.
- Një person që është kualifikuar të jetë ndërmjetës nuk është punonjës i distriktit shkollor ose Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio vetëm mbi bazën se ai ose ajo paguhet nga agjencia për të shërbyer si ndërmjetës.
- Edhe ju, edhe distrikti shkollor duhet të angazhoheni në zgjedhjen e ndërmjetësit dhe duhet të bini dakord për zgjedhjen.
- Ndërmjetësi nuk duhet të ketë ndonjë interes personal ose profesional që do të bënte që ai të favorizonte një palë më shumë se tjetrën.
- Ndërmjetësi nuk mund të thirret si dëshmitar në aktivitete të ardhshme që kanë lidhje me sesionet e ndërmjetësimit.
- Çdo sesion në procesin e ndërmjetësimit duhet të caktohet pa vonesë dhe duhet të mbahet në vendndodhje që janë të përshtatshme për të gjitha palët.
- Distrikti shkollor ose agjencia e përfshirë në mosmarrëveshje duhet të dërgojë një përfaqësues që ka autoritet për të premtuar burime ndihmash.
- Nëse ju dhe distrikti shkollor e zgjidhni mosmarrëveshjen tuaj nëpërmjet ndërmjetësimit, palët duhet të hyjnë në një marrëveshje ligjore që përvijon zgjidhjen dhe ju bën që t'i qëndroni besnik pjesës suaj të marrëveshjes. Secila palë duhet të marrë një kopje të nënshkruar të marrëveshjes së ndërmjetësimit në fund të mbledhjes.
- Nëse arrihet një marrëveshje, distrikti shkollor dhe prindi do të vënë në veprim të gjitha kushtet e marrëveshjes.
- Nëse marrëveshja e ndërmjetësimit kërkon ndonjë ndryshim në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj, atëherë një mbledhje e IEP-së duhet mbajtur brenda 20 ditëve nga nënshkrimi i marrëveshjes ose për aq kohë sa është rënë dakord në ndërmjetësim.
- Nëse kërkuat seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose paraqitët ankesë zyrtare me shkrim dhe më pas gjatë ndërmjetësimit arrihet një marrëveshje për të gjitha çështjet, ju duhet ta tërhiqni kërkesën tuaj për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose kërkesën për hetimin e ankesës.

A i vë marrëveshja e ndërmjetësimit të dyja palët para detyrimit ligjor që t'u qëndrojnë besnike premtimeve të tyre?

Nëse mosmarrëveshja zgjidhet nëpërmjet procesit të ndërmjetësimit, palët do të përgatisin një dokument me shkrim ku përvijohet marrëveshja. Secila palë do të jetë e zbuluar ndaj gjyqit kundër tyre, nëse thyhet marrëveshja. Dokumenti gjithashtu:

- Thekson se të gjitha diskutimet që ndodhën gjatë procesit të ndërmjetësimit duhet të mbahen private dhe nuk duhet të përdoren si fakte në ndonjë seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose në veprime të ngjashme të gjykatës që mund të pasojnë ndërmjetësimin.
- Nënshkruhet si nga prindi, ashtu edhe nga përfaqësuesi i agjencisë që ka autoritet të marrë zotim në emër të agjencisë; dhe
- Mund të detyrohet për t'u zbatuar në çdo gjykatë të përshtatshme në Shtetet e Bashkuara.

SHËNIM: Distrikti shkollor mund të ofrojë mënyra të tjera të zgjidhjes së konflikteve për prindërit dhe shkollat që vendosin të mos përdorin procesin e ndërmjetësimit. Këto procedura mund t'u japin prindërve dhe shkollave mundësi për t'u takuar me një individ asnjans, që ka kontratë me Qendrën e Trajnimit të Prindërve dhe Informacionit të Shtetit Ohio ose me ndonjë organizatë tjetër të përshtatshme. (Shihni pjesën "Zgjidhja e konflikteve dhe shqetësimeve"). Ky person shpjegon përfitimet e procesit të ndërmjetësimit dhe i nxit prindërit që ta përdorin atë. Ministria

e Arsimit e Shtetit Ohio do të marrë përsipër koston e kësaj mbledhjeje. Distrikti shkollor nuk mund të mohojë ose vonojë të drejtën e prindit për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor nëse prindi nuk merr pjesë në këtë mbledhje.

A mund të më kthehen paratë që pagova për tarifat e avokatit për ndërmjetësimin?

Ju mbani përgjegjësi për pagesën e tarifave të avokatit tuaj, përveç rastit kur marrëveshja e ndërmjetësimit thekson se distrikti shkollor mban përgjegjësi për tarifat e avokatit tuaj.

Si të kërkoj ndërmjetësim ose marr informata shitesë për ndërmjetësimin?

Për të kërkuar ndërmjetësim, kontaktoni: Ministrinë e Arsimit të shtetit Ohio (Ohio Department of Education) Zyrën për Fëmijët e Veçantë (Office for Exceptional Children) Sektorin e Masave Mbrojtëse Procedurale (Procedural Safeguards Section) *Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.*

ARBITRIMI I IEP-SË

Çfarë është arbitrimi i IEP-së?

Kur një ndërmjetësi asnjans të edukimit special, që ka marrë trajnim të specializuar për zhvillimin e programeve edukative të individualizuara i kërkohet që të ndihmojë anëtarët e ekipit të IEP-së për të krijuar një program edukativ të individualizuar për një fëmijë, atëherë ky quhet arbitrim i IEP-së. "Arbitri" ndihmon që të hapet komunikimi mes anëtarëve të ekipit, drejton diskutimin dhe ndihmon ekipin që të zgjidhë mosmarrëveshjet. Arbitri nuk merr vendime, por ndihmon anëtarët e ekipit që t'i gjejnë vetë zgjidhjet.

Si e kërkoj arbitrimin e IEP-së?

Për të kërkuar arbitrimin e IEP-së, kontaktoni: Ministrinë e Arsimit të shtetit Ohio (Ohio Department of Education) Zyrën për Fëmijët e Veçantë (Office for Exceptional Children) Sektorin e Masave Mbrojtëse Procedurale (Procedural Safeguards Section) *Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.*

Në mënyrë që të ndodhë ndihma e IEP-së, edhe distrikti shkollor, edhe ju duhet që të merrni

July 1, 2008

pjesë vullnetarisht. Zyra për Fëmijët e Veçantë do t'ju ndihmojë që të kontaktoni distriktin shkollor për të parë nëse është i interesuar në arbitrimin e IEP-së.

PROCEDURAT E ANKESAVE

Mund të kërkonit informacion me telefon, letër, email ose faks në Zyrën për Fëmijët e Veçantë në lidhje me:

- Procedurat e ankesave;
- Kopje të rregullave dhe normave;
- Më shumë informacion rreth një çështjeje; ose
- Ndihmën për gjetjen e personit të duhur për të biseduar me të në një distrikt, agjenci ose organizatë.

Këto kontakte për informacion të përgjithshëm, të quajtura kërkesa të përgjithshme, nuk konsiderohen si ankesa.

Mund të kërkonit të dhëna për edukimin publik të një fëmije me paaftësi në Ministrinë e Arsimit të Shtetit Ohio në adresën e mëposhtme:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.

Çfarë bën procesi i ankesës?

Procesi i ankesës siguron një zgjidhje për shkeljet e ligjit të vitit 2004 për përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (IDEA) dhe ligjin e standardet vepruese të shtetit Ohio.

Ky proces lejon që ankesat të zgjidhen shpejt pa ndonjë shpenzim si për prindin, ashtu edhe për distriktin shkollor. Gjithashtu, procesi i ankesës mund të jetë më pak kontradiktore se seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor.

Cila është rregullorja federale që i jep autoritet shtetit për të pasur një proces ankimi?

Autoriteti për shqyrtimin e ankesave nga një agjenci shtetërore jepet nga rregullorja federale, kodi 34 i rregullores federale (C.F.R.) §300.151-§300.153 *Adoptimi i procedurave shtetërore për ankesat.*

Si dhe ku e paraqes ankesën?

Ankesa me shkrim duhet të ketë një nënshkrim origjinal (jo fotokopje ose të stampuar) të palës ankuese dhe duhet të dërgohet tek:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
25 South Front Street
Mail Stop 202
Columbus, OH 43215-4183
Telefon: (614) 466-2650
Falas: 1-877-644-6338;

Zyra për Fëmijët e Veçantë nuk pranon:

- Ankesa të dërguara me faks;
- Ankesa të dërguara me email; ose
- Ankesa anonime.

A më duhet t'ia çoj ankesën time distriktit?

Po. Në bazë të rregullit federal 34 CFR §300.153(c), pala që bën ankesën (e njohur si ankuesi) duhet t'i dërgojë një kopje të ankesës shefit të distriktit shkollor kundër të cilit është paraqitur ankesa.

Çfarë duhet të përfshijë ankesa ime?

Ankesa duhet të përfshijë:

- Një deklaratë ku thuhet se distrikti shkollor publik ka shkelur një kërkesë të ligjeve federale dhe/ose shtetërore, si dhe/ose rregulla që kanë të bëjnë me edukimin special;
- Faktet mbi të cilat e bazoni ankesën tuaj. ("Fakti" përkufizohet si një ngjarje e vërtetë ose diçka që ka ndodhur në të vërtetë. Kjo përfshin një shpjegim të çështjes dhe datën se kur ndodhi çështja);
- Nënshkrimin origjinal të ankuesit dhe informacionin e kontaktit;
- Një zgjidhje të propozuar të problemit. Lutemi vini re se zgjidhja juaj e propozuar do të merret në konsideratë. Megjithatë, zgjidhja përfundimtare e ankesës do të përcaktohet nga Zyra për Fëmijët e Veçantë e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio (OEC);
- Nëse keni bërë ankesë për shkelje në rastin e një fëmije specifik ose të një grupi fëmijësh, gjithashtu përfshini:
 1. Emrin ose emrat e fëmijëve të përfshirë në ankesë;
 2. Adresën e fëmijës;

3. Adresën e personit që paraqet ankesat (nëse është e ndryshme nga adresa e fëmijës);

4. Në rastin e një fëmije ose të riu të pastrehë, përfshini informacion kontakti të disponueshëm për fëmijën (kur fëmija e plotëson përkufizimin e fëmijës së pastrehë që përcaktohet në paragrafin federal 725(2) të ligjit McKinney-Vento (42 U.S.C. 11434a(2)) për ndihmën për të pastrehët ; dhe

5. Emrin e shkollës që po ndjek fëmija;

- Ankesa duhet të jetë për një shkelje që ka ndodhur jo më shumë se një vit para datës kur merret ankesa; dhe
- Pala që paraqet ankesën duhet t'i dërgojë një kopje të ankesës distriktit për të cilin është bërë ankesa, në të njëjtën kohë që pala paraqet ankesën te Zyra për Fëmijët e Veçantë.

Çfarë është mjaftueshmëria?

Në mënyrë që një ankesë të hetohet, ankesa duhet të përmbajë informacionin e shënuar nën pyetjen e mësipërme "Çfarë duhet të përfshijë ankesa ime?" Nëse ankesa juaj nuk e përfshin të gjithë këtë informacion, Zyra për Fëmijët e Veçantë mund ta konsiderojë të gjithë ankesën ose një pjesë të saj si "të pamjaftueshme".

Çfarë ndodh nëse e gjithë ankesa ime konsiderohet si e pamjaftueshme?

Nëse e gjithë ankesa juaj konsiderohet e pamjaftueshme, ankesa nuk do të hetohet dhe një "letër pamjaftueshmërie" do t'ju dërgohet së bashku me një shpjegim se pse nuk do të hetohet e gjithë ankesa. Letra do t'ju tregojë çfarë duhet të ndryshoni ose shtoni në ankesë, në mënyrë që Zyra për Fëmijët e Veçantë ta pranojë ankesën tuaj për hetim.

Mbasi të merrni letrën e pamjaftueshmërisë, ju mund të përfshini informacionin që mungonte dhe ta paraqisni përsëri ankesën. Ankesa e riparaqitur duhet të jetë për një shkelje që ka ndodhur jo më shumë se një vit para datës kur ankesa e riparaqitur është marrë nga Zyra për Fëmijët e Veçantë.

Çfarë ndodh nëse vetëm një pjesë e ankesës sime konsiderohet si e pamjaftueshme?

Vetëm një pjesë e ankesës suaj mund të konsiderohet si e pamjaftueshme në qoftë se i mungon një fakt ose ndonjë element tjetër.

Nëse ankesës suaj, qoftë tërësisht apo pjesërisht, i mungon një fakt, atëherë ankesa do të konsiderohet e pamjaftueshme për atë çështje që ka të bëjë direkt me faktin që mungon. Pjesa e ankesës që nuk përfshin faktin nuk do të hetohet. Nëse ankesa përfshin çështje të tjera për të cilat janë dhënë fakte, ato çështje do të hetohen, nëse çështja është brenda autoritetit të Zyrës për Fëmijët e Veçantë.

Çfarë ndodh nëse ankesës sime i mungon një element dhe jo një fakt?

Nëse ankesës suaj i mungon ndonjë nga të dhënat e shënuara këtu:

- emri i fëmijës;
- adresa e fëmijës;
- adresa e personit që paraqet ankesën (nëse është e ndryshme nga adresa e fëmijës);
- informacioni i kontaktit; ose
- emri i shkollës që po ndjek fëmija,

atëherë, këshilltari edukativ do të kontaktojë ankuesin për t'i thënë se një apo më shumë nga të dhënat e shënuara më lart mungon. Atëherë ankuesi do të ketë pesë ditë afat (nga koha e kontaktit me këshilltarin edukativ) për t'i dërguar informacionin e nevojshëm këshilltarit edukativ. Ankuesi do t'ia dërgojë informacionin me shkrim këshilltarit edukativ, i cili do të hetojë ankesën. Nëse elementi që mungon nuk i dërgohet këshilltarit edukativ brenda pesë ditëve, ankesa nuk do të hetohet.

Nëse nuk e kuptoj pse nuk do të hetohet ankesa ime ose nëse kam nevojë për ndihmë për ta rregulluar ankesën, kush mund të më ndihmojë?

Agjencitë që mund t'ju ndihmojnë janë:

- Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio (ODE); Sektori i Masave Mbrojtëse Procedurale i Zyrës për Fëmijët e Veçantë;
- Koalicioni i Shtetit Ohio për Edukimin e Fëmijëve me Paaftësi (OCECD); dhe
- Shërbimet e të Drejtave Ligjore të Shtetit Ohio (OLRS)

Kush vendos se cili ligj, normë ose rregull mund të jetë shkelur?

Zyra për Fëmijët e Veçantë do të përcaktojë se cili ligj pretendohet se është shkelur dhe se cili ligj, normë ose rregull do të referohet në hetim.

Si do ta marr vesh që Zyra për Fëmijët e Veçantë e ka marrë ankesën time?

Brenda pesë ditësh pune nga dita kur Zyra për Fëmijët e Veçantë merr ankesën me shkrim dhe të nënshkruar, ajo do t'i dërgojë një letër njoftuese personit që ka paraqitur ankesën. Zyra gjithashtu do t'ia dërgojë letrën edhe palëve të mëposhtme, nëse janë të ndryshme nga personi që paraqiti ankesën:

- Prindit/kujdestarit;
- Nxënësit, nëse nxënësi ka mbushur moshën 18 vjeç; ose
- Shefit të distriktit shkollor.

Çfarë përfshin letra e njoftimit?

Letra e njoftimit do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Njoftimin e datës që Zyra për Fëmijët e Veçantë ka marrë ankesën;
- Identifikimin e informacionit të kontaktit për këshilltarin edukativ të caktuar për të hetuar ankesën;
- Njoftim në lidhje me mundësinë që kanë palët, ose, nëse është e përshtatshme, një palë e tretë ankuese për të dhënë informacion shtesë;
- Njoftimin që një letër rezultatesh do të dërgohet brenda 60 ditëve kalendarike nga data që Zyra për Fëmijët e Veçantë merr ankesën, përveç rastit kur është shtyrë afati. Në këtë rast, letra e rezultateve do të dërgohet në datën e caktuar në letrën e shtyrjes së afatit.
- Njoftimin që ankesa është "mbajtur pezull" (gjendje pritjeje), në pritje të rezultateve të një seance dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Në këtë rast, afati 60-ditor do të fillojë (a) në datën që zyrtari i seancës dëgjimore jep vendimin e vet dhe Zyra për Fëmijët e Veçantë përcakton se vendimi i zyrtarit të seancës dëgjimore nuk adreson të gjitha çështjet e ankesës; ose (b) me tërheqjen ose anulimin e kërkesës së procesit të rregullt ligjor; dhe
- Njoftimin për mundësinë që kanë palët të angazhohen në ndërmjetësimin e ankesës.

SHËNIM: Nëse ndonjëra palë përfaqësohet nga një avokat, do të jetë përgjegjësia e avokatit për të komunikuar me këshilltarin edukativ dhe për

të kërkuar që avokatit t'i dërgohen kopjet e të gjithë korrespondencës.

A mundet që distrikti t'i ofrojë një propozim prindit për ta zgjidhur ankesën para se Zyra për Fëmijët e Veçantë të dërgojë letrën e rezultateve?

Po, distrikti mund t'i ofrojë prindit një propozim për të zgjidhur ankesën para se të dërgohet letra e rezultateve.

A mundet që palët e përfshira në ankesë t'i ndërmjetësojnë çështjet e ankesës duke përdorur ndërmjetësit e Zyrës për Fëmijët e Veçantë?

Po, nëse ju jeni prindi ose distrikti shkollor apo agjenci tjetër publike dhe dëshironi t'i ndërmjetësoni çështjet që janë në ankesën tuaj duke përdorur një ndërmjetës të Zyrës për Fëmijët e Veçantë, lutemi njoftoni këshilltarin edukativ të caktuar për ankesën.

Çfarë ndodh gjatë hetimit të ankesës?

Zyra për Fëmijët e Veçantë duhet të kryejë hetim të ankesës, i cili duhet të përfshijë një shqyrtim të të gjithë dokumentacionit përkatës dhe mund të përfshijë një hetim në vendin e ngjarjes.

Letra e rezultateve do të dërgohet brenda 60 ditëve kalendarike nga data që Zyra për Fëmijët e Veçantë merr ankesën me shkrim dhe të nënshkruar. Sipas ligjit 34 CFR §300.152 (b)(1), Zyra për Fëmijët e Veçantë mund ta shtyjë afatin, atëherë kur vendos se ekzistojnë rrethana të veçanta që justifikojnë vonesën. Këto rrethana të veçanta mund të përfshijnë ndërmjetësimin ose mënyra alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Rrethanat e veçanta do të përcaktohen nga Zyra për Fëmijët e Veçantë në bazë të çdo rasti të veçantë.

Nëse ankesa është gjithashtu subjekti i një seance dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, Zyra për Fëmijët e Veçantë do ta pezullojë ankesën ose ato çështje të ankesës që janë pjesë e seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor deri në përfundim të seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Kur administratori i seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor merr vendim ose kur seanca dëgjimore tërhiqet apo mbyllet, çështjet do të shqyrtohen. Nëse ka çështje të ankesës që nuk u adresuan gjatë

July 1, 2008

procesit të seancës dëgjimore, ato çështje do të hetohen brenda 60 ditëve duke filluar nga data kur administratori i seancës dëgjimore jep vendimin përfundimtar ose kur kërkesa e procesit të rregullt ligjor është tërhequr ose mbyllur.

Çfarë ndodh kur Zyra për Fëmijët e Veçantë e përfundon hetimin e saj?

Kur të përfundojë hetimi, Zyra për Fëmijët e Veçantë do të përcaktojë nëse distrikti veptroi sipas (ju bind) ligjeve dhe rregullave përkatëse të edukimit special. Përcaktimi nëse distrikti veptroi apo nuk veptroi sipas ligjit në secilën prej çështjeve duhet të bazohet në faktet dhe në ligjet, rregullat ose standardet përkatëse. Zyra për Fëmijët e Veçantë duhet t'i njoftojë palët me shkrim në lidhje me rezultatet dhe arsyet për këto rezultate.

Çfarë është kërkesa e mëtejshme?

Gjatë një hetimi zyrtar të ankesës, Zyra për Fëmijët e Veçantë mund të gjejë fusha të tjera shtesë ku distrikti mund të mos ketë zbatuar ligjin. Këto fusha shtesë të "moszbatimit" janë çështje që nuk ishin përfshirë në ankesën origjinale të paraqitur nga ankuesi.

Si një agjenci që detyron zbatimin e ligjeve dhe rregullave, duke përfshirë igjin për përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (IDEA) të vitit 2004, Zyra për Fëmijët e Veçantë duhet të këshillojë distriktet në lidhje me fushat në të cilat është e shqetësuar se distrikti mund të mos jetë duke zbatuar ligjet dhe rregullat. Nëse Zyra për Fëmijët e Veçantë gjen fusha ku distrikti mund të mos ketë zbatuar ligjin, ajo do të shtojë një paragraf në fund të letrës së rezultateve ku thuhet se ekziston një fushë shqetësimi dhe se Zyra për Fëmijët e Veçantë do ta kontaktojë distriktin për të diskutuar shqetësimin dhe për të ofruar ndihmë teknike. Kjo ndihmë teknike quhet "kërkesë e mëtejshme".

Kërkesa e mëtejshme do të jetë e ndarë veç nga hetimi i ankesës origjinale. Informacioni i kërkesës së mëtejshme nuk do t'i dërgohet ankuesit, përveç rastit kur ankuesi bën kërkesë për dokumentacionin në lidhje me kërkesën e mëtejshme.

Kur ndodh kërkesa e mëtejshme, Zyra për Fëmijët e Veçantë i dërgon një letër të veçantë distriktit në lidhje me fushat e mundshme të

Faqja 38

moszbatimit të ligjit. Kërkesa e mëtejshme mund të përfshijë një kërkesë për dokumentacion ose informacion të mëtejshëm ose mund të përfshijë caktimin e një vizite në vend nga anëtarët e personelit të Zyrës për Fëmijët e Veçantë. Nëse zbulohet se distrikti nuk i ka zbatuar ose kërkesat e IDEA-s ose ato shtetërore për t'u shërbyer fëmijëve me paaftësi, atëherë Zyra e Fëmijëve të Veçantë do të sigurojë ndihmë teknike për ta korrigjuar problemin.

PROCESI I RREGULLT LIGJOR

Çfarë është seanca dëgjimore e paanshme e procesit të rregullt ligjor?

Seanca dëgjimore e paanshme e procesit të rregullt ligjor është një seancë dëgjimore zyrtare që mbahet për të zgjidhur mosmarrëveshje. Këto mosmarrëveshje mund të jenë rreth vlerësimit të fëmijës, programit edukativ të individualizuar, shërbimeve të fëmijës, vendosjes (vendndodhjes) edukative ose çdo gjë tjetër që ka të bëjë me sigurimin e një edukimi publik të përshtatshëm falas për fëmijën tuaj. Seanca dëgjimore mund të përfshijë mësues ose personel tjetër të shkollës, si dhe njerëz që sigurojnë shërbime të tjera që kanë të bëjnë me edukimin special të fëmijës suaj.

Kush mund të kërkojë seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor?

Prindërit, distrikti shkollor ose agjenci të tjera publike, (të tilla si këshillat e rrethit për personat me të meta mendore dhe paaftësi në zhvillim, qendrat e zhvillimit mendor dhe Departamenti i Shërbimeve të Rinjve të shtetit) të gjithë këta mund të kërkojnë një seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor.

Për të filluar procesin e seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, pala plotëson dhe paraqet formularin "Ankesa e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor" që gjendet në fund të këtij udhëzuesi. Duke filluar qysh tani e më poshtë në këtë botim, këtij procesi do t'i referohemi si "ankesa e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore".

Kush do ta drejtojë seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor?

July 1, 2008

E kujt është kjo IDEA? Udhëzues për prindërit në lidhje me ligjin e vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi

Një administrator i paanshëm (neutral) i seancave dëgjimore (Impartial Hearing Officer - IHO) do ta drejtojë seancën dëgjimore.

Në Ohio, administratori i seancës dëgjimore:

- Duhet të jetë avokat;
- Duhet të kryejë trajnimin e ofruar nga Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio;
- Nuk mund të jetë punonjës i distriktit shkollor, Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio ose i ndonjë agjencie publike që është përfshirë në edukimin ose kujdesin e fëmijës suaj;
- Nuk mund të ketë ndonjë interes personal ose profesional që mund të rezultojë në favorizimin e njëres apo tjetres palë në seancën dëgjimore;
- Duhet të dijë dhe të kuptojë ligjin IDEA, rregullat përkatëse federale dhe shtetërore dhe si gjykatat federale dhe shtetërore e interpretojnë IDEA-n;
- Duhet të ketë njohuri dhe aftësi për të drejtuar seanca dëgjimore duke përdorur praktika standarde ligjore; dhe
- Duhet të ketë njohuri dhe aftësi për të marrë dhe shkruar vendime sipas praktikës së përshtatshme standarde ligjore.

Distrikti shkollor shtetëror dhe lokal mund të japë një listë të administratorëve të seancës dëgjimore dhe kualifikimet e tyre. Kjo listë është vënë në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio, www.ode.state.oh.us, kërkimi me fjalët kyçe: *administratorë të seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor (due process hearing officers)*.

Kush paguan për seancën dëgjimore?

Administratorin e seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor e paguan distrikti shkollor. Megjithatë, administratori i seancës dëgjimore nuk konsiderohet si punonjës i distriktit shkollor vetëm mbi bazën se ai ose ajo paguhet nga distrikti shkollor për të shërbyer si administrator i seancës dëgjimore.

Ju duhet të paguani çdo kosto që ndodh për shkak të veprimeve tuaja, duke përfshirë kostot e ndonjë avokati, dëshmitari dhe eksperti që përdorni, si dhe shpenzimet e kopjeve të bëra apo shpenzimet postare.

A duhet të kem një avokat i cili paraqet ankesën time të procesit të rregullt ligjor dhe

Faqja 39

kërkesën për seancë dëgjimore dhe më përfaqëson në seancën dëgjimore?

Jo, mund ta paraqisni vetë ankesën e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesën për seancë dëgjimore dhe nëse dëshironi, mund të përfaqësoni veten në seancën dëgjimore. Distrikti shkollor do të ketë një avokat të vetin.

Si mund të kërkoj një seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor?

Mund të kërkonit një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor duke paraqitur një ankesë të procesit të rregullt ligjor dhe kërkesë për seancë dëgjimore. Njoftimi juaj i ankesës (shihni pyetjen tjetër) duhet të jetë me shkrim dhe t'i dërgohet palëve të mëposhtme:

- Dërgojani ankesën origjinale të procesit të rregullt ligjor (jo fotokopje) shefit të distriktit shkollor të vendbanimit të fëmijës juaj;
- Dërgoni një kopje të ankesës suaj të procesit të rregullt ligjor me postë ose me faks tek:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
25 South Front Street
Mail Stop #202
Columbus, Ohio 43215-4183
Faks: (614) 728-1097

Mund të plotësoni dhe paraqisni formularin e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio "Ankesa e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor" ose mund të përgatisni dhe paraqisni një ankesë tuajën me shkrim të procesit të rregullt ligjor. Nuk jeni i detyruar që ta përdorni formularin, por duhet të siguroheni që të përfshini të gjitha informacionet e kërkuara. Do ta gjeni formularin në fund të këtij botimi dhe gjithashtu në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio, www.ode.state.oh.us, kërkimi me fjalët kyçe: *procesi i rregullt ligjor (due process)*.

Termi "ankesë e procesit të rregullt ligjor" përdoret në lidhje me një kërkesë për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Duhet t'ju jepet mundësia për një seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor sa herë që paraqitet ankesë për një proces të rregullt ligjor.

Çfarë informacioni duhet të përfshijë ankesa ime e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore?

Ankesa juaj e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore duhet të përfshijë:

- Emrin e fëmijës suaj;
- Adresën e banesës së fëmijës;
- Emrin e shkollës që po ndjek fëmija;
- Në rastin e një fëmije ose të riu të pastrehë, (siç përcaktohet në paragrafin 725(2) të ligjit McKinney-Vento (42 U.S.C. 11434a(2) për ndihmën për të pastrehët), informacionin e kontaktit për fëmijën dhe emrin e shkollës që po ndjek fëmija;
- Një përshkrim të natyrës së problemit dhe si ka të bëjë me kualifikimin e fëmijës për shërbime të edukimit special dhe marrjen e shërbimeve të edukimit special;
- Faktet që kanë të bëjnë me problemin; dhe
- Një zgjidhje të propozuar të problemit në bazë të asaj çka dini në kohën që paraqisni ankesën.

SHËNIM: Nuk do të keni seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor derisa ju ose avokati që ju përfaqëson të paraqisni një ankesë të procesit të rregullt ligjor, e cila përfshin informacionin e shënuar më lart, sipas rregullit federal 34 C.F.R. paragrafi 300.508.

A ka ndonjë kufizim në lidhje me çështjet që mund të ngrenë në seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor?

Në seancën e procesit të rregullt ligjor nuk mund të ngrini çështje që nuk janë ngritur në ankesën e procesit të rregullt ligjor përveç rastit kur pala tjetër bie dakord për këtë.

A mund të paraqes një ankesë të veçantë të procesit të rregullt ligjor për një çështje që nuk e ngrita në një ankesë të procesit të rregullt ligjor të paraqitur më parë?

Po. Mund të paraqisni një ankesë të veçantë të procesit të rregullt ligjor për një çështje të veçantë që nuk është ngritur në një ankesë të procesit të rregullt ligjor të paraqitur më parë.

Cili është afati për të kërkuar seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor?

Si rregull i përgjithshëm, duhet të kërkonte seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor brenda dy vitesh nga data që e dinit ose duhet ta kishit ditur veprimin për të cilin keni ankesë të procesit të rregullt ligjor.

PËRJASHTIM: Afati dy vjeçar nuk ka të bëjë me ju nëse ju kanë penguar që të kërkonte seancën dëgjimore për arsyen se:

- Distrikti shkollor në mënyrë specifike ju mashtrou dhe menduat se e kishte zgjidhur problemin; ose
- Distrikti shkollor fshehu informacion që IDEA ia kërkon që t'ju japë.

Çfarë ndodh nëse distrikti shkollor beson se ankesa ime e procesit të rregullt ligjor nuk është e mjaftueshme?

Ankesa juaj e procesit të rregullt ligjor do t'ju lejojë që të keni një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, përveç rastit kur ndodh sa më poshtë vijon:

- Brenda 15 ditëve nga marrja e ankesës suaj të procesit të rregullt ligjor, distrikti shkollor njofton me shkrim administratorin e seancës dëgjimore, Ministrinë e Arsimit të Shtetit Ohio dhe juve se distrikti shkollor mendon se ankesa juaj e procesit të rregullt ligjor nuk i ka plotësuar kushtet e kërkesës për proces të rregullt ligjor. (Për kushtet e një kërkesë, shihni pyetjen "*Çfarë informacioni duhet të përfshijë ankesa ime e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore?*")
- Brenda 5 ditëve nga marrja e këtij njoftimi prej distriktit shkollor, administratori i seancës dëgjimore duhet të vendosë nëse ankesa juaj e procesit të rregullt ligjor i plotëson kushtet për një ankesë të tillë.
- Mbas marrjes së këtij vendimi, administratori i seancës dëgjimore duhet t'ju njoftojë menjëherë me shkrim juve, distriktin shkollor dhe Zyrën për Fëmijët e Veçantë në lidhje me vendimin e tij.

Çfarë do të ndodhë nëse administratori i seancës dëgjimore vendos se ankesa ime për procesin e rregullt ligjor nuk i përmbushi të gjitha kërkesat?

Vendimi me shkrim i administratorit të seancës dëgjimore do të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- Arsyet që ankesa juaj u përcaktua se ishte e pamjaftueshme.
- Një deklaratë në një gjuhë të qartë se çështja nuk është hedhur poshtë.
- Një deklaratë se çështja nuk mund të shkojë në seancë dëgjimore derisa të paraqitet një njoftim i procesit të rregullt ligjor që përmban të gjithë informacionin e kërkuar. Për këtë informacion të kërkuar, referojuni pyetjes "*Çfarë informacioni duhet të përfshijë ankesa ime e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore?*"
- Një listë të burimeve ndihmëse për t'ju ndihmuar që të plotësoni një ankesë të procesit të rregullt ligjor dhe për të korrigjuar gjithçka që përcaktohet se nuk është e mjaftueshme. Një prej këtyre burimeve është personeli i Sektorit të Masave Mbrojtëse Procedurale të Zyrës për Fëmijët e Veçantë të ODE-së. Ju mund të kontaktoni:
Sandy Kaufman, Consultant
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards
25 South Front St.
Columbus, OH 43215
Email: sandy.kaufman@ode.state.oh.us
Telefon: 614-466-2650 ose
Telefon falas (877) 644-6338

Nëse ankesa ime është e mjaftueshme, por dëshiroj ta ndryshoj atë, çfarë mund të bëj?

Nëse dëshironi të bëni disa ndryshime ose të shtoni çështje të reja, ju mund të kërkonte leje për ta "ndryshuar" ankesën ose mund të paraqisni një ankesë të re për çështjet e reja.

Ju mund ta ndryshoni ankesën e procesit të rregullt ligjor vetëm nëse distrikti shkollor ose administratori i seancës dëgjimore e pranon ndryshimin në një prej mënyrave të mëposhtme:

- Distrikti shkollor e pranon me shkrim ndryshimin dhe atij i jepet mundësia për ta zgjidhur ankesën e ndryshuar të procesit të rregullt ligjor përmes një mbledhjeje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; ose
- Administratori i seancës dëgjimore jep lejen. Administratori i seancës dëgjimore mund të japë një leje të tillë jo më vonë se 5 ditë përpara seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Për shembull, nëse seanca juaj dëgjimore është caktuar më 15 gusht dhe administratori i seancës dëgjimore e

merr kërkesën tuaj për të ndryshuar njoftimin tuaj më 1 gusht, administratori i seancës dëgjimore mund t'ju japë leje në çdo kohë ndërmjet 1 gushtit dhe 10 gushtit.

Nëse merrni leje dhe e ndryshoni kërkesën tuaj për proces të rregullt ligjor, data në të cilën paraqitët kërkesën tuaj fillestare për proces të rregullt ligjor qëndron edhe për ndryshimin.

Për shembull, nëse e paraqitët kërkesën tuaj me 1 korrik 2008 dhe e ndryshuat kërkesën tuaj me 1 gusht 2008, data e paraqitjes së kërkesës nuk ndryshon. Data fillestare e paraqitjes së kërkesës më 1 korrik zbatohet për të gjithë kërkesën e procesit të rregullt ligjor, përfshirë ndryshimin.

Nëse më duhet ta ndryshoj ankesën time të procesit të rregullt ligjor sepse administratori i seancës dëgjimore vendosi se ankesa ishte e pamjaftueshme, sa kohë kam për të paraqitur një ankesë të ndryshuar?

Ju duhet të paraqisni një njoftim të ankesës së ndryshuar të procesit të rregullt ligjor pranë administratorit të seancës dëgjimore brenda 14 ditësh nga data e vendimit të administratorit të seancës dëgjimore se ankesa ishte e pamjaftueshme. Nëse nuk paraqisni një njoftim ndryshimi brenda kësaj periudhe, administratori i seancës dëgjimore do ta hedhë poshtë ankesën tuaj të procesit të rregullt ligjor dhe do të mbyllë çështjen.

SHËNIM: Nëse paraqisni një ankesë të ndryshuar të procesit të rregullt ligjor, afatet kohore për mbledhjen e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (15 ditë ose nëse do të jetë një seancë “e përshpejtuar” (më e shpejtë), 7 ditë) dhe periudha kohore për të zgjidhur ankesën e procesit të rregullt ligjor (30 ose nëse është një seancë e përshpejtuar, 15 ditë) fillojnë përsëri me paraqitjen e ankesës së ndryshuar të procesit të rregullt ligjor.

Nëse nuk e ndryshoj ankesën, çfarë mund të bëj tjetër nëse kërkesa ime u përcaktua se është e pamjaftueshme?

Ju mund ta riparaqisni ankesën pranë shefit të distriktit shkollor dhe të dërgoni një kopje të ankesës së riparaqitur pranë Zyrës për Fëmijët e

Veçantë. Ankesa juaj do të trajtohet si kërkesë e re dhe duhet të përmbushë të gjitha kriteret e një kërkesë të re.

Ku ndryshon një ankesë e riparaqitur nga një ankesë e ndryshuar?

Ankesa e riparaqitur është kërkesë e re. Ankesa e ndryshuar nuk është kërkesë e re, por një ndryshim në kërkesën tuaj aktuale.

Ankesa e riparaqitur ka një datë të re të paraqitjes. Ankesa e ndryshuar ruan datën fillestare të paraqitjes.

Ju do të duhet të siguroheni që ta riparaqisni ankesën tuaj brenda afatit kohor dyvjeçar ose që ajo përmbush një prej përjashtimeve të afatit kohor dyvjeçar. Për të përcaktuar këtë, referojuni pyetjes së mëparshme, “Cili është afati kohor për të kërkuar një seancë të paanshme të procesit të rregullt ligjor?”

A mundet që ankesa e procesit të rregullt ligjor dhe kërkesa për seancë dëgjimore të ndryshohet ose riparaqitet vetëm në rastin kur kërkesa ime u përcaktua si e pamjaftueshme?

Jo. Kërkesa mund të ndryshohet ose riparaqitet për arsye të tjera, përfshirë sa më poshtë:

- Ju mund të dëshironi ta ndryshoni kërkesën për të sqaruar ose shtuar çështje; ose
- Ju mund të riparaqisni një kërkesë nëse e tërhoqët kërkesën tuaj dhe më pas vendosët ta riparaqisni atë.

Çfarë mund të bëj nëse distrikti ka paraqitur një ankesë të procesit të rregullt ligjor dhe një kërkesë për seancë të procesit të rregullt ligjor dhe unë besoj se ankesa e procesit të rregullt ligjor e distriktit nuk është e mjaftueshme?

Nëse besoni se ankesa e procesit të rregullt ligjor e distriktit është e pamjaftueshme, ju mund të ndërmerrni hapat e mëposhtëm:

- Brenda 15 ditësh nga marrja e ankesës së procesit të rregullt ligjor së distriktit, ju njoftoni me shkrim si administratorin e seancës dëgjimore, ashtu edhe distriktin se ju besoni se ankesa e procesit të rregullt ligjor e distriktit nuk ka përmbushur kriteret përkatëse

të njoftimit të ankesës. Dërgoni një kopje të njoftimit tuaj pranë Sektorit të Masave Mbrojtëse Procedurale, Zyra për Fëmijët e Veçantë, Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio (Procedural Safeguards Section, Office for Exceptional Children, Ohio Department of Education). *Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.*

- Kontaktoni Sektorin e Masave Mbrojtëse Procedurale, Zyra për Fëmijët e Veçantë, Ministria e Arsimit të Shtetit Ohio për emrin e administratorit të seancës dëgjimore që duhet të kontaktoni nëse nuk e keni marrë tashmë këtë informacion nga Zyra për Fëmijët e Veçantë. *Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.*
- Brenda 5 ditësh nga marrja e njoftimit tuaj, administratori i seancës dëgjimore duhet të vendosë nëse ankesa e procesit të rregullt ligjor e distriktit përmbush kërkesat përkatëse të ankesës së procesit të rregullt ligjor.
- Në të njëjtën ditë që administratori i seancës dëgjimore merr vendimin, ai ose ajo duhet t'ju njoftojë me shkrim juve, distriktin shkollor dhe Zyrën për Fëmijët e Veçantë në lidhje me vendimin e tij ose të saj.

Nëse administratori i seancës dëgjimore vendos se ankesa e procesit të rregullt ligjor e distriktit shkollor është e pamjaftueshme ose nëse distrikti shkollor dëshiron ta ndryshojë vetë ankesën e tij, a mundet që distrikti ta ndryshojë ankesën e tij?

Distrikti shkollor mund ta ndryshojë ankesën e tij të procesit të rregullt ligjor vetëm nëse:

- Ju jepni miratim me shkrim për ndryshimin dhe ju jepet mundësia për ta zgjidhur ankesën e ndryshuar të procesit të rregullt ligjor përmes një mbledhjeje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; ose
- Administratori i seancës dëgjimore jep lejen. Administratori i seancës dëgjimore mund ta japë një leje të tillë jo më vonë se 5 ditë përpara kryerjes së seancës së procesit të rregullt ligjor.

A do t'i përgjigjet distrikti shkollor kërkesës time për një proces të rregullt ligjor?

Nëse distrikti shkollor nuk ju ka dërguar tashmë një njoftim paraprak me shkrim në lidhje me temën e ankesës tuaj të procesit të rregullt ligjor,

distrikti shkollor duhet t'ju dërgojë përgjigje brenda 10 ditësh prej marrjes së ankesës tuaj. Përgjigja duhet të përfshijë:

- Një shpjegim se pse propozoi të ndërmarrë veprimin që ju kundërshtuat në ankesën tuaj ose pse refuzoi të veprojë;
- Një përshkrim të mundësive të tjera që ekipi i IEP-së mori në konsideratë dhe arsyet pse ato mundësi u hodhën poshtë;
- Një përshkrim të çdo procedure vlerësimi, gjykimi, dokumentimi ose raportimi që agjencia përdori si bazë për veprimin që propozoi ose refuzoi; dhe
- Një përshkrim të faktorëve të tjerë që kanë lidhje me veprimin që distrikti shkollor propozoi ose refuzoi.

SHËNIM: Nëse distrikti shkollor jua dërgon këtë njoftim, distrikti përsëri mund të pretendojë se ankesa juaj e procesit të rregullt ligjor ishte e pamjaftueshme.

Çfarë do të bëjë distrikti shkollor pasi merr ankesën time të procesit të rregullt ligjor?

Pasi të kërkonti një seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor:

- Nëse kjo është ankesa e parë e procesit të rregullt ligjor që keni paraqitur gjatë vitit shkollor, distrikti shkollor do t'ju japë një kopje të "E kujt është kjo IDEA?"
- Do ju thuhet se ndërmjetësimi është i mundshëm dhe do t'ju jepet informacion në lidhje me ndërmjetësimin.
- Nëse kërkuat seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, distrikti shkollor do të zhvillojë një mbledhje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve (që diskutohet me hollësi më poshtë).
- Zyra për Fëmijët e Veçantë do t'ju dërgojë juve dhe distriktin shkollor emrin e administratorit të seancës dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor të caktuar për çështjen tuaj.
- Nëse ju (ose distrikti shkollor) kërkonti seancë dëgjimore, distrikti shkollor do t'ju informojë për çdo shërbim ligjor falas ose me kosto të ulët ose shërbime të tjera që mund t'ju nevojiten që janë të disponueshme në rajonin tuaj.
- Personeli i distriktit shkollor, duke u këshilluar me administratorin e seancës dëgjimore dhe me ju, do të caktojë vendin,

datën dhe kohën e seancës dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor.

- Të paktën pesë ditë pune përpara seancës dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor, çdo palë duhet t'ju tregojë të gjitha palëve të tjera të gjitha vlerësimet e kryera deri në atë datë dhe të gjitha rekomandimet mbështetur në ato vlerësime, që pala synon të përdorë në seancën dëgjimore. Ju mund t'i kërkonti administratorit të seancës dëgjimore që të dërgojë thirrje për në gjyq që i kërkon dëshmitarëve të marrin pjesë në seancën dëgjimore ose të sjellin dokumente të caktuara në seancën dëgjimore.
- Nëse një palë nuk përmbush kërkesën e mësipërme, administratori i seancës dëgjimore mund të mos e lejojë atë palë që të paraqesë vlerësimin ose rekomandimin përkatës, përveçse me miratimin e palës tjetër.
- Do të mbahet një seancë dëgjimore e paanshme e procesit të rregullt ligjor dhe vendimi do t'i dërgohet me postë secilës palë. Distrikti shkollor duhet të sigurohet se kjo ndodh brenda 45 ditësh pas përfundimit të periudhës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përveçse kur ju ose distrikti shkollor kërkonti që koha e seancës dëgjimore të zgjatet përtej 45 ditëve dhe administratori i seancës dëgjimore të paanshme e ka miratuar zgjatjen.
- Vendimi i marrë në seancën dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor është përfundimtar, përveçse kur ju ose distrikti shkollor bëni apel brenda 45 ditësh prej njoftimit të vendimit.

Nëse distrikti shkollor është pala që paraqet ankesën e procesit të rregullt ligjor, çfarë duhet të bëj kur marr një kopje të ankesës së procesit të rregullt ligjor të distriktit?

Brenda 10 ditësh nga marrja e ankesës së procesit të rregullt ligjor të distriktit shkollor, ju duhet t'i dërgoni distriktit shkollor një përgjigje që trajton me përpikëri çështjet e ngritura në ankesën e procesit të rregullt ligjor të distriktit shkollor.

Çfarë është mbledhja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Nëse kërkuat seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, një mbledhje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve do të zhvillohet përpara

July 1, 2008

kryerjes së seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Mbledhja ju jep mundësinë për të diskutuar ankesën tuaj dhe i jep distriktit mundësinë për të zgjidhur ankesën tuaj.

Distrikti shkollor do të zhvillojë një mbledhje me ju dhe anëtarin ose anëtarët e ekipit të IEP-së që kanë njohuri të posaçme të fakteve të identifikuar në ankesën tuaj. Distrikti dhe ju vendosni se cilët anëtarë të ekipit të IEP-së do të vijnë në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Mbledhja duhet:

- Të zhvillohet brenda 15 ditësh nga koha kur distrikti mori njoftimin e ankesës tuaj të procesit të rregullt ligjor. Kjo do të jetë brenda 7 ditësh për një kërkesë të përshpejtuar ose më të shpejtë.
- Të përfshijë një përfaqësues të distriktit shkollor ose agjencie tjetër publike që ka autoritet për të vendosur në emër të asaj agjencie.
- Të mos përfshijë avokat të distriktit shkollor, përveçse kur ju shoqëroheni nga avokat.

Cili është qëllimi i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Qëllimi i mbledhjes është që ju të diskutoni ankesën tuaj të procesit të rregullt ligjor dhe faktet mbi të cilat bazohet ajo, në mënyrë që distrikti shkollor të ketë mundësinë për të zgjidhur mosmarrëveshjen mbi të cilën bazohet ankesa juaj.

Mbledhja duhet të zhvillohet, përveç rastit kur ju dhe distrikti shkollor bini dakord me shkrim për të mos e zhvilluar mbledhjen ose bini dakord që në vend të kësaj mbledhjeje të përdorni procesin e ndërmjetësimit të përshkruar në segmentin "Ndërmjetësimi" të këtij manuali.

Diskutimet që zhvillohen në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve duhet të ruhen si private dhe nuk mund të përdoren si prova në një seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose në apelin e atij vendimi.

Çfarë është arbitrimi i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Kur Zyra për Fëmijët e Veçantë ofron një ndërmjetësues me aftësi ose arbitër, që ka marrë trajnim të gjerë në edukimin special, si të

Faqja 44

pranishëm në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ky proces quhet "arbitrim i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve".

"Arbitri" ju ndihmon ju dhe anëtarët e nevojshëm të ekipit të IEP-së që të zgjidhni mosmarrëveshjen në të cilën mbështetet ankesa. Arbitri:

- Ndhmon në mbajtjen hapur të komunikimit mes palëve;
- Drejton diskutimin; dhe
- Ndhmon palët që të zgjidhin mosmarrëveshjet.

Arbitri nuk merr vendime, por ndihmon palët që t'i gjejnë vetë zgjidhjet.

Si e kërkoj arbitrimin e mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Për të kërkuar arbitrimin e mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, kontaktoni: Ohio Department of Education Office for Exceptional Children Procedural Safeguards Section *Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.*

Nëse distrikti shkollor kërkon seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, a kërkohet që distrikti të thërrasë një mbledhje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Jo. Kur distrikti shkollor kërkon seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, nuk ekziston ndonjë kërkesë për një mbledhje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe një periudhë prej 30 ditësh.

Nëse distrikti kërkon seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, afati kohor prej 45 ditësh për dhënien e vendimit të seancës dëgjimore fillon kur ju të keni marrë njoftimin e ankesës së procesit të rregullt ligjor të bërë nga distrikti.

Brenda 45 ditësh që kur merrni ankesën e procesit të rregullt ligjor të bërë nga distrikti shkollor:

- Seanca dëgjimore duhet të zhvillohet;
- Një vendim i seancës dëgjimore duhet të jepet; dhe
- Një kopje e vendimit duhet të postohet, përveçse kur administratori i seancës

dëgjimore zgjat afatin kohor sipas kërkesës tuaj me shkrim ose të distriktit shkollor.

Nëse ankesa ime zgjidhet në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, cili është hapi i mëtejshëm?

Nëse arrihet një zgjidhje e mosmarrëveshjes në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ju dhe distrikti shkollor duhet të vini në veprim një marrëveshje ligjore që kërkon nga të dy ju që të zbatoni pjesën tuaj të marrëveshjes dhe ajo:

- Nënshkruhet nga ju dhe një përfaqësues i distriktit shkollor që ka autoritet për të nënshkruar; dhe
- Mund të zbatohet në çdo gjykatë të përshtatshme në Shtetet e Bashkuara.

PERIUDHA E RISHIKIMIT: Nëse ju dhe distrikti shkollor ekzekutoni një marrëveshje me shkrim të zgjidhjes, ose ju ose distrikti shkollor mund ta anuloni marrëveshjen brenda 3 ditësh pune pas nënshkrimit të marrëveshjes.

Çfarë ndodh nëse ankesa ime nuk zgjidhet përmes sesionit për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Nëse distrikti i shkollës nuk e ka zgjidhur ankesën sipas pëlqimit tuaj brenda 30 ditësh që kur mësoi për ankesën e procesit të rregullt ligjor, periudha e zgjidhjes së çështjes ka përfunduar dhe mund të zhvillohet seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor, përveçse kur periudha 30 ditëshe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve është ndryshuar.

Ndryshimi i periudhës 30 ditëshe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ndodh nëse:

- Ju dhe distrikti bini dakord me shkrim që ta lini mënjane (anashkaloni) mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; ose
- Ju dhe distrikti bini dakord me shkrim se asnjë zgjidhje nuk është e mundshme pasi të keni filluar diskutimin e çështjeve në një mbledhje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose një mbledhje ndërmjetësimi; ose
- Ju dhe distrikti bini dakord me shkrim për tejkalimin e periudhës 30 ditëshe, në mënyrë që të vazhdoni ndërmjetësimin dhe pastaj ose ju, ose distrikti, tërhiqeni nga ndërmjetësimi.

Kur ndodh ndonjë prej këtyre gjërave, periudha e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve ka përfunduar dhe fillon afati kohor prej 45 ditësh për seancën dëgjimore. Brenda 45 ditësh pas përfundimit të periudhës 30 ditëshe për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve:

- Seanca dëgjimore duhet të zhvillohet;
- Një vendim i seancës dëgjimore duhet të jepet; dhe
- Një kopje e vendimit duhet të postohet, përveçse kur administratori i seancës dëgjimore e ka zgatur afatin kohor sipas kërkesës tuaj me shkrim ose të distriktit shkollor.

Çfarë ndodh nëse nuk marr pjesë në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Nëse nuk merrni pjesë në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, afati kohor i zakonshëm për procesin e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (30 ditë) dhe për seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor (45 ditë) do të zgjatet derisa të zhvillohet mbledhja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, përveçse kur ju dhe distrikti shkollor së bashku keni rënë dakord me shkrim:

- Të anashkaloni procesin për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve; ose
- Të përdorni ndërmjetësimin e koordinuar nga shteti në vend të mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Çfarë ndodh në fund të periudhës për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve nëse unë nuk marr pjesë në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Nëse distrikti shkollor nuk mund t'ju bindë që të merrni pjesë në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve pasi ka bërë përpjekje të arsyeshme (dhe mbasi i ka dokumentuar këto përpjekje), distrikti shkollor mund, në fund të periudhës 30 ditore, të kërkojë që administratori i seancës dëgjimore të hedhë poshtë ankesën tuaj të procesit të rregullt ligjor. Kjo do të bëhet në fund të 15 ditëve në rast të një kërkesë të përshpejtuar ose më të shpejtë.

Çfarë ndodh nëse distrikti shkollor nuk e zhvillon mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve ose nuk merr pjesë në

mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve?

Nëse distrikti shkollor (a) nuk e zhvillon mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve brenda 15 ditësh (7 ditësh nëse është kërkesë e përshpejtuar) nga marrja e njoftimit të ankesës tuaj të procesit të rregullt ligjor ose (b) nuk merr pjesë në mbledhjen për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, ju mund t'i kërkonit administratorit të seancës dëgjimore që të përfshihet dhe të fillojë afatin kohor prej 45 ditësh të seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor.

Nëse zhvillohet seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor, cilat janë të drejtat e mia?

Nëse jeni përfshirë në një seancë dëgjimore të paanshme të procesit të rregullt ligjor, ju keni të drejtë:

- Të merrni me vete fëmijën që është subjekt i seancës dëgjimore;
- T'i hapni publikut seancën dëgjimore;
- Të shoqëroheni dhe të këshilloheni nga një avokat dhe nga individë me njohuri ose trajnim të posaçëm që kanë lidhje me problemet e fëmijëve me paaftësi;
- Të paraqisni prova, të përballeni me dhe t'i kundërbëni pyetje palëve të tjera dhe të kërkonit praninë e dëshmitarëve;
- Të mos lejoni paraqitjen e çdo prove që nuk ju është paraqitur juve të paktën 5 ditë pune përpara seancës dëgjimore;
- Të merrni një regjistrim me shkrim ose, nëse preferoni, një regjistrim elektronik fjalë-për-fjalë të seancës dëgjimore;
- Të merrni regjistrime me shkrim ose, nëse preferoni, regjistrim elektronik të konkluzioneve dhe vendimeve; dhe
- Të merrni falas regjistrimin e seancës dëgjimore dhe konkluzionet e vendimit.

Si do të komunikojë administratori i seancës dëgjimore me mua dhe distriktin shkollor?

Administratori i seancës dëgjimore do t'ju japë juve dhe distriktit shkollor të njëjtat njoftime në të njëjtën kohë gjatë të gjitha pjesëve të seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor.

Si do ta marrë vendimin e tij ose të saj administratori i seancës dëgjimore?

Përgjithësisht vendimi i administratorit të seancës dëgjimore nëse fëmija juaj mori një

edukim publik falas të përshtatshëm, duhet të bazohet vetëm në çështjen e marrjes së edukimit të përshtatshëm nga fëmija juaj dhe jo në moszbatimin e rregullave nga distrikti shkollor. Nëse distrikti shkollor, për shembull, nuk zhvilloi mbledhje aq shpesh sa duhet të zhvillonte, nuk ftoi personat e duhur në këto mbledhje ose nuk ju dha njoftim të mjaftueshëm, por ju gjithsesi morët pjesë në mbledhje, fëmija juaj konsiderohet se mori një edukim të përshtatshëm. Administratori i seancës dëgjimore mund të vendosë kundër distriktit për mospërshtatshëm dhe edukimit publik falas të përshtatshëm, por nuk mund të vendosë kundër distriktit thjesht për moszbatimin e rregullave. Nëse distrikti thjesht nuk zbatoi rregullat, administratori i seancës dëgjimore mund ta urdhërojë distriktin që të fillojë të zbatojë rregullat dhe procedurat.

PËRJASHTIM: Nëse pretendoni se distrikti shkeli procedurat në lidhje me kualifikimin e fëmijës suaj për shërbimet e edukimit special ose marrjen e tyre, administratori i seancës dëgjimore mund të vendosë se fëmija juaj nuk mori një edukim publik falas të përshtatshëm. Kjo mund të ndodhë vetëm nëse shkeljet e procedurave:

- Ndërhynë në të drejtën e fëmijës tuaj për një edukim publik falas të përshtatshëm;
- Ndërhynë rëndë në mundësinë tuaj për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes në lidhje me sigurimin e edukimit publik falas të përshtatshëm për fëmijën tuaj; ose
- U bënë shkak që fëmija juaj të mos marrë përfitimet edukative.

Administratori i seancës dëgjimore përsëri mund ta urdhërojë distriktin shkollor që të përmbushë kërkesat procedurale.

SHËNIM: Asnjëra prej këtyre dispozitave të seancës dëgjimore nuk ju heq të drejtën për të bërë apel pranë Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.

Cili është statusi i fëmijës tim gjatë procedimeve të procesit të rregullt ligjor?

- Përveçse kur fëmija është në një mjedis të edukimit të përkohshëm alternativ (Interim Alternative Educational Setting – IAES) (IAES – mjedis edukimi i përkohshëm jashtë shkollës, që ndodh nëse fëmija është disiplinuar) ndërsa jeni në pritje të vendimit

të seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, rishikimit ose procedimit gjyqësor, fëmija juaj duhet të qëndrojë në vendosjen edukative aktuale të tij ose të saj (mjedisin edukativ), përveçse kur ju dhe shteti ose distrikti shkollor bini dakord për diçka tjetër. Kjo quhet “qëndrim në vend.”

- Nëse ankesa e procesit të rregullt ligjor përfshin kërkimin e një aplikimi për praninë fillestarë në shkollën publike, fëmija, me miratimin e prindërve, duhet të vendoset në shkollën publike derisa të përfundojnë të gjitha procedimet.
- Nëse ankesa përfshin një aplikim për të filluar shërbimet sipas pjesës së ligjit për moshën shkollare sepse fëmija ka mbushur moshën 3 vjeç dhe nuk ka më të drejtë për shërbime sipas pjesës së ligjit për ndërhyrjen e hershme, agjencisë publike nuk i kërkohet të sigurojë shërbimet e ndërhyrjes së hershme.
- Nëse vendoset se fëmija ka të drejtë për edukim special dhe shërbime përkatëse sipas pjesës B dhe prindi e miraton dhënien fillestare të edukimit special dhe shërbimeve përkatëse, atëherë agjencia publike duhet të sigurojë edukimin special dhe shërbimet përkatëse që nuk janë objekt i mosmarrëveshjes ndërmjet prindit dhe agjencisë publike.
- Nëse një zyrtar rishikimi në një rishikim në nivel shtetëror bie dakord me prindërit e fëmijës se një ndryshim i vendosjes (vendndodhjes edukative) është i përshtatshëm, kjo vendosje duhet të trajtohet si marrëveshje ndërmjet shtetit dhe prindërve për qëllimet e qëndrimit në vend (shihni pikën një më sipër).

SHËNIM: Pjesa B e IDEA-s ka të bëjë me fëmijët e moshës nga 3 deri në 21 vjeç. Pjesa C e IDEA-s ka të bëjë me fëmijët e moshës nga lindja deri në 2 vjeç.

Çfarë mund të bëj nëse nuk jam dakord me vendimin e administratorit të seancës dëgjimore?

Nëse ju ose distrikti shkollor nuk jeni dakord me vendimin e marrë nga administratori i seancës dëgjimore, çdonjëri prej jush mund të bëjë apel me shkrim pranë Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio brenda 45 ditësh nga dita që merrni vesh vendimin.

- Dërgoni apelin tuaj origjinal (jo fotokopje) me postë tek:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.

- Dërgojini një kopje të apelit shefit të distriktit shkollor.

Kur Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio merr apelin tuaj, ajo emëron një nëpunës rishikimi të nivelit shtetëror (state-level review officer – SLRO) për të kryer një rishikim të paanshëm të vendimit të administratorit të seancës dëgjimore. Nëpunësi i rishikimit të nivelit shtetëror:

- Shqyrton të gjithë dokumentacionin e seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor;
- Siguron se procedurat e seancës dëgjimore ndoqën kërkesat e procesit të rregullt ligjor;
- Kërkon prova të tjera, nëse është e nevojshme. Nëse zhvillohet seancë dëgjimore për të marrë prova të tjera, zbatohen të drejtat tuaja për seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor;
- Mund të bëjë zgjatjen e afatit kohor nëse ju ose distrikti shkollor bëni kërkesë; dhe
- Merr një vendim të pavarur pas përfundimit të rishikimit.

Për informacion në lidhje me të drejtat tuaja për seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, shihni pyetjen e mësipërme *“Nëse zhvillohet seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor, cilat janë të drejtat e mia?”*

Brenda 30 ditësh pas marrjes nga Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio e një kërkesë për apel, ministria do të sigurojë që:

- Të merret një vendim i pavarur në një seancë dëgjimore rishikimi në nivel shtetëror; dhe
- Nëse dëshironi, një kopje me shkrim ose regjistrim elektronik fjalë-për-fjalë i konkluzioneve dhe vendimit do t’i postohet të gjitha palëve.

Afati kohor prej 30 ditësh për seancën dëgjimore të rishikimit në nivel shtetëror mund të zgjatet nëse çdonjëra palë kërkon një zgjatje dhe zgjatja jepet me shkrim nga nëpunësi i rishikimit në nivel shtetëror.

Çfarë mund të bëj nëse nuk jam dakord me vendimin e nëpunësit të rishikimit në nivel shtetëror?

Nëse nuk jeni të kënaqur me konkluzionet dhe vendimin e marrë gjatë rishikimit në nivel shtetëror, ju keni të drejtë të paraqisni një padi gjyqësore në gjykatën shtetërore ose federale.

Ju mund ta apelon vendimin:

- Në një gjykatë distrikti në Shtetet e Bashkuara brenda 90 ditësh nga data e vendimit të nëpunësit të rishikimit në nivel shtetëror; ose
- Në gjykatën e kërkesave të zakonshme të rrethit ku ndodhet distrikti shkollor i vendbanimit të fëmijës brenda 45 ditësh nga marrja e njoftimit të urdhrat të nëpunësit të rishikimit në nivel shtetëror.

Paraqitja e kërkesës në gjykatën federale të distriktit: Nëse jeni duke bërë apel kundër vendimit në gjykatën e distriktit të Shteteve të Bashkuara, shkoni pranë gjykatës së distriktit për të përcaktuar kërkesat e paraqitjes pranë gjykatës.

Paraqitja e kërkesës në gjykatën e kërkesave të zakonshme në Ohio: Nëse jeni duke bërë apel kundër vendimit në një gjykatë të kërkesave të zakonshme në Ohio, ju duhet:

- Ta dërgoni apelin tuaj origjinal (jo fotokopje) me postë tek:
Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
25 South Front Street
Mail Stop #202
Columbus, Ohio 43215-4183
- T’i dërgoni një kopje të apelit tuaj gjykatës së duhur dhe palës kundër të cilës po apelon.

Në çdo apel, gjykata:

- Merr dokumentacionin e seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor dhe seancës së rishikimit në nivel shtetëror;
- Dëgjon prova të tjera me kërkesë të një palë; dhe
- Jep masat që gjykata vendos se janë të përshtatshme, duke e bazuar vendimin e saj në të gjitha provat.

A më duhet të paguaj për tarifat e avokatit tim?

Ju do të jeni përgjegjës për çdo tarifë të avokatit tuaj dhe dëshmitarëve ekspertë. Megjithatë,

nëse e fitoni çështjen në çdo veprim ose procedim që ka lidhje me seancën tuaj dëgjimore të procesit të rregullt ligjor (duke u bërë kështu “palë mbizotëruese”), ju mund t’i kërkonte gjykatës që të urdhërojë palën tjetër që t’ju rimburojë (paguajë) për tarifën e arsyeshme të avokatit. Administratori i seancës dëgjimore dhe nëpunësi i rishikimit në nivel shtetëror nuk mund të japin pagesë për tarifën e avokatit.

Ju duhet të dini se nëse pala tjetër është pala mbizotëruese, avokatit tuaj ose juve mund t’ju duhet të paguani tarifën e arsyeshme të avokatit të palës mbizotëruese.

Nëse pala mbizotëruese është Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio ose një distrikt shkollor, palëve të renditura në pikat 1-4 më poshtë mund t’u duhet të rimburojnë për tarifën ligjore Ministrinë e Arsimit të Shtetit Ohio ose distriktin shkollor:

1. Avokati i një prindi që paraqet një ankesë ose shkak veprimi të mëvonshëm që është e pakuptimtë, e paarsyeshme ose pa bazë; ose
2. Avokati i një prindi që vazhdoi ta ndjekë padinë ligjore pasi ajo u bë qartësisht e pakuptimtë, e paarsyeshme ose pa bazë; ose
3. Avokati i një prindi, nëse kërkesa e prindit për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose shkak i veprimit pasues u paraqit për ndonjë qëllim të papërshtatshëm, të tillë si për të ngacmuar, shkaktuar vonesë të panevojshme ose për të rritur në mënyrë të panevojshme koston e mbrojtjes ligjore; ose
4. Prindi, nëse kërkesa e prindit për seancë dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose shkak i veprimit pasues u paraqit për ndonjë qëllim të papërshtatshëm, të tillë si për të ngacmuar, shkaktuar vonesë të panevojshme ose për të rritur në mënyrë të panevojshme koston e mbrojtjes ligjore.

Mbledhja e ekipit të IEP-së; Mbledhja për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Tarifat e avokatit nuk do të paguhen në lidhje me çfarëdolloj mbledhjeje të ekipit të IEP-së, përveçse kur mbledhja 1) është rezultat i seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, i rishikimit në nivel shtetëror ose i çështjes gjyqësore; ose 2) është thirrur nga shteti për një ndërmjetësim të koordinuar nga shteti. Tarifat e

avokatit nuk mund të kërkojnë për një mbledhje të procesit të rregullt ligjor për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Asnjë shpërblim ose shumëfishim

Gjykata do të përcaktojë sasinë që konsiderohet të jetë tarifë e arsyeshme për avokatin, bazuar në tarifën tipike në komunitetin ku paraqitet veprimi ose procedimi dhe në llojin e cilësinë e shërbimit të ofruar.

Asnjë shpërblim ose “shumëfishim” nuk mund të përdoret në llogaritjen e sasisë së tarifave të avokatit të dhëna nga gjykata. Për shembull, nëse tarifa juaj për avokatin ishte 40.000 dollarë, ju nuk do të merrni 10.000 dollarë ekstra (shpërblim) ose 80.000 dollarë (dyfishi i tarifave tuaja) ose 120.000 dollarë (trefishi i tarifave tuaja).

A ka ndonjë rast kur gjykata mund të mos m’i japë tarifën e avokatit për shërbimet e kryera pas një oferte me shkrim për zgjidhjen e çështjes?

Po, juve mund të mos u jepen tarifën e avokatit dhe mund të mos rimburoheni për kostot përkatëse për çfarëdolloj veprimi ose procedimi sipas paragrafit 615 të IDEA-s (të tilla si seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor ose apeli) për shërbimet që u kryen pasi ju morët ofertë me shkrim për zgjidhjen e çështjes, nëse:

- Oferta u bë brenda kohës së parashikuar nga rregulli 68 i rregullave federale të procedurës civile ose, në procedimin e rishikimit të çështjes, në çdo kohë më shumë se 10 ditë përpara fillimit të procedimit;
- Ju nuk e pranuat ofertën brenda 10 ditësh; dhe
- Gjykata ose administratori i seancës dëgjimore administrative vendos se ndihma që morët më në fund nuk është më e favorshme sesa oferta për zgjidhjen e çështjes.

PËRJASHTIM: Juve mund t’ju paguhen tarifën e avokatit dhe kostot përkatëse nëse jeni pala mbizotëruese dhe kishit arsye të justifikuar për refuzimin e ofertës për zgjidhjen e çështjes.

A ka ndonjë rast kur gjykata mund ta zvogëlojë shumën e tarifave të avokatit për shërbimet e kryera pas një oferte me shkrim për zgjidhjen e çështjes?

Po, nëse:

- Ju ose avokati tuaj, gjatë periudhës së veprimit ose procedimit, në mënyrë të paarsyeshme vonuat zgjidhjen përfundimtare të mosmarrëveshjes;
- Shuma e tarifave të avokatit tuaj është në mënyrë të paarsyeshme më e madhe sesa tarifa për orë që është tipike në komunitet për shërbime të ngjashme që ofrohen nga avokatë me aftësi, reputacion dhe përvojë të ngjashme;
- Koha e shpenzuar dhe shërbimet e ofruara ligjore ishin të tepërta duke mbajtur parasysht natyrën e veprimit ose procedimit; ose
- Avokati që ju përfaqësoi nuk i dha distriktit shkollor informacionin e përshtatshëm në njoftimin e kërkesës së procesit të rregullt ligjor sipas rregullores federale 34 C.F.R. paragrafi 300.508.

PËRJASHTIM: Kushtet e mësipërme nuk zbatohen në ndonjë veprim ose procedim nëse gjykata zbulon se shteti ose distrikti shkollor në mënyrë të paarsyeshme vonuan zgjidhjen përfundimtare të veprimit ose procedimeve, duke shkelur kështu paragrafin 614 të IDEA-s.

Si mund të marr informacion të mëtejshëm në lidhje me procesin e rregullt ligjor?

Për informacion të mëtejshëm në lidhje me procesin e rregullt ligjor, kontaktoni:

- Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
25 South Front Street, Mail Stop 202
Telefon (614) 466-2650,
Telefon falas i Ministrisë së Arsimit të Shtetit
Ohio (877) 644-6338.
- Referojuni paragrafit 615 të ligjit të vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (IDEA) (Individuals with Disabilities Education Improvement Act - IDEA), ligji publik 108-446, kongresi i 108^{të}, i shpallur më 3 dhjetor 2004 (H.R.1350) dhe që hyri në fuqi më 1 korrik 2005, 20 U.S.C. 1415; rregullave federale të kodit 34 të rregullores federale (Code of Federal Regulations (CFR) paragrafët 300.507-300.518; paragrafët 3323.04 dhe 3323.05 të kodit të ripunuar të Ohio-s dhe rregulli 3301-51-05 i kodit administrativ të Ohio-s. Rregulli është pjesë e *Standardeve vepruese për agjencitë*

edukative në Ohio që u shërbejnë fëmijëve me paaftësi.

- Këshillohuni me avokatin tuaj.

DISIPLINA

Termet “disiplinë” dhe “ndëshkim” shpesh përdoren në vend të njëra-tjetrës për t’iu referuar praktikave të përmirësimit të sjelljes. Në kundërshtim me disa pikëpamje, të dy praktikat nuk janë e njëjta gjë. Kuptimi i dallimeve është i rëndësishëm për një klasë të suksesshme dhe për të qenë një prind i suksesshëm. Ky kuptim do t’i ndihmojë mësuesit dhe prindërit që të promovojnë një sjellje më bashkëpunuese, të përgjegjshme, të sigurt dhe të shëndetshme për të gjithë nxënësit.

Ndëshkimi është thjesht një “ndreqje e shpejtë.” Ndëshkimi shpesh nuk e zgjidh problemin dhe, kur përdoret veçmas, ndalon vetëm sjelljen e menjëhershme. Ndëshkimi kërkon pak ndryshim në bindjet ose mendimet e fëmijës tuaj dhe zakonisht nuk ka asnjë vlerë në të mësuarit e fëmijës tuaj. Ndëshkimi nuk do ta ndryshojë sjelljen për një periudhë të gjatë sepse nevoja thelbësore e fëmijës që po shkakton sjelljen nuk është përmbushur. Ndëshkimi përqendrohet në veprimin e fëmijës, jo në shkakun. Zakonisht ngjall te fëmija ndjenjat e zemërimit, mungesës së respektit, hakmarrjes ose mposhtjes.

Disiplina, nga ana tjetër, është metodë e ndryshimit të sjelljes përmes planifikimit, mësimit dhe vlerësimit. Disiplina e efektshme siguron pasoja të përshtatshme dhe logjike për sjelljen e fëmijës tuaj dhe rezulton në ndryshime pozitive dhe afatgjata në sjellje. Disiplina e vërtetë nuk përqendrohet në sjellje të izoluar, por është një proces mësimi që i jep fëmijës një shumëllojshmëri aftësish që janë të nevojshme për të mësuar. Disiplina trajton shkakun e sjelljes dhe ndihmon në krijimin e një mjedisi mësimi të sigurt dhe pozitiv për të gjithë.

Disiplina është e fortë, e drejtë dhe në përputhje me sjelljen. Ajo kërkon përkushtim, planifikim dhe zgjidhje të problemit në mënyrë të vazhdueshme.*

*Fragmente nga: *Strategji për zhvillimin e një sistemi të plotë për menaxhimin e klasës*

Cfarë është pezullimi nga shkolla?

Pezullimi është një largim “disiplinor” i fëmijës tuaj nga vendosja (vendndodhja e edukimit) aktuale për sjellje të keqe. Pezullimi mund të jetë për deri në 10 ditë shkollë rresht në të njëjtin vit shkollor. Largimi për një periudhë më të gjatë mund të quhet “përrjashtim.”

Vini re se distrikti shkollor mund ta largojë fëmijën tuaj për periudha të tjera deri në 10 ditë shkollë me radhë gjatë të njëjtit vit shkollor për incidente të veçanta të sjelljes së keqe, për sa kohë që ato nuk e nxjerrin fëmijën jashtë nga vendndodhja e edukimit. “Ndryshimi i vendosjes” diskutohet më tej në paragrafët e mëposhtëm dhe përkufizohet në segmentin “Përkufizime” të këtij botimi.

Gjatë pezullimit, distrikti shkollor nuk vë në dispozicion të fëmijës edukim publik falas të përshtatshëm ose nuk vë në zbatim programin edukativ të individualizuar për fëmijën tuaj.

Ekzistojnë lloje të ndryshme pezullimesh, ku përfshihen:

- Pezullimi zyrtar;
- Largimi urgjent;
- Largimi i fëmijës tuaj nga shkolla përpara përfundimit të ditës së rregullt shkollor;
- Pezullimi nga autobusi, nëse transporti është një shërbim që ka lidhje me programin edukativ të individualizuar dhe nuk është siguruar ndonjë transport tjetër. (SHËNIM: Nëse fëmija juaj vjen në shkollë gjatë pezullimit nga autobusi, ato ditë nuk llogariten si ditë pezullimi nga shkolla);
- Pezullim në shkollë kur nuk sigurohen shërbimet e edukimit special. Nëse programi edukativ i individualizuar i fëmijës tuaj është duke u kryer, pezullimi në shkollë nuk llogaritet ndaj 10 ditëve të pezullimit; ose
- Pezullim në shkollë ku fëmija juaj transferohet në një vendndodhje tjetër në shkollë (si p.sh. në zyrë) ku programi edukativ i individualizuar i fëmijës tuaj nuk kryhet për periudha të gjata kohe ose për periudha të përsëritura kohe.

Çfarë ndodh nëse fëmija im me paaftësi pezullohet për 10 ditë shkollë ose më pak në të njëjtin vit shkollor?

Këshilli i politikave edukative që është krijuar për çdo nxënës që pezullohet nga shkolla zbatohet gjithashtu edhe për fëmijën tuaj.

Distriktit nuk i kërkohet që:

- Të krijojë një plan vlerësimi të sjelljes (për të mësuar më shumë mbi sjelljen e fëmijës tuaj) ose për të krijuar ndërhyrje (forma të ndihmës për të përmirësuar sjelljen);
- Të bëjë një përcaktim të manifestimit (të përcaktojë nëse sjellja e fëmijës tuaj u shkaktua nga paaftësia e tij ose e saj); ose
- Shërbime të tjera.

Megjithatë, ekipi i IEP-së gjatë periudhës 10 ditore mund të përcaktojë:

- Nëse programi edukativ i individualizuar i fëmijës tuaj është i përshtatshëm;
- Nëse programi edukativ i individualizuar i fëmijës tuaj është duke u zbatuar;
- Nëse një plan vlerësimi është i nevojshëm për të shqyrtuar arsyen e mundshme të sjelljes së fëmijës tuaj; dhe
- Nevojën për ndihmë, strategji dhe mbështetje, për të ndihmuar fëmijën tuaj që të krijojë sjellje pozitive.

Largimi i fëmijës tim nga shkolla për arsye disiplinore kur do të konsiderohet si ndryshim i vendosjes (vendndodhjes edukative)?

Largimi nga shkolla për arsye disiplinore konsiderohet si ndryshim i vendosjes kur:

- Largimi është për më shumë se 10 ditë shkollë rresht në të njëjtin vit shkollor; ose
- Fëmija juaj i është nënshtruar një seri largimesh që sugjerojnë një sjellje të përsëritur:
 1. Sepse seria e largimeve përbën më shumë se 10 ditë shkollë në një vit shkollor;
 2. Sepse sjellja e fëmijës tuaj është shumë e ngjashme me sjelljen e fëmijës tuaj në situata të mëparshme që shkaktuan serinë e largimeve; ose
 3. Për shkak të faktorëve shtesë, të tillë si kohëzgjatja e çdo largimi, sasia e përgjithshme e kohës që fëmija juaj është larguar dhe afërsia e largimeve nga njëri-tjetri.

SHËNIM: Largimi për më shumë se 10 ditë rresht në të njëjtin vit shkollor ose seritë e largimeve që sugjerojnë një sjellje të përsëritur dhe që përbëjnë më shumë se 10 ditë shkollë në të njëjtin vit shkollor mund të quhet përrjashtim.

Kush vendos nëse një sjellje e përsëritur e largimeve disiplinore përbën ndryshim të vendosjes (vendndodhjes edukative)?

Drejtuesit e shkollës vendosin rast-pas-rasti nëse një sjellje e përsëritur e largimeve disiplinore është ndryshim i vendosjes.

Çfarë ndodh nëse ndryshon vendosja e fëmijës tim?

Përpara ndryshimit të vendosjes së fëmijës tuaj për shkelje të rregullave të shkollës, distrikti shkollor duhet t'i sigurojë fëmijës tuaj disa mbrojtje. Një prej këtyre mbrojtjeve është që distrikti shkollor duhet të bëjë një "përcaktim të manifestimit"; me fjalë të tjera, të përcaktojë nëse sjellja e fëmijës tuaj kishte lidhje me ose ishte rezultat i paaftësisë së tij.

Çfarë mund të bëj nëse nuk jam dakord me ndryshimin e vendosjes?

Ju mund të kërkonit një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor për të kundërshtuar vendimin për ndryshimin e vendosjes edukative të fëmijës tuaj. Administratori i seancës dëgjimore do të vendosë nëse distrikti shkollor ka treguar se i zbatoi kërkesat kur ndryshoi vendosjen e fëmijës tuaj. Procesi i seancës dëgjimore shpjegohet me më shumë hollësi në paragrafët e mëposhtëm dhe në segmentin "Procesi i rregullt ligjor" të këtij dokumenti. Seanca dëgjimore "e përshpejtuar" e procesit të rregullt ligjor zhvillohet më shpejt sesa seanca dëgjimore "normale" e procesit të rregullt ligjor dhe diskutohet me hollësi më poshtë.

Çfarë është përcaktimi i manifestimit?

Përcaktimi i manifestimit është një vendim që sjellja e fëmijës tuaj u shkaktua nga paaftësia e tij (me fjalë të tjera, ishte një manifestim i saj). Ky përcaktim bëhet nga distrikti shkollor, ju prindi, dhe anëtarët e duhur (të nevojshëm) të ekipit të IEP-së ("anëtarët e duhur" përcaktohen nga ju dhe distrikti shkollor).

Kur kryhet rishikimi i përcaktimit të manifestimit? Kush e kryen përcaktimin e manifestimit?

Përcaktimi i manifestimit kryhet brenda 10 ditësh shkolle nga çfarëdolloj vendimi për të ndryshuar vendosjen (vendndodhjen edukative) të fëmijës

tuaj me paftësi për shkak të një shkeljeje të rregullave të shkollës.

Distrikti shkollor, prindi dhe anëtarët e duhur të ekipit të IEP-së bëjnë përcaktimin e manifestimit. Ata duhet të shqyrtojnë të gjithë informacionin përkatës në dosjen e fëmijës, duke përfshirë programin edukativ të individualizuar të fëmijës, komentet e çdo mësuesi dhe çdo informacion përkatës të dhënë nga prindërit.

Ky informacion përkatës përdoret për të përcaktuar:

1. Nëse sjellja në fjalë e fëmijës tuaj u shkaktua ose kishte lidhje të drejtpërdrejtë dhe të rëndësishme me paaftësinë e fëmijës; ose
2. Nëse sjellja e fëmijës ishte rezultat i drejtpërdrejtë i moszbatimit nga distrikti shkollor i programit edukativ të individualizuar.

Nëse ju, distrikti shkollor dhe anëtarët e nevojshëm të ekipit të IEP-së vendosni se sjellja e fëmijës përmbush një kusht në numrin 1 ose numrin 2 më sipër, atëherë sjellja është një manifestim i paftësisë së fëmijës tuaj.

Nëse përmbushet kushti i përshkruar në numrin 2 më sipër, distrikti shkollor duhet të marrë masa të menjëhershme për të zbatuar programin edukativ të individualizuar.

Çfarë mund të bëj nëse nuk jam dakord me përcaktimin e manifestimit?

Ju mund të kërkonit një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor për të kundërshtuar vendimin. Administratori i seancës dëgjimore do të vendosë nëse distrikti shkollor ka treguar se sjellja e fëmijës tuaj ishte ose jo një shfaqje e paftësisë së fëmijës tuaj, sipas kushteve të mësipërme. Procesi i seancës dëgjimore diskutohet me më shumë hollësi në paragrafët e mëposhtëm dhe në segmentin "Procesi i rregullt ligjor".

Çfarë duhet të bëjë ekipi IEP nëse u përcaktua se sjellja ishte manifestim i paftësisë së fëmijës tim?

Nëse sjellja është manifestim i paftësisë së fëmijës tuaj, ekipi IEP duhet:

1. Ose:

- Të fillojë të kryejë një vlerësim të sjelljes funksionale (shihni segmentin “Përkufizime”) brenda 10 ditësh nga përcaktimi i manifestimit dhe ta përfundojë vlerësimin sa më shpejt që të jetë e mundur, përveçse kur distrikti shkollor ka kryer një vlerësim të sjelljes funksionale përpara sjelljes që shkaktoi ndryshimin e vendosjes dhe duhet të miratojë një plan ndërhyrës për sjelljen e fëmijës tuaj; ose
- Nëse plani ndërhyrës për sjelljen është krijuar tashmë, brenda 10 ditësh nga përcaktimi i manifestimit, të rishikojë planin dhe zbatimin e tij dhe ta ndryshojë atë sipas nevojës, për të adresuar sjelljen; dhe

2. Ta rikthejë fëmijën tuaj në vendndodhjen nga e cila u hoq, përveçse kur prindi dhe distrikti shkollor bien dakord për një ndryshim të vendndodhjes si pjesë e ndryshimit në planin ndërhyrës për sjelljen.

“Plani ndërhyrës për sjelljen” është një plan për të adresuar një sjellje të fëmijës tuaj që nuk është e përshtatshme në shkollë.

A ka ndonjë përjashtim ndaj kërkesës që fëmija im të rikthehet në vendndodhjen nga e cila u hoq, nëse sjellja ishte një manifestim i paaftësisë së fëmijës tim?

Po, distrikti nuk është i detyruar ta rikthejë fëmijën tuaj në vendndodhjen nga e cila u hoq për një sjellje të caktuar. Përkundrazi, distrikti mund ta dërgojë fëmijën tuaj në një vendosje edukative alternative të përkohshme (interim alternative educational setting – IAES që nënkupton një vendndodhje edukative të ndryshme) për deri në 45 ditë shkolle, edhe nëse sjellja e fëmijës tuaj ishte një manifestim i paaftësisë së tij, nëse fëmija juaj:

- Sjell armë ose zotëron armë në shkollë ose në mjediset shkollore ose në një veprimtari shkollorë në juridiksionin e një distrikti shkollor ose të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.
- Me dijeni zotëron ose përdor droga të paligjshme, ose shet apo përpiqet të blejë apo të shesë një substancë të kontrolluar ndërsa është në shkollë ose në mjediset të shkollës ose në një veprimtari shkollorë nën autoritetin e një distrikti shkollor ose të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio

- I ka shkaktuar lëndim të rëndë trupor një personi tjetër gjatë shkollës, në mjediset shkollore ose në një veprimtari shkollorë nën autoritetin e një distrikti shkollor ose të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.

Nëse sjellja në fjalë e fëmijës tim nuk ishte manifestim i paaftësisë së tij, si do të disjelinohet fëmija im?

Nëse sjellja nuk ishte rezultat i paaftësisë së fëmijës tuaj, personeli i shkollës do të zbatojë procedurat disiplinore të zakonshme të shkollës. Shkolla mund ta disjelinohet fëmijën tuaj në të njëjtën mënyrë dhe për të njëjtën periudhë kohe siç do të disjelinonte fëmijët pa paaftësi.

Nëse fëmija juaj hiqet nga vendosja edukative e tanishme (vendndodhja), fëmija juaj duhet:

- Të vazhdojë të marrë shërbime edukative në mënyrë që fëmija juaj të vazhdojë të marrë pjesë në programin edukativ të përgjithshëm, por në një vendndodhje tjetër, dhe të ecë përpara drejt arritjes së qëllimeve të vendosura në programin edukativ të individualizuar të fëmijës tuaj; dhe
- Të marrë, kurdoherë që konsiderohet e përshtatshme, një vlerësim funksional të sjelljes dhe ndryshime të sjelljes që synojnë të adresojnë sjelljen në mënyrë që të mos ndodhë përsëri.

SHËNIM: Personeli i shkollës mund të mbajë parasysh çdo rrethanë të veçantë rast-pas-rasti kur përcakton nëse do të urdhërojë një ndryshim në vendosje për një fëmijë me paaftësi që shkel një kod të sjelljes së nxënësit.

Si do të njoftohem nëse distrikti shkollor vendos të ndryshojë vendosjen e fëmijës tim për shkak të shkeljes së një rregulli shkollor?

Në datën që merret vendimi për të ndryshuar vendosjen e fëmijës tuaj për shkak të shkeljes së një rregulli shkollor, distrikti shkollor duhet:

- T’ju njoftojë për vendimin; dhe
- T’ju japë njoftimin për të drejtat tuaja të masave mbrojtëse procedurale (një kopje të “E kujt është kjo IDEA?”).

Kush vendos se cila do të jetë vendndodhja edukative alternative e përkohshme (IAES –

ose vendndodhja e përkohshme e ndryshme) dhe çfarë shërbimesh do të marrë fëmija im?

Ekipi IEP përcakton IAES-në dhe shërbimet e përshtatshme kurdoherë që:

- Fëmija juaj shkel rregullat shkollore dhe ndryshimi i vendndodhjes edukative bëhet për më shumë se 10 ditë rresht. Kjo ndodh gjithashtu kur ekziston një sjellje e përsëritur e heqjes së fëmijës tuaj nga vendndodhja edukative normale që përbën më shumë se 10 ditë shkolle në një vit shkollor; ose
- Vendosja e fëmijës tuaj u ndryshua për shkak të rrethanave të veçanta që kanë lidhje me armë, drogë ose lëndime të rënda trupore ndaj një personi tjetër.

Për sa kohë mund të jetë fëmija im në një vendndodhje edukative alternative të përkohshme?

Nëse sjellja e fëmijës tuaj nuk u shkaktua drejtpërdrejt nga paaftësia e tij, fëmija juaj mund të jetë në një IAES për të njëjtën sasi kohe që do të disiplinohet një fëmijë pa paaftësi.

Nëse sjellja e fëmijës tuaj ishte e lidhur drejtpërdrejt ose e shkaktuar nga paaftësia e fëmijës tuaj dhe:

- Sjellja e fëmijës tuaj kishte të bënte me shkeljen e rregullave shkollore: fëmija juaj duhet të kthehet në vendndodhjen edukative nga e cila u hoq, përveçse kur ju dhe distrikti shkollor bini dakord për një ndryshim të vendndodhjes si pjesë e ndryshimit në planin ndërhyrës për sjelljen ose programin edukativ të individualizuar;
- Sjellja e fëmijës tuaj përfshiu një armë ose një shkelje që ka lidhje me drogën ose lëndimin e rëndë trupor të një personi tjetër: fëmija juaj mund të dërgohet në një IAES për deri në 45 ditë.

Po sikur të mos jem dakord me vendimin e vendosjes që rezulton nga veprimi disiplinor?

Ju mund të kërkonte një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor për të kundërshtuar një vendim të vendosjes për një veprim disiplinor. Procesi i seancës dëgjimore diskutohet me më shumë hollësi më poshtë dhe në segmentin "Procesi i rregullt ligjor" të këtij botimi.

Si mund të kërkoj një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor?

Kur kërkonte seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor:

- Paraqisni kërkesën me shkrim pranë shefit dhe dërgoni një kopje te Zyra për Fëmijët e Veçantë:
 1. Dërgojani ankesën origjinale të procesit të rregullt ligjor shefit të distriktit shkollor të vendbanimit të fëmijës suaj;
 2. Dërgoni një kopje të ankesës suaj të procesit të rregullt ligjor me postë ose me faks tek:
Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.

- Distrikti shkollor duhet të kontaktojë personin në ngarkim të seancave dëgjimore të procesit të rregullt ligjor në Zyrën për Fëmijët e Veçantë përpara përfundimit të ditës së nesërme të punës.
- Një administrator i seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor do të caktohet nga Zyra për Fëmijët e Veçantë përpara përfundimit të ditës së nesërme të punës nga dita që distrikti informon zyrën në lidhje me kërkesën.
- Administratori i seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor do t'ju kontaktojë brenda 24 orësh nga emërimi i tij për të caktuar seancën dëgjimore.
- Seanca dëgjimore e përshpejtuar do të kryhet brenda 20 ditëve shkollore nga data që u kërkuar seanca dëgjimore dhe duhet të rezultojë në një vendim brenda 10 ditëve shkollore pas seancës dëgjimore.

Referojuni segmentit "Procesi i rregullt ligjor" për informacion në lidhje me ato që duhet të përfshini në kërkesën tuaj të procesit të rregullt ligjor.

Çfarë mund të bëjë distrikti shkollor nëse beson se ruajtja e vendosjes (vendndodhjes edukative) së tanishme të fëmijës tim ka shumë të ngjarë të rezultojë në lëndim të fëmijës tim ose të të tjerëve?

Nëse distrikti shkollor beson se ruajtja e vendosjes së tanishme të fëmijës tuaj ka shumë të ngjarë të rezultojë në lëndim të fëmijës tuaj ose të të tjerëve, distrikti shkollor mund:

- Të kryejë një mbledhje të IEP-së për të shqyrtuar programin edukativ të individualizuar dhe për ta diskutuar shqetësimin me ju dhe me anëtarët e tjerë të ekipit IEP. Nëse ju dhe distrikti shkollor nuk binë dakord në lidhje me mënyrën se si ta adresoni shqetësimin e distriktit, distrikti mund të kërkojë një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor; ose
- Të kërkojë menjëherë një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor pa kryer një mbledhje të IEP-së; ose
- Të kërkojë një urdhër nga një gjykatë ose një masë tjetër që lejohet nga ligji.

Nëse distrikti shkollor kërkon një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor, cilat janë hapat e tjera?

Nëse distrikti shkollor kërkon një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor, distrikti shkollor duhet:

- T'ju japë një kopje me shkrim të kërkesës dhe njoftimit të masave mbrojtëse procedurale ("E kujt është kjo IDEA?"), nëse kjo është ankesa juaj e parë e procesit të rregullt ligjor gjatë një viti shkollor; dhe
- Të bëjë një përcaktim të manifestimit brenda 10 ditësh shkollor të vendimit për pezullim.

Çfarë ndodh nëse nuk jam dakord me vendimin e administratorit të seancës dëgjimore?

Ju mund ta kundërshtoni me shkrim vendimin e administratorit të seancës dëgjimore brenda 45 ditëve kalendarike që kur ju njoftohet vendimi. Dërgojeni apelin tuaj tek:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
Shihni faqen 31 për informacionin e kontaktit.

I dërgoni një kopje të apelit tuaj shefit të distriktit shkollor të vendbanimit.

Për më shumë informacion në lidhje me procesin e apelit shihni segmentin "Procesi i rregullt ligjor" të këtij botimi.

Ku do të jetë fëmija im gjatë apelit tim të vendimit të administratorit të seancës dëgjimore?

July 1, 2008

Fëmija juaj do të qëndrojë në IAES deri në 45 ditë shkollore nëse vendosja e fëmijës tuaj në IAES u urdhërua nga administratori i seancës dëgjimore. Në fund të 45 ditëve shkollore, nëse distrikti beson se kthimi i fëmijës tuaj në vendosjen fillestare ka shumë të ngjarë të rezultojë në lëndim të fëmijës ose të të tjerëve, distrikti mund të paraqesë një kërkesë të re të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor.

Kur mund të kërkoj seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor?

Ju mund të kërkonit seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor vetëm për të kundërshtuar:

- Përcaktimin e manifestimit për fëmijën tuaj; ose
- Çdo vendim në lidhje me vendosjen e fëmijës tuaj gjatë një veprimi në lidhje me disiplinën.

Siç u vu re më sipër, distrikti shkollor mund të kërkojë një seancë dëgjimore të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor nëse distrikti beson se vazhdimi i vendosjes së fëmijës tuaj ka shumë të ngjarë të rezultojë në lëndimin e fëmijës suaj ose të të tjerëve.

Ku arsimohet fëmija im gjatë një seance të përshpejtuar të procesit të rregullt ligjor?

Fëmija juaj duhet të qëndrojë në IAES (vendndodhje edukative të përkohshme) derisa administratori i seancës dëgjimore të marrë vendimin, ose derisa pezullimi ose përjashtimi të ketë përfunduar, cilado nga këto të ndodhë më parë.

Si mund të kërkoj një apel të vendimit të dhënë në një seancë dëgjimore të përshpejtuar?

Duhet ta bëni kërkesën tuaj, me shkrim, në Zyrën për Fëmijët e Veçantë brenda 45 ditëve kalendarike nga dita kur jeni njoftuar për vendimin me shkrim të administratorit të seancës dëgjimore.

- Dërgojeni apelin tuaj origjinal me postë tek:
Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Procedural Safeguards Section
25 South Front Street
Mail Stop #202
Columbus, Ohio 43215-4183
Faks: (614) 728-1097

Faqja 55

- Dërgojini një kopje të apelit tuaj shefit të distriktit shkollor.

Rishikimi duhet të përfundojë dhe një vendim me shkrim duhet të jepet nga nëpunësi i rishikimit në nivel shtetëror brenda 30 ditëve kalendarike. Nuk mund të ketë asnjë zgjatje të periudhës prej 30 ditësh. Ju mund ta apeloni vendimin e nëpunësit të rishikimit në nivel shtetëror në gjykatën e duhur të kërkesave të zakonshme ose në gjykatën federale të distriktit. Shihni segmentin "Procesi i rregullt ligjor" për informacion se si ta apeloni vendimin e nëpunësit të rishikimit në nivel shtetëror.

Fëmija im nuk është identifikuar si fëmijë me paaftësi, por unë mendoj se ai ka një paaftësi që kërkon edukim special. A ka fëmija im ndonjë mbrojtje nëse ai ose ajo ka shkelur një rregull shkollor?

Nëse distrikti shkollor e dinte se fëmija juaj ishte fëmijë me paaftësi përpara sesa fëmija juaj të shkelte rregullin shkollor, ju mund të kërkonte që fëmijës tuaj t'i jepen të njëjtat të drejta si fëmijët e tjerë me paaftësi.

Distrikti shkollor konsiderohet se e ka ditur se fëmija juaj ishte fëmijë me paaftësi nëse çdonjëri nga rastet e mëposhtme ndodhi përpara sesa fëmija juaj të shkelte rregullin shkollor:

- Ju i shprehët shqetësimin tuaj me shkrim drejtuesve ose personelit administrativ të distriktit të shkollës tuaj ose një mësuesi të fëmijës se fëmija juaj ka nevojë për shërbime të edukimit special;
- Ju kërkuat një vlerësim për fëmijën tuaj; ose
- Mësuesi i fëmijës tuaj ose personeli tjetër i shkollës:
 - I shprehu – drejtpërdrejt drejtorit të edukimit special ose personelit tjetër drejtues të distriktit shkollor – shqetësimet të caktuara në lidhje me një sjellje të përsëritur që po shfaq fëmija juaj.

Distrikti juaj shkollor do të konsiderohet se nuk kishte dijeni se fëmija juaj është fëmijë me paaftësi nëse:

- Ju:
 1. Nuk keni lejuar që fëmija juaj të vlerësohet; ose
 2. Keni refuzuar edukimin special dhe shërbimet përkatëse për fëmijën tuaj; ose

- Fëmija juaj është vlerësuar dhe është vendosur se ai nuk është fëmijë me paaftësi.

Nëse distrikti shkollor nuk ka dijeni se fëmija juaj është fëmijë me paaftësi përpara marrjes së veprimit disiplinor, fëmija juaj mund të marrë të njëjtën disiplinë si fëmijët pa paaftësi që sillen në mënyrë të ngjashme.

Çfarë do të ndodhë nëse unë ose një palë tjetër kërkojmë vlerësim të fëmijës tim ndërsa fëmija im është duke u disiplinuar?

Nëse ju ose një palë tjetër bëni një kërkesë ndërsa fëmija juaj është duke u disiplinuar, fëmija juaj duhet të vlerësohet sa më shpejt që të jetë e mundur.

Derisa të përfundojë vlerësimi, fëmija juaj qëndron në vendosjen edukative të përcaktuar nga autoritetet shkollore, që mund të përfshijë pezullimin ose përjashtimin pa shërbime edukative.

Pas përfundimit të vlerësimit, një grup individësh të kualifikuar dhe ju, prindi, përcaktoni nëse fëmija juaj është fëmijë me paaftësi.

Vendimi i grupit do të mbajë parasysh informacionin nga vlerësimi i distriktit tuaj shkollor dhe informacionin që dhatë ju.

Nëse fëmija im vlerësohet së është fëmijë me paaftësi, a mundet që distrikti shkollor t'ia referojë fëmijën tim policisë dhe gjykatës dhe t'i japë atyre dokumentacionin shkollor të fëmijës?

Ligji i vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (IDEA) lejon që një distrikt ose agjenci shkollore t'i raportojë autoriteteve përkatëse një krim të kryer nga një fëmijë me paaftësi. IDEA lejon gjithashtu që forcat shtetërore të ruajtjes së rendit dhe gjykatat të ushtrjnë përgjegjësitë e tyre në zbatimin e ligjit federal dhe shtetëror ndaj krimeve të kryera nga një fëmijë me paaftësi.

Nëse një distrikt ose agjenci shkollore raporton një krim të kryer nga fëmija juaj, distrikti shkollor duhet të sigurojë që kopje të dokumentacionit të edukimit special të fëmijës tuaj dhe të dhënat mbi disiplinën t'u jepen autoriteteve ku distrikti ose agjencia bën raportimin e krimit.

Distrikti ose agjencia shkollore që raporton krimin mund të dërgojë kopje të dokumentacionit të edukimit special të fëmijës tuaj dhe të dhëna mbi disiplinën, vetëm nëse lejohet ta bëjë këtë sipas ligjit mbi privatësinë dhe të drejtat edukative familjare.

SHKOLLAT JOPUBLIKE (PRIVATE)

Në Ohio, një shkollë private quhet shkollë jopublike.

Çfarë lloj shkollash jopublike ekzistojnë dhe a ka ndonjë ndryshim për mua ose për fëmijën tim?

Shkollë jopublike është një shkollë që drejtohet nga individë privatë ose një korporatë apo organizatë private. Ekzistojnë dy lloj shkollash jopublike: (1) të varura, të cilat janë të autorizuar nga shteti Ohio dhe (2) të pavarura, të cilat lejohen të funksionojnë, por nuk i përmbushin të gjitha kushtet e kërkuara për t'u autorizuar nga shteti. (Shihni përkufizimin e shkollave jopublike në segmentin "Përkufizime").

Nxënësit individualë me paaftësi, që vendosen nga prindërit e tyre në një shkollë jopublike (të varur ose të pavarur) mund të marrin shërbime nga distrikti i shkollave publike siç përshkruhen në këtë segment. Megjithatë, nuk ka asnjë garanci. Shihni pyetjen e mëposhtme për të mësuar se cilat janë kushtet që fëmija juaj të marrë shërbime.

Cilat janë të drejtat e mia nëse jam duke konsideruar vendosjen e fëmijës tim me paaftësi në një shkollë jopublike pa miratim ose rekomandim të distriktit shkollor?

Nëse jeni duke konsideruar vendosjen e fëmijës tuaj në një shkollë jopublike pa miratimin ose rekomandimin e distriktit shkollor:

- Distriktit të vendbanimit tuaj nuk i kërkohet të paguajë koston e edukimit, përfshirë edukimin special dhe shërbimet përkatëse, përveçse kur distrikti shkollor nuk ka vënë në dispozicion të fëmijës tuaj edukim publik falas të përshtatshëm. (Kjo nënkupton se distrikti juaj shkollor ju ka ofruar edukim special dhe shërbime përkatëse dhe ju i keni refuzuar ato).
- Nëse fëmija juaj ka të drejtë të marrë shërbime, distrikti shkollor ku jetoni (i quajtur distrikti shkollor i vendbanimit) është përgjegjës për vendosjen në dispozicion të fëmijës tuaj të një edukimi publik falas të

përshtatshëm. Nëse ju e bëni të qartë qëllimin tuaj për ta mbajtur fëmijën tuaj të regjistruar në shkollën jopublike, distrikti ku jetoni nuk ka nevojë të krijojë një program edukativ të individualizuar për fëmijën tuaj.

- Nëse vendosni ta regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë jopublike në vend të distriktit tuaj shkollor të vendbanimit, distriktit të vendbanimit tuaj nuk i kërkohet që të paguajë koston e edukimit, përfshirë edukimin special dhe shërbimet përkatëse, përveçse kur distrikti shkollor nuk ka vendosur në dispozicion të fëmijës tuaj një edukim publik falas të përshtatshëm.
- Ju keni të drejtë që fëmija juaj të vlerësohet nga distrikti shkollor ku ndodhet shkolla jopublike, i cili mund të mos jetë distrikti juaj shkollor i vendbanimit.
- Distrikti shkollor ku ndodhet shkolla jopublike do të këshillohet me shkollën jopublike në lidhje me mënyrën se si distrikti shkollor do t'i shpenzojë një pjesë të parave të tij për t'u shërbyer fëmijëve në shkollën jopublike.
- Distrikti shkollor mund të vendosë që të shpenzojë një pjesë të parave për t'i shërbyer fëmijës tuaj, por distriktit nuk i kërkohet që t'i shërbejë fëmijës tuaj. Me fjalë të tjera, fëmija juaj nuk ka asnjë të drejtë individuale që të marrë shërbimin.
- Distrikti shkollor bën përcaktimin përfundimtar nëse fëmija juaj do të marrë ndonjë shërbim dhe, nëse po, shërbimet që do të marrë.
- Nëse distrikti vendos t'i shërbejë fëmijës tuaj, ai do të krijojë një plan shërbimi.
- Plani i shërbimit është i ndryshëm nga plani edukativ i individualizuar sepse plani i shërbimit nuk siguron një edukim publik falas të përshtatshëm.

Për informacion të mëtejshëm, shihni *Udhëzimet për sigurimin e shërbimeve për fëmijët me paaftësi të vendosur nga prindërit në shkollat jopublike të varura dhe të pavarura në Ohio (Guidelines for Providing Services to Children with Disabilities Parentally Placed in Ohio Chartered and Nonchartered Nonpublic Schools)* (shtator 2005; Rish. maj 2006; Rish. korrik 2008). Këto janë të botuara në faqen e internetit të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio, www.ode.state.oh.us, kërkimi me fjalët kyçe: *Udhëzimet për sigurimin e shërbimeve për fëmijët me paaftësi (Guidelines for Providing Services to Children with Disabilities)*.

Çfarë mund të bëj nëse shkolla jopublike ku shkon fëmija im nuk këshillohet me distriktin shkollor ku ndodhet shkolla jopublike në lidhje me shpenzimin e parave për t'u shërbyer fëmijëve në shkollën jopublike?

Në këtë rast, ju mund të kontaktoni drejtpërdrejt distriktin shkollor për të kërkuar shërbime për fëmijën tuaj.

A mund të shkëmbejë informacion distrikti shkollor ku ndodhet shkolla jopublike me distriktin tonë shkollor të vendbanimit?

Ju duhet të jepni miratimin tuaj përpara se informacioni personal në lidhje me fëmijën tuaj të shkëmbehet ndërmjet nëpunësve në distriktin shkollor ku ndodhet shkolla jopublike dhe distriktit shkollor ku jetoni.

A heq dorë nga ndonjë e drejtë kur e vendos fëmijën tim në një shkollë jopublike?

Duhet ta dini se të drejtat tuaja për masat mbrojtëse procedurale nuk janë të njëjta nëse vendosni që ta fusni fëmijën në një shkollë jopublike.

Procesi i rregullt ligjor: Nuk keni asnjë të drejtë të procesit të rregullt ligjor përtej "gjetjes së fëmijës", përgjegjësisë së distriktit për të identifikuar, gjetur dhe vlerësuar fëmijën tuaj; sigurimit nga distrikti të një programi të përshtatshëm për fëmijën tuaj, pavarësisht nëse vendosni të përfitonit nga ky program ose jo; dhe sigurimit nga distrikti të sasisë së përshtatshme të parave siç deklarohet me ligj për të siguruar njëfarë edukimi special dhe shërbime përkatëse për grupin e fëmijëve me paaftësi të vendosur në shkolla jopublike nga prindërit.

Gjithashtu, fëmijës tuaj nuk i garantohet ndonjë shërbim ose ndonjë pjesë shërbimi që fëmija juaj do të merrte po të ishte regjistruar në një shkollë publike.

Ankesat: Keni të drejtë të paraqisni një ankesë me shkrim pranë Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio në lidhje me:

- Gjetjen e fëmijës (identifikimin, gjetjen dhe vlerësimin e fëmijës tuaj);
- Identifikimin dhe vlerësimin;
- Kryerjen e shërbimeve të cilat distrikti shkollor ka rënë dakord që t'i sigurojë;

- Sasinë e fondeve që distrikti shkollor duhet të shpenzojë;
- Vendndodhjen e shërbimeve;
- Transportin;
- Ndarjen e klasave;
- Kërkesat që fondet të mos shkojnë në përfitim të një shkolle jopublike;
- Përdorimin e personelit të shkollës publike;
- Përdorimin e personelit të shkollës jopublike; dhe
- Kërkesat në lidhje me pasurinë, pajisjet dhe furnizimet.

Shihni segmentin "Ankesat" të këtij dokumenti për informacion në lidhje me mënyrën si të paraqisni një ankesë me shkrim.

Kur i kërkohet distriktit shkollor publik që ta paguajë të gjithë ose një pjesë të edukimit jopublik të fëmijës tim?

Nëse fëmija juaj ka marrë edukim special dhe shërbime përkatëse nga distrikti shkollor dhe ju e regjistroni fëmijën tuaj në një shkollë jopublike pa miratimin ose rekomandimin e distriktit shkollor, atëherë një administrator i seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor ose gjykatë mund të kërkojë që distrikti shkollor t'ju paguajë për koston e vendosjes në shkollën jopublike nëse:

- Distrikti shkollor i vendbanimit nuk ka vënë në dispozicion të fëmijës tuaj një edukim publik falas të përshtatshëm brenda një kohe të arsyeshme përpara regjistrimit në shkollën jopublike; dhe
- Vendosja e fëmijës tuaj në shkollën jopublike është e përshtatshme.

Administratori i seancës dëgjimore ose gjykata mund të konkludojë se vendosja nga prindi (që është vendimi juaj për ta vendosur fëmijën në shkollë jopublike) është e përshtatshme, edhe nëse nuk përmbush standardet që zbatohen për edukimin e siguruar nga shteti dhe distriktet shkollore.

Kostot e rimbursimit (sasia që distrikti shkollor duhet t'ju paguajë) për edukimin jopublik mund të zvogëlohet ose të mohohet nga administratori i seancës dëgjimore ose gjykata nëse:

- Në mbledhjen më të fundit të IEP-së ku morët pjesë para heqjes së fëmijës tuaj nga shkolla publike, ju nuk e informuat ekipin IEP se po e refuzonit vendosjen e propozuar (d.m.th. masat e distriktit për edukimin e

fëmijës tuaj) dhe nuk i deklaruar shqetësimet tuaja dhe qëllimin tuaj për regjistrimin e fëmijës në shkollë jopublike me shpenzimet publike (të distriktit tuaj shkollor);

- Ju nuk i dhatë njoftim me shkrim distriktit shkollor të paktën 10 ditë pune paraprakisht (përfshirë festat që bien në ditë pune) përpara heqjes së fëmijës tuaj nga shkolla publike, se po refuzoni masat e propozuara nga distrikti për sigurimin e një edukimi publik falas të përshtatshëm për fëmijën tuaj. Ky njoftim me shkrim duhet të përfshijë një deklaratë të shqetësimeve tuaja dhe synimin tuaj për ta regjistruar fëmijën në një shkollë jopublike me shpenzime publike;
- Përpara heqjes së fëmijës tuaj nga shkolla publike, shkolla ju informoi në lidhje me qëllimin e saj për të vlerësuar fëmijën dhe ju nuk e sollët fëmijën tuaj për vlerësim; OSE
- Ekziston një vendim ligjor që thotë se veprimet e kryera prej jush ishin të paarsyeshme.

Kostoja e rimbursimit (përsëri, sasia që do t'ju paguhet) për vendosjen në shkollën jopublike nuk mund të zvogëlohet ose mohohet nëse nuk dhatë njoftim me shkrim për një prej këtyre arsyeve:

- Nuk mund të lexoni ose shkruani në anglisht;
- Dhënia e njoftimit me shkrim ka të ngjarë të rezultojë në lëndim të rëndë fizik ose emocional të fëmijës suaj;
- Shkolla nuk ju lejoi që ta jepni një njoftim të tillë; ose
- Nuk e morët njoftimin për të drejtat tuaja të masave mbrojtëse procedurale (një kopje të këtij dokumenti, "*E kujt është kjo IDEA?*") dhe nuk ju tha se duhej të jepnit njoftim me shkrim.

A mund të marrë fëmija im shërbime në ndërtesën e shkollës jopublike?

Nëse distrikti shkollor publik vendos dhe shkolla jopublike pranon, fëmija juaj mund të marrë shërbime në ndërtesën e shkollës jopublike.

A sigurohet transport për fëmijën tim?

Nëse fëmija juaj është duke ndjekur një shkollë jopublike të varur, atij i sigurohet transport në po në atë masë sa ç'i sigurohet çdo fëmije pa paaftësi që është duke ndjekur një shkollë jopublike të varur.

Nëse fëmija juaj është duke ndjekur një shkollë jopublike të pavarur, fëmijës tuaj nuk i sigurohet transport, përveçse kur transporti renditet si shërbim përkatës në planin e shërbimit të fëmijës tuaj.

Nëse fëmija juaj është duke ndjekur një shkollë jopublike të varur ose të pavarur dhe plani i shërbimit për fëmijën tuaj kërkon shërbime që jepen në një vendndodhje tjetër, atëherë atij duhet t'i sigurohet transporti nga dhe tek ajo vendndodhje .

Transporti duhet të sigurohet për te dhe nga shkolla jopublike ose shtëpia e fëmijës për te vendndodhja e shërbimeve, në varësi të kohës së shërbimeve.

PËRKUFIZIME

Rishikimi administrativ

Një mbledhje gjatë së cilës mund t'i paraqisni ankesa shefit të distriktit tuaj shkollor në lidhje me vlerësimin, vendosjen edukative ose sigurimin e edukimit special për fëmijën tuaj.

Mosha e rritur

Mosha kur të drejtat e edukimit special transferohen prej jush te fëmija juaj (18 vjeç në Ohio). Një shpjegim i këtyre të drejtave (një kopje e “*E kujt është kjo IDEA?*”) duhet t'i jepet fëmijës suaj të paktën një vit më parë se ditëlindja e 18-të e tij apo e saj.

Qëllimet vjetore

Deklaratat në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj që përshkruajnë se çfarë mund të pritët që ai ose ajo të arrijë në një vit.

Vlerësimi

Metoda ose mjete që përdoren për të matur:

- Rezultatet mësimore të tanishme dhe nevojat edukative;
- Plotësimin e kushteve për shërbime;
- Përparimin drejt arritjes së qëllimeve; dhe
- Kategorinë e paaftësisë.

Pajisje teknologjike ndihmëse

Çdo pajisje ose produkt që përdoret për të rritur, ruajtur ose përmirësuar aftësitë e fëmijës tuaj me paaftësi. Termi nuk përfshin pajisjet mjekësore që implantoohen në mënyrë kirurgjike në trup apo zëvendësimin e një shërbimi të tillë.

Shërbimi teknologjik ndihmës

Çdo shërbim që ndihmon drejtpërdrejt fëmijën tuaj me paaftësi në zgjedhjen, marrjen ose përdorimin e një pajisjeje teknologjike ndihmëse, duke përfshirë:

- Vlerësimin e nevojave të fëmijës suaj;
- Sigurimin e pajisjeve teknologjike ndihmëse për fëmijët me paaftësi;
- Koordinimin dhe përdorimin e terapive dhe shërbimeve të tjera me pajisje teknologjike ndihmëse;
- Trajnimin ose ndihmën teknike për një fëmijë me paaftësi, ose, nëse është e përshtatshme, për familjen e tij; dhe
- Trajnimin ose ndihmën teknike për profesionistët që janë angazhuar në funksionet jetike kryesore të fëmijës.

Plani ndërrhyrës për sjelljen

Plani për adresimin e sjelljes së papërshtatshme të fëmijës suaj në shkollë.

Standard matës

Një deklaratë specifike se çfarë duhet të dijë dhe të jetë në gjendje të bëjë fëmija juaj, në një kohë të caktuar të vitit shkollor. Standardet matëse përshkruajnë se deri në çfarë mase pritët që të përparojë fëmija drejt qëllimit vjetor dhe brenda cilit afat.

Konferenca e çështjes

Mbledhje jozyrtare që ju lejon juve ose distriktin tuaj shkollor që të rishikoni informacionin në lidhje me fëmijën tuaj dhe programin edukativ të individualizuar të tij, në mënyrë që të zgjidhen problemet.

Ndryshimi i vendosjes si disiplinë

Largimi nga shkolla për arsye disiplinore konsiderohet si ndryshim i vendosjes kur:

- Largimi është për më shumë se 10 ditë shkolle me radhë në të njëjtin vit shkollor; ose
- Fëmija juaj i është nënshtruar një seri largimesh që sugjerojnë një sjellje të përsëritur:
 - Për shkak se numri i largimeve përbën më shumë se 10 ditë shkolle në një vit shkollor;
 - Për shkak se sjellja e fëmijës suaj është shumë e ngjashme me sjelljen e tij në raste të mëparshme që kanë rezultuar në një sërë largimesh; dhe
 - Për shkak të faktorëve të tillë shtesë, si kohëzgjatja e çdo largimi, periudha kohore totale për të cilën është hequr fëmija dhe afërsia kohore e largimeve nga njëri-tjetri.

Fëmijë me paaftësi

Ose (a) një fëmijë që ka një paaftësi, e cila përputhet me përkufizimin e një termi të paaftësisë të përfshirë në pjesën “Përkufizimet e termave të paaftësisë”, ose (b) sipas vendimit të distriktit, një fëmijë me vonesë zhvillimi (shihni përkufizimin më vonë në këtë pjesë) i cili ka nevojë për edukim special dhe shërbime përkatëse.

Shkollë komuniteti

Një shkollë publike, e krijuar në bazë të kapitullit 3314 të kodit të ripunuar, që është e pavarur nga çdo distrikt shkollor dhe është pjesë e programit edukativ shtetëror. Shkollat e komunitetit konsiderohen shkolla distrikti kur vjen puna për edukimin e fëmijëve me paaftësi sipas kapitullit 3323 të kodit të ripunuar dhe kapitullit 3301-51 të kodit administrativ.

Ankesë

Një dokument zyrtar me shkrim (një formular) që prindi ose një palë tjetër paraqet te Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio, Zyra për Fëmijët e Veçantë, ku pretendohet se një distrikt shkollor ose agjenci tjetër publike nuk po ndjek ligjet ose rregulloret që kanë të bëjnë me kualifikimin e fëmijës për edukim special ose marrjen e edukimit special dhe shërbimeve përkatëse.

Vazhdimi i mundësive alternative për vendosje

(Vendodhja e edukimit)

Një përzgjedhje shërbimesh, duke përfshirë mësimdhënien në klasa ose shkolla speciale; mësimdhënien në shtëpi, spitale dhe institucione; dhe shërbimet shtesë (të tilla si klasa e ndihmës në shkollë ose mësuesi vizitor) që mund t'i sigurohen një fëmije me paaftësi paralelisht me klasat e rregullta.

SHËNIM: Ndryshimi në sasinë e kohës që një fëmijë me paaftësi harxhon në vende të veçanta NUK konsiderohet si ndryshim i vendosjes (i vendndodhjes edukative) dhe nuk kërkon lejen e prindërve. Ndryshimi nga një ndërtesë në tjetrën gjithashtu nuk është ndryshim i vendosjes që kërkon lejen e prindërve, për aq kohë sa vendosja e re është në një mjedis të ngjashëm (p.sh. në një klasë ndihme) siç ishte në ndërtesën e mëparshme. Për shembull, nëse fëmija ishte në klasën e mësimit të rregullt gjatë një pjese të kohës dhe në klasën e ndihmës gjatë pjesës tjetër të kohës, por më pas shkon në një ndërtesë të re ku fëmija është në klasën e mësimit të rregullt gjatë një pjese të kohës dhe në klasën e ndihmës gjatë pjesës tjetër të kohës, atëherë nuk ka ndryshim të vendosjes që kërkon lejen e prindërve. Nëse fëmija ishte në klasën e mësimit të rregullt për katër lëndë dhe në klasën e ndihmës për dy lëndë, dhe orari i fëmijës ndryshohet në tri lëndë në klasën e mësimit të rregullt dhe tri lëndë në klasën e ndihmës, ky nuk është ndryshim i vendosjes që kërkon lejen e prindërve.

Vonesë në zhvillim

July 1, 2008

Një fëmijë 3 deri në 5 vjeç për të cilin një ekip vlerësimi me profesionistë të kualifikuar ka përcaktuar se po përjeton vonesë në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme: zhvillimi fizik, zhvillimi kognitiv, zhvillimi në komunikim; zhvillimi social ose emocional; apo zhvillimi adaptiv. Termi mund të përdoret në vend të kategorive të mëposhtme të paaftësisë: paaftësi kognitive; çrregullim emocional; mangësi në të folur ose gjuhë.

Proces i rregullt ligjor

Një sërë hapash të shënuar në ligjin e vitit 2004 për përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi (IDEA) që mbron të drejtat e prindërve dhe fëmijëve të tyre me paaftësi.

Ankesa e procesit të rregullt ligjor dhe seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor

Seanca dëgjimore e paanshme e procesit të rregullt ligjor është një seancë dëgjimore zyrtare që mbahet me kërkesën e një prindi ose agjencie publike. Kjo bëhet për të zgjidhur një ankesë të procesit të rregullt ligjor që ka të bëjë me kualifikimin e një fëmije për edukim special dhe shërbime përkatëse, ose marrjen e tyre.

Shërbimet e ndërhyrjes së hershme

Shërbimet që i sigurohen një fëmije me paaftësi ose me vonesë në zhvillim që nga lindja deri në moshën 2 vjeç.

Vlerësimi

Procedurat e përdorura për të përcaktuar nëse fëmija juaj ka paaftësi dhe shërbimet e edukimit special e ato përkatëse për të cilat ka nevojë fëmija juaj.

Ekipi i vlerësimit

Ekipi i programit edukativ të individualizuar (IEP) të fëmijës dhe profesionistë të tjerë të kualifikuar që konsiderohen të nevojshëm.

Edukimi publik i përshtatshëm falas (FAPE)

Edukimi special dhe shërbimet përkatëse që sigurohen me shpenzimet e publikut, nën mbikëqyrjen dhe drejtimin publik dhe pa asnjë kosto për prindërit. Këto shërbime duhet të plotësojnë standardet e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio; duhet të përfshijnë një edukim të përshtatshëm parashkollor, fillor ose të shkollës së mesme në shtet; dhe duhet të bazohen në programin edukativ të individualizuar të fëmijës suaj (IEP).

Vlerësimi funksional i sjelljes

Procesi që mund të përfshijë intervista, vëzhgime të drejtpërdrejta dhe vlerësime të tjera të sjelljes së nxënësit. Procesi përdoret për të përcaktuar se çfarë e nxit sjelljen e papërshtatshme në mjedisin e fëmijës, si dhe cilat sjellje zëvendësoese duhet t'i mësohen fëmijës, në mënyrë që fëmija të ketë rezultate dhe reagime pozitive. Disa nga pyetjet e bëra si pjesë e vlerësimit funksional të sjelljes mund të përfshijnë: Çfarë ndodhi para sjelljes? Çfarë ndodhi gjatë sjelljes? Cili ishte rezultati i sjelljes? Në cilin mjedis ndodhi sjellja? A ka ndryshuar ilaçi i fëmijës? A e piu fëmija ilaçin në kohën e duhur?

Vlerësimi funksional profesional

Procesi i përdorur për të identifikuar karakteristikat e punës dhe trajnimin e nxënësit, si dhe ndihmën për të cilën nxënësi ka nevojë në lidhje me kërkesat aktuale të punës. Informacioni i vlerësimit funksional mbledhet në mënyrë që të gjendet puna që i përshtatet sa më mirë nxënësit.

Programi i përgjithshëm mësimor

I njëjti program mësimor që u mësohet nxënësve që nuk kanë paaftësi.

Fëmijët e pastrehë

Shihni termin "fëmijë dhe të rinj të pastrehë" në paragrafin (42 U.S.C. 11434a) të ligjit McKinney-Vento për ndihmën për të pastrehët sipas ndryshimeve, 42 U.S.C. 11431 dhe më pas.

IDEA

Ligji i vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi në 20 U.S.C. 1400, ligji publik 108-446 i Kongresit të 108^{të}, 3 dhjetor 2004.

Vlerësimi i pavarur edukativ (IEE)

Vlerësimi i një fëmije i bërë nga një profesionist i trajnuar që nuk është i punësuar nga distrikti shkollor i fëmijës.

Programi edukativ i individualizuar (IEP)

Një deklaratë me shkrim për fëmijën tuaj që zhvillohet, rishikohet dhe ripunohet në përputhje me rregulloret federale dhe shtetërore.

Ekipi i programit edukativ të individualizuar (IEP)

Një grup individësh që kanë përgjegjësi për zhvillimin, rishikimin ose ripunimin e një programi edukativ të individualizuar për një fëmijë me paaftësi.

July 1, 2008

Vendndodhja edukative alternative e përkohshme (IAES)

Kur një fëmijë disiplinohet, distrikti shkollor mund ta largojë fëmijën nga vendosja (vendodhja) edukative aktuale e tij. Ekipi IEP i fëmijës do të përcaktojë një vendosje të përkohshme të përshtatshme për fëmijën, të quajtur vendndodhje edukative alternative e përkohshme (IAES). Në rrethanat e mëposhtme, cilido zyrtar i shkollës mund ta përcaktojë IAES-në:

Kur fëmija:

- Solli armë në shkollë ose kishte armë gjatë kohës që ishte në shkollë, në mjediset e shkollës, në një aktivitet shkollor nën autoritetin e distriktit shkollor ose të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio;
- Me dijeni zotëroi ose përdori drogë të paligjshme ose shiti apo u përpoq të blejë ose shesë ndonjë substancë të kontrolluar gjatë kohës që ishte në shkollë, në mjediset e shkollës, në një aktivitet shkollor nën autoritetin e distriktit shkollor ose të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio; ose
- Bëri plagosje të rëndë trupore të një personi tjetër gjatë kohës që ishte në shkollë, në mjediset e shkollës ose në një aktivitet shkollor nën autoritetin e distriktit shkollor ose të Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio;

Arbitrimi i IEP-së

Kur një profesionist i trajnuar, i paanshëm ndihmon ekipin e IEP-së për të krijuar një program edukativ të individualizuar cilësor për një fëmijë.

Ekipi ndërhyrës i ndihmës (Intervention Assistance Team - IAT)

Një ekip mësuesish nga shkolla e fëmijës suaj që takohen për të përpiluar forma të ndryshme ndihme për fëmijët që po hasin vështirësi. Ju mund të ftoheni për të marrë pjesë në një mbledhje IAT në lidhje me fëmijën tuaj.

Mjedisi sa më pak kufizues (LRE)

Sa më shumë që të jetë e mundur, fëmijët me paaftësi (duke përfshirë fëmijët në shkolla publike ose jopublike ose në institucione të tjera kujdesi) edukohen në të njëjtin vend me fëmijët që nuk kanë paaftësi. Një fëmijë me paaftësi largohet nga mjedisi edukativ i rregullt vetëm atëherë kur paaftësia e fëmijës është aq e rëndë sa fëmija nuk mund të edukohet në klasat e

Faqja 62

mësimin të rregullt me përdorimin e ndihmave dhe shërbimeve shtesë.

Njohuri e kufizuar e anglishtes (Limited English Proficient - LEP)

Kur një fëmijë ka aftësi të kufizuar ose nuk mund të flasë, të lexojë, të shkruajë ose të kuptojë gjuhën angleze. Gjithashtu shiheni këtë term të përkufizuar në paragrafin 9101 të ligjit të vitit 1965 mbi arsimin fillor dhe të mesëm.

Përcaktimi i manifestimit

Një përcaktim që thotë se sjellja e fëmijës suaj u shkaktua ose erdhi si rezultat i paaftësisë së tij. Ky përcaktim bëhet nga distrikti shkollor, ju prindi dhe anëtarët përkatës të ekipit IEP (“anëtarët përkatës” përcaktohen prej jush dhe distriktit shkollor).

Ndërmjetësimi

Një proces vullnetar për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve midis dy palëve, i cili drejtohet nga një palë e tretë e trajnuar, e paanshme e quajtur ndërmjetës. Ndërmjetësi mund të zgjidhet nga një listë e ndërmjetësve që mbahet nga Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio.

Modifikimi

Çdo ndryshim që bëhet në shkollën, punën ose mjedisin e fëmijës suaj, për të plotësuar nevojat edukative individuale të tij ose të saj.

Gjuha amtare

1. Për një individ me aftësi të kufizuar të anglishtes përfshin:
 - Gjuhën që përdoret normalisht nga ai individ, ose, në rastin e fëmijës suaj, gjuha e përdorur normalisht prej jush si prindër të fëmijës, përveç rastit siç theksohet në pikën e mëposhtme.
 - Në të gjithë kontaktin e drejtpërdrejtë me fëmijën tuaj (duke përfshirë vlerësimin e fëmijës suaj), gjuha e përdorur normalisht nga fëmija juaj në shtëpi ose në mjedisin e të mësuarit.
2. Për një individ të shurdhët ose të verbër ose për një individ pa gjuhë të shkruar, mënyra e komunikimit është ajo që përdoret zakonisht nga individit (si p.sh. gjuha me shenja, Braj, ose komunikimi me gojë).

Shkolla jopublike

Shkolla jopublike është një institucion i të mësuarit, i organizuar dhe i mbajtur nga individë privatë ose nga ndonjë korporatë ose organizatë
July 1, 2008

private. Shkollat jopublike të varura konsiderohen "shkolla private" që duhet të plotësojnë "Standardet e duhura operative për shkollat e shtetit Ohio" të përcaktuara në kapitullin 3301-35 të kodit administrativ. Shkollat e pavarura, të pafinancuara nga taksat nuk janë në varësi ose nuk kërkojnë që të jenë në varësi të Këshillit Arsimor të Shtetit për shkak të besimeve fetare tepër të forta.

Objektivi

Një detyrë mësimore më e vogël dhe më e administrueshme që duhet të zotërojë fëmija juaj si një hap përpara në arritjen e qëllimit vjetor. Objektivat i ndajnë aftësitë e përkohshme në qëllimin vjetor në komponentë të veçantë të cilët, kur zotërohen në mënyrë të përsosur, e lejojnë fëmijën tuaj të plotësojë qëllimin.

Prindi

(A) "Prind" do të thotë:

- (1) Një prind biologjik ose adoptues i një fëmije, por jo një prind kujdestar i përkohshëm, (SHËNIM: Prindi kujdestar i përkohshëm e ka të ndaluar në bazë të ligjit të shtetit Ohio që të shërbejë si prind, pasi kujdestaria ligjore e fëmijës nën kujdes të përkohshëm mbahet nga një agjenci e shërbimit të fëmijëve dhe jo nga prindi kujdestar i përkohshëm. Një prind kujdestar i përkohshëm mund të caktohet si prind zëvendësues nëse prindi kujdestar i përkohshëm i plotëson kërkesat e duhura);
 - (2) Një kujdestar i autorizuar në përgjithësi për të vepruar si prindi i fëmijës ose i autorizuar që të marrë vendime edukative për fëmijën (por jo shteti nëse fëmija është nën tutelën e shtetit);
 - (3) Një individ që vepron në vend të një prindi biologjik ose adoptues (duke përfshirë gjyshin apo gjyshen, njerkun apo njerken ose të afërmit e tjerë) me të cilin jeton fëmija ose një individ që ka përgjegjësi ligjore për mirëqenien e fëmijës; ose
 - (4) Një prind zëvendësues që është caktuar në bazë të ligjit 34 C.F.R. 300.519 ose paragrafit 639(a)(5) të IDEA-s;
- (B) Përveç rastit që jepet në pikën (C) të këtij përkufizimi, prindi biologjik ose adoptues, kur përpiqet të veprojë si prind sipas pjesës B të IDEA-s dhe kur më shumë se një palë kualifikohet për të vepruar si prind sipas pikës (A) të këtij përkufizimi, duhet të

presupozohet se është prindi për qëllimet e kësaj pjese, përveç rastit kur prindi biologjik ose adoptues nuk ka autoritet ligjor për të marrë vendime edukative për fëmijën.

- (C) Nëse një dekret ose urdhër ligjor identifikon një person ose persona të caktuar sipas pikës (A)(1) deri në (3) të këtij përkufizimi për të vepruar si "prindi" i fëmijës ose për të marrë vendime edukative në emër të fëmijës, atëherë një person ose persona të tillë do të përcaktohen si "prindi" për qëllimet e këtij përkufizimi.

SHËNIM: Një nxënës në moshën 18 vjeç mund të veprojë në emër të vet.

Vendosja

Përfshin shërbimet që i sigurohen një fëmije me paaftësi, vendndodhjen e shërbimeve dhe ofruesit e këtyre shërbimeve.

Fëmijë parashkollor me paaftësi

1. Një fëmijë që është të paktën 3 vjeç dhe nuk i ka mbushur ende 6 vjeç; dhe
2. Që plotëson përkufizimin e një fëmije me paaftësi, ose, me vendim të distriktit shkollor, është një fëmijë që:
 - Po përjeton vonesa zhvillimore në një ose më shumë nga fushat e mëposhtme: zhvillim fizik, zhvillim kognitiv, zhvillim në komunikim, zhvillim social ose emocional; ose zhvillim adaptiv; dhe
 - që, për shkak të kësaj vonese, ka nevojë për edukim special dhe shërbime përkatëse.

Edukimi special parashkollor

Mësimdhënie e përpiluar në mënyrë specifike që plotëson nevojat e një fëmije me paaftësi, që është nga mosha 3 deri në 5 vjeç.

Nivelet aktuale të përparimit

Deklarata të krijuara nga informacioni në lidhje me një fëmijë. Ky informacion përfshin përparimin e fëmijës në programin aktual edukativ të individualizuar, raportin e ekipit të vlerësimit, mendimin tuaj dhe të fëmijës suaj, ndërhyrjet, vlerësimet, vëzhgimet dhe faktorë të veçantë. Ky informacion jep një "pasqyrë" të fëmijës, duke përfshirë pikat e forta dhe nevojat e tij apo të saj.

Masat mbrojtëse procedurale

Procedura të krijuara sipas ligjit dhe rregullave federale dhe shtetërore që mbrojnë të drejtat e

fëmijëve me paaftësi dhe prindërit e tyre, në lidhje me një fëmijë që merr edukim publik falas të përshtatshëm.

Agjenci publike

Përfshin distriktet shkollore, këshillat e rrethit për personat me të meta mendore dhe paaftësi në zhvillim, agjenci të tjera edukative, shkollat e komunitetit dhe nënsektorë të tjerë politikë të shtetit që kanë përgjegjësi për sigurimin e edukimit për fëmijët me paaftësi.

Shpenzime publike

Paguar nga distrikti shkollor ose ndryshe, siguruar për prindërit pa pagesë.

Rivlerësimi

Procesi që përdoret për të përcaktuar nëse fëmija vazhdon të ketë paaftësi dhe nevojat edukative të tij.

Rekomandimi

Kërkesa e një prindi, distrikti shkollor ose agjencie tjetër edukative për vlerësimin e parë ose rivlerësimin e një fëmije, i cili ose dyshohet se ka paaftësi ose është konfirmuar se ka paaftësi.

Shërbime përkatëse

Shërbimet e transportit dhe ato të zhvillimit, shërbimet korigjuese dhe shërbime të tjera ndihmëse që janë të detyrueshme për të ndihmuar një fëmijë që të përfitojë nga edukimi i tij apo i saj special. Këto përfshijnë shërbimet e shënuara në rregullin federal 34 CFR 300.34.

Arbitrimi i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

Kur një profesionist i trajnuar, i paanshëm thirret në një mbledhje për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, i caktuar nga distrikti shkollor në përpjekje për të zgjidhur një ankesë të procesit të rregullt ligjor, atëherë ky quhet arbitrim i mbledhjes për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. "Arbitri" përpiqet që të ndihmojë prindin dhe anëtarët e ekipit IEP për zgjidhjen e mosmarrëveshjes.

Distrikti shkollor

Një distrikt shkollor i qytetit, lokal, i shkollave të përjashtuara të fshatit ose një shkollë komuniteti.

Distrikti shkollor i vendbanimit

Distrikti shkollor në zonën ku banojnë prindërit e fëmijës me paaftësi. Nëse fëmija juaj është

regjistruar në një shkollë komuniteti, atëherë shkolla e komunitetit konsiderohet si distrikti shkollor i vendbanimit të fëmijës suaj.

Plani i shërbimeve

Një deklaratë me shkrim që përshkruan edukimin special dhe shërbimet përkatëse që distrikti shkollor do t'i sigurojë fëmijës me paaftësi, i cili është vendosur nga prindërit në një shkollë jopublike dhe që është caktuar për të marrë shërbime. Ky plan përfshin vendndodhjen e shërbimeve dhe çdo transport të nevojshëm.

Edukimi special

Mësimdhënie e përpiluar në mënyrë specifike, pa pagesë për prindërit, për të plotësuar nevojat unike të fëmijës me paaftësi, duke përfshirë mësimdhënien që jepet në klasë, shtëpi, spitale dhe institucione, si dhe në mjedise të tjera; dhe mësimdhënien në edukimin fizik, dhe që përfshin kushtet e cilësuar në rregullin federal 34 CFR 300.39.

Provimet e standardizuara

Provime që jepen në të njëjtën mënyrë çdo herë dhe që ndahen në nënkategori për të vlerësuar fusha të ndryshme të aftësisë. Provimet e inteligjencës, provimet e përparimit ose gjuhës, të zhvillimit, të sjelljes adaptive, të vlerësimit të sjelljes dhe të lëvizjeve të imta motorike, të lëvizjeve të mëdha motorike dhe provimet perceptuese pamore janë disa shembuj të provimeve të standardizuara.

Rishikimi në nivel shteti

Rishikim i vendimit të seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor, të cilin ose prindi, ose distrikti shkollor e ka apeluar. Drejtohet nga një nëpunës rishikimi në shkallë shteti, i caktuar nga Zyra për Fëmijët e Veçantë.

Qëndrim në vend

Statusi edukativ i fëmijës suaj gjatë një seance dëgjimore të procesit të rregullt ligjor. Fëmija juaj duhet të qëndrojë në mjedisin edukativ aktual të tij ose të saj, përveçse kur agjencia shtetërore ose lokale dhe prindi bien dakord për diçka tjetër.

Ndihmat dhe shërbimet shtesë

Këto janë ndihma, shërbime dhe mbështetje të tjera që ofrohen në klasat e edukimit të rregullt, në mjedise të tjera përkatëse edukimi dhe në mjedise jashtëshkollore dhe jomësimore. Ato kanë për qëllim që t'i mundësojnë fëmijët me

paaftësi për t'u edukuar sa më shumë që të jetë e mundur me fëmijët që nuk kanë paaftësi.

Prind zëvendësues

Prindi zëvendësues është një individ që mund të përfaqësojë një fëmijë me paaftësi në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me kualifikimin e fëmijës për shërbime të edukimit special dhe marrjen e këtyre shërbimeve dhe atyre përkatëse. Prindi zëvendësues caktohet nëse prindi i fëmijës nuk mund të identifikohet ose të gjendet, nëse fëmija është nën tutelën e shtetit ose nëse fëmija është një i ri i pastrehë i pashoqëruar.

Pezullimi

Kur shkolla e largon fëmijën tuaj nga vendosja (vendndodhja) e tij edukative aktuale për deri në dhjetë ditë me radhë për shkak të ndonjë shkeljeje në sjellje.

Shërbimet tranzitore

Një grup i koordinuar aktivitetesh për një fëmijë të moshës 16 vjeç e poshtë, të cilat përqendrohen në përmirësimin e përparimit akademik të fëmijës me paaftësi. Shërbimet tranzitore e ndihmojnë fëmijën për të kaluar nga jeta shkollore në jetën e të rriturit, duke përfshirë arsimin e lartë, trajnimin në punë, punësimin, edukimin e mëtejshëm dhe atë të të rriturit, shërbimet e të rriturit dhe të jetuarin në mënyrë të pavarur ose pjesëmarrjen në komunitet. Shërbimet tranzitore bazohen në nevojat individuale të fëmijës, duke marrë parasysh pikat e forta, parapëlqimet dhe interesat e fëmijës. Shërbimet tranzitore mund të përfshijnë mësimdhënien, shërbimet përkatëse, përvojat në komunitet dhe zhvillimin e objektivave të punësimit dhe të tjera të jetesës si i rritur, dhe nëse është e përshtatshme, zhvillimin e aftësive të përditshme jetësore, si dhe sigurimin e një vlerësimi funksional profesional. Për një fëmijë 14 vjeç e poshtë, nëse përcaktohet e përshtatshme nga ekipi IEP, shërbimet tranzitore mund të përqendrohen në kurset e studimit të nxënësit.

Fëmijë nën tutelën e shtetit

Termi "fëmijë nën tutelën e shtetit" do të thotë një fëmijë që përcaktohet nga shteti ku banon se është fëmijë i vënë nën kujdes prindëror të përkohshëm, është nën tutelën e shtetit ose në kujdestarinë e një agjencie publike për mirëqenien e fëmijëve.

Përkufizimet e termave të paaftësisë

Autizmi

Një paaftësi zhvillimi që ndikon së tepërmi në komunikimin gojor dhe jोगojor, si dhe ndërveprimin social, që del në pah zakonisht para moshës 3 vjeç dhe që ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës. Karakteristika të tjera që shpesh shoqërojnë autizmin janë angazhimi në aktivitete përsëritëse dhe lëvizje stereotipe, rezistenca ndaj ndryshimeve mjedisore ose ndaj ndryshimeve në regjimin ditor dhe reagime të pazakonta ndaj përvojave ndijore. Termi nuk ka të bëjë me rastin kur përparimi edukativ i fëmijës është ndikuar në mënyrë të pafavorshme kryesisht për shkak se fëmija ka shqetësime serioze emocionale. Një fëmijë që manifeston karakteristikat e autizmit mbas moshës tre vjeç mund të identifikohet që ka autizëm nëse plotësohen kushtet e dy fjalive të para të këtij përkufizimi.

Paaftësia kognitive (të metat mendore)

Aftësi intelektuale e përgjithshme që është shumë më poshtë se mesatarja e cila ekziston së bashku me mungesat në sjelljen adaptive (me fjalë të tjera, mungesa e aftësisë për t'u adaptuar). Demonstron gjatë periudhës së zhvillimit të fëmijës dhe ndikon në mënyrë negative në përparimin edukativ të fëmijës.

Shurdhim-verbëria

Dëmtimi edhe i të dëgjuarit, edhe i shikimit së bashku. Ky kombinim shkakton një komunikim tepër të rënduar, si dhe probleme të tjera zhvillimi dhe edukative, saqë fëmija me shurdhim-verbëri nuk mund të vihet në programet e edukimit special të përpiluara vetëm për fëmijët e shurdhët ose vetëm për fëmijët e verbër.

Shurdhimi

Një dëmtim i dëgjimit që është aq i rëndë saqë fëmija nuk është në gjendje të përpunojë gjuhën nëpërmjet dëgjimit, me ose pa aparat dëgjimi, dhe kështu kjo ndikon në përparimin edukativ të nxënësit.

Çrregullimi emocional

Një gjendje që tregon një ose më shumë nga karakteristikat e mëposhtme gjatë një periudhe të gjatë kohe dhe në një shkallë të tillë saqë ndikon në përparimin edukativ të fëmijës, duke rezultuar në:

- Një paaftësi për të mësuar që nuk mund të shpjegohet me anë të faktorëve të inteligjencës, ndjeshmërisë ose ata shëndetësorë;
- Një paaftësi për të krijuar ose mbajtur marrëdhënie të kënaqshme me moshatarët dhe mësuesit;
- Lloje të papërshtatshme të sjelljes ose ndjenjave në rrethana normale;

Një gjendje shpirtërore e përgjithshme sunduese mërzitjeje ose depresioni; ose

- Një prirje për të krijuar simptoma fizike ose frikë të shoqëruar me probleme personale ose shkollore.

Termi përfshin skizofreninë. Termi nuk ka të bëjë me fëmijët që janë të keqpërshtatur nga ana sociale, përveç rastit kur përcaktohet se këta fëmijë kanë shqetësime serioze emocionale.

Dëmtimi i dëgjimit

Dëmtim në dëgjim, qoftë i përhershëm ose luhatës, që ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës, por që nuk përfshihet në përkufizimin e shurdhimit.

Paaftësi të shumëfishta

Dëmtime që ndodhin në të njëjtën kohë (të tilla si të metat mendore të shoqëruara nga verbëria dhe të metat mendore të shoqëruara nga dëmtimi ortopedik), kombinimi i të cilave shkakton probleme aq të rënda edukative, saqë nxënësi nuk mund të futet në programet e edukimit special që janë paracaktuar vetëm për një nga dëmtimet. Termi nuk përfshin shurdhim-verbërinë.

Dëmtimi ortopedik

Një dëmtim i rëndë ortopedik që ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës. Termi përfshin dëmtime të shkaktuara nga anomali të bashkëlindura (p.sh. këmbë e deformuar, mungesë e një gjymtyre); dëmtim i shkaktuar nga sëmundja (p.sh. poliomieliti, tuberkulozi i kockave); dhe dëmtime nga shkaqe të tjera (p.sh. paraliza cerebrale, prerja e gjymtyrëve dhe frakturat ose djegiet që shkaktojnë tkurrje të qëndrueshme muskulore).

Dëmtime të tjera të shëndetit

Patja e fuqisë, vitalitetit ose gjallërisë së kufizuar, duke përfshirë ndjeshmërinë e lartë ndaj stimujve të mjedisit, që rezultojnë në ndjeshmëri të kufizuar përsa i përket mjedisit edukativ, që

July 1, 2008

Faqja 66

E kujt është kjo IDEA? Udhëzues për prindërit në lidhje me ligjin e vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi

vjen si pasojë e problemeve shëndetësore kronike ose akute, të tilla si astma, çrregullimi i mungesës së vëmendjes ose çrregullimi i hiperaktivitetit të mungesës së vëmendjes, diabeti, epilepsia, sëmundje zemre, hemofilia, helmimi nga lënda e plumbit, leucemia, pezmatimi i veshkave, ethet reumatizmale ose anemia e qelizave drapërore, si dhe nga sindroma Tourette; dhe ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës.

Paaftësi specifike në të mësuar

Një çrregullim në një ose më shumë nga proceset psikologjike bazë të përfshira në kuptimin ose përdorimin e gjuhës, të folur ose të shkruar, që mund të manifestohet në aftësi jo të përkryera të të dëgjuarit, menduarit, folurit, shkrimit, drejtshkrimit ose përlogaritjeve matematikore. Termi përfshin gjendje të tilla si paaftësi perceptuese, lëndime të trurit, çrregullime minimale të trurit, disleksi dhe afazi të zhvillimit. Termi nuk përfshin fëmijët që kanë probleme në të mësuar, që janë kryesisht rezultat i aftësive të të parit, të të dëgjuarit ose të lëvizjeve motorike, të të metave mendore, të çrregullimit emocional ose të disavantazhit mjedisor, kulturor ose ekonomik.

Dëmtimi i të folurit ose i gjuhës

Çrregullim i komunikimit, si marrja e gojës, shqiptim i rënduar, çrregullim i gjuhës ose i zërit, që ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës.

Lëndimi traumatik i trurit

Lëndim i trurit i shkaktuar nga forcë fizike e jashtme ose nga ndonjë gjendje tjetër mjekësore, duke përfshirë, por duke mos u kufizuar vetëm te hemoragjia cerebrale, anoksia (pakësimi i oksigjenit në gjak), sëmundjet infektive, aneurizmi, tumoret e trurit dhe goditjet

neurologjike që rezultojnë nga trajtimet mjekësore ose kirurgjikale. Lëndimi rezulton në paaftësinë e plotë ose të pjesshme funksionale ose në çrregullimin psiko-social, ose të dyja këto, gjë që ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës. Termi ka të bëjë me lëndimet e hapura ose të mbyllura të kokës, si dhe me gjendjet e tjera mjekësore që rezultojnë në lëndime të pësura nga truri. Lëndimet rezultojnë në çrregullimet e një apo më shumë fushave, si njohja, gjuha, kujtesa, vëmendja, arsyetimi, të menduarit abstrakt, gjykimi, zgjidhja e problemeve, ndijimi, aftësitë perceptuese dhe motorike, sjellja psiko-sociale, funksionet fizike, përpunimi i informacionit dhe të folurit. Termi nuk ka të bëjë me lëndimet e trurit që janë të bashkëlindura ose degjenerative, apo lëndimet e trurit që janë shkaktuar nga trauma gjatë lindjes.

Dëmtimi i shikimit duke përfshirë verbërinë

Dëmtim i shikimit që, edhe me korigjim, ndikon në mënyrë të pafavorshme në përparimin edukativ të fëmijës. Termi përfshin edhe shikimin e pjesshëm, edhe verbërinë. Lëndimi i shikimit për çdo fëmijë do të thotë:

- Një lëndim i shikimit, kryesisht jo perceptues nga natyra, që rezulton në perceptim të matur të shikimit 20/70 ose më të dobët në syrin më të mirë me korigjim; ose
- Një gjendje fizike e syrit që ndikon në funksionin e shikimit në atë shkallë saqë vendosja në edukim special, materialet speciale dhe/ose shërbimet speciale janë të detyrueshme në mjedisin edukativ.

Data e hyrjes në fuqi: 1 korrik 2008

Data të mëparshme të hyrjes në fuqi: shkurt 2000; nëntor 2004; shtesë në nëntor 2004: i hyrë në fuqi në 1 korrik 2005; shtator 2005 (Korigjime teknike 23/9/2005, 7/11/2005, 17/11/2005); 1 mars 2007; 1 mars 2007: Korigjuar më 3 prill 2007

FORMULARË



KËRKESË E DREJTPËRDREJTË PËR NDËRMJETËSIM

Po kërkoj ndërmjetësim nga distrikti shkollor i fëmijës tim, në mënyrë që të zgjidh çështjet që kanë të bëjnë me fëmijën tim me paaftësi. Lutemi kontaktoni distriktin në emrin tim.

Data: _____

Emri i fëmijës: _____

Klasa e fëmijës: _____

Distrikti dhe shkolla që ndjek fëmija: _____

Prindi (emri me shkronja shtypi): _____

Nënshkrimi i prindit: _____

Adresa: _____

Qyteti, shteti dhe kodi postar: _____

Numri/numrat e telefonit: _____

Lutemi postojeni dhe/ose dërgojeni me faks tek:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Mediation Coordinator
25 South Front Street, Mail Stop 202
Columbus, OH 43231-4183
Telefoni: (614) 752-1679
Faksi: (614) 728-1097



Ministria e Arsimit e Shtetit Ohio
Zyra për Fëmijët e Veçantë

FORMULAR ANKESE

Emri i ankuesit: _____

Lidhja e ankuesit me nxënësin: _____

Adresa e ankuesit: _____

Qyteti, shteti dhe kodi postar: _____

Numrat e telefonit të ankuesit:

I punës: (____) _____

I shtëpisë: (____) _____

Adresa e email-it (jo e detyrueshme): _____

Emri i nxënësit: _____

Adresa e nxënësit (nëse adresa është e ndryshme nga ajo e ankuesit): _____

Mosha e nxënësit: _____ Në çfarë klase është nxënësi: _____

Fusha e identifikuar/e dyshuar e paaftësisë së nxënësit: _____

Distrikti i shkollës së vendbanimit të nxënësit: _____

Emri i shkollës që po ndjek nxënësi: _____

Përshkrimi i problemit, duke përfshirë fakte që kanë lidhje me problemin:

DATA E SHKELJES: _____

* Sipas ligjit 34 CFR §300.153 (c) [paraqitja e një ankese], data e shkëljes së pretenduar nuk mund të jetë më shumë se një vit para datës që ju paraqisni këtë ankese.

NJË ZGJIDHJE E PROPOZUAR E PROBLEMIT:

*Zgjidhja e propozuar do të merret në konsideratë, megjithatë, zgjidhja përfundimtare e ankesës do të përcaktohet nga Zyra për Fëmijët e Veçantë e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.

Përshkrimi i problemit, duke përfshirë fakte që kanë lidhje me problemin:

DATA E SHKELJES: _____

* Sipas ligjit 34 CFR §300.153 (c) [paraqitja e një ankesë], data e shkeljes së pretenduar nuk mund të jetë më shumë se një vit para datës që ju paraqisni këtë ankesë.

NJË ZGJIDHJE E PROPOZUAR E PROBLEMIT:

*Zgjidhja e propozuar do të merret në konsideratë, megjithatë, zgjidhja përfundimtare e ankesës do të përcaktohet nga Zyra për Fëmijët e Veçantë e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.

Përshkrimi i problemit, duke përfshirë fakte që kanë lidhje me problemin:

DATA E SHKELJES: _____

* Sipas ligjit 34 CFR §300.153 (c) [paraqitja e një ankesë], data e shkeljes së pretenduar nuk mund të jetë më shumë se një vit para datës që ju paraqisni këtë ankesë.

NJË ZGJIDHJE E PROPOZUAR E PROBLEMIT:

*Zgjidhja e propozuar do të merret në konsideratë, megjithatë, zgjidhja përfundimtare e ankesës do të përcaktohet nga Zyra për Fëmijët e VeçantëVeçantë e Ministrisë së Arsimit të shtetit Ohio.

Përshkrimi i problemit, duke përfshirë fakte që kanë lidhje me problemin:

DATA E SHKELJES: _____

* Sipas Ligjit 34 CFR §300.153 (c) [paraqitja e një ankesë], data e shkeljes së pretenduar nuk mund të jetë më shumë se një vit para datës që ju paraqitet këtë ankesë.

NJË ZGJIDHJE E PROPOZUAR E PROBLEMIT:

*Zgjidhja e propozuar do të merret në konsideratë, megjithatë, zgjidhja përfundimtare e ankesës do të përcaktohet nga Zyra për Fëmijët e Veçantë e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.

Përshkrimi i problemit, duke përfshirë fakte që kanë lidhje me problemin:

DATA E SHKELJES:

* Sipas ligjit 34 CFR §300.153 (c) [paraqitja e një ankese], data e shkeljes së pretenduar nuk mund të jetë më shumë se një vit para datës që ju paraqisni këtë ankese.

NJË ZGJIDHJE E PROPOZUAR E PROBLEMIT:

*Zgjidhja e propozuar do të merret në konsideratë, megjithatë, zgjidhja përfundimtare e ankesës do të përcaktohet nga Zyra për Fëmijët e Veçantë e Ministrisë së Arsimit të Shtetit Ohio.

**SHËNONI ZYRTARËT E SHKOLLËS QË KENI KONTAKTUAR NË LIDHJE ME KËTO ÇËSHTJE:
EMRI/TITULLI**

NËNSHKRIMI I ANKUESIT:

Sipas ligjit 34 C.F.R. 300.153 ky formular duhet të nënshkruhet, përndryshe nuk mund të shqyrtohet dhe do t'ju kthehet juve për ta nënshkruar.

- Zyra për Fëmijët e Veçantë nuk pranon ankese të dërguara me faks ose ankese që dërgohen me email.
- Sipas ligjit 34 C.F.R. 300.153 (c), një kopje e ankesës duhet t'i dërgohet nga ankuesi distriktit kundër të cilit është paraqitur ankese.

Lutemi shënoni kutinë nëse ia keni dërguar një kopje të kësaj ankese shefit të distriktit shkollor kundër të cilit është paraqitur ankese.

Në përfundim të rishikimit nga Zyra për Fëmijët e Veçantë, rezultatet i jepen vetëm prindit ose nxënësit që ka mbushur moshën madhore, si dhe distriktit, përveç rastit kur ankuesi ka marrë dhe paraqitur miratimin e nevojshëm për lëshimin e informacionit. Nëse ankese nuk ka miratimin e nevojshëm për lëshimin e informacionit, ankuesi merr një letër e cila siguron që çdo fushë e identifikuar e mospajimit është adresuar.

Shënim: Përdorimi i këtij formulari nuk është i detyruar. Në vend që të përdorni këtë formular, mund të paraqisni një ankese tuajën, por kërkesa juaj duhet të përfshijë të gjithë informacionin e kërkuar nga rregulli federal 34 CFR §300.153.

Lutemi postojni të gjitha ankesat në adresën e mëposhtme:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Attn: Assistant Director of Procedural Safeguards
25 South Front Street, 2nd Floor
Columbus, OH 43215

Data e hyrjes në fuqi: 1 shkurt 2007



Department of
Education

ANKESË E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR DHE KËRKESË PËR SEANCË DËGJIMORE TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR Udhëzime

Lutemi jepni informacionin e kërkuar në të gjitha fushat.

1. *Emri, ditëlindja dhe klasa e fëmijës.*
2. *Kategoria e paaftësisë:* Jepni listën e të gjitha paaftësive që ka fëmija aktualisht. Nëse fëmija nuk është identifikuar si fëmijë me paaftësi, shënoni "Fëmija nuk është identifikuar" në hapësirën e dhënë.
3. *Adresa e banimit të fëmijës, ose në rastin e një fëmije ose të riu të pastrehë, informacioni i disponueshëm i kontaktit.*
4. *Emri dhe adresa e shkollës që po ndjek fëmija.*
5. *Emri i prindit dhe adresa, nëse adresa është e ndryshme nga ajo e fëmijës, ose në rastin e një fëmije ose të riu të pastrehë, informacioni i disponueshëm i kontaktit të fëmijës.* "I pastrehë" do të thotë i pastrehë brenda kuptimit të paragrafit 725(2) të ligjit McKinney-Vento për ndihmën për të pastrehët, 42 U.S.C. 11434a(2); dhe numrat e telefonit.
6. *Ndërmjetësimi:* Ndërmjetësimi është një shërbim falas i siguruar nga shteti për të zgjidhur mosmarrëveshjet. Pjesëmarrja në ndërmjetësim bëhet plotësisht në baza vullnetare dhe të dyja palët duhet të jenë dakord për të. Ndërmjetësuesi do të planifikojë datat me qëllim që palët të diskutojnë masat ndreqëse për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Ndërmjetësimi kryhet paralelisht me procesin e rregullt ligjor, por mbledhja e ndërmjetësimit zakonisht caktohet para se të kryhet seanca dëgjimore e procesit të rregullt ligjor. Nëse jeni të interesuar në ndërmjetësim, lutemi shënoni vijën e duhur.
7. *Përshkrimi i problemit dhe faktet që kanë lidhje me problemin:* Bëni një përshkrim të natyrës së problemit, i cili është baza e kërkesës suaj për seancën dëgjimore të procesit të rregullt ligjor dhe jepni fakte që kanë lidhje me problemin. **Shembull i problemit:** Problemi është se distrikti shkollor nuk e zbatoi programin edukativ të individualizuar të fëmijës tim. **Shembuj të fakteve që kanë lidhje me problemin:** Fëmija im nuk ka marrë shërbime të të folurit dhe gjuhës, të cilësuar në programin e saj edukativ të individualizuar.
8. *Përshkrimi i zgjidhjes së propozuar:* Shënoni zgjidhjen që po propozoni, në atë shkallë që është e njohur dhe që është në dispozicionin tuaj në atë kohë. **Shembull i zgjidhjes së propozuar:** Propozoj që fëmija im të marrë shërbime të të folurit dhe të gjuhës, të cilësuar në programin e saj edukativ të individualizuar.
9. *Avokati ose përfaqësuesi:* Nëse keni avokat ose përfaqësues në këtë rast, lutemi na jepni emrin dhe adresën e avokatit ose përfaqësuesit. Nëse kjo pjesë plotësohet nga prindi ose LEA (Agjencia Lokale e Arsimit - Local Education Agency) e gjithë korrespondenca dhe i gjithë informacioni i procesit të rregullt ligjor do t'i dërgohet avokatit ose përfaqësuesit dhe jo prindit ose LEA-s.
10. *Nënshkrimi:* Palës që kërkon seancën dëgjimore i kërkohet që të shkruajë me shkronja shtypi, të nënshkruajë dhe të vërë datën në njoftimin e ankesës/kërkesës e seancës dëgjimore të procesit të rregullt ligjor.
11. *Seancë dëgjimore e përshpejtuar, nëse ka të bëjë me rastin:* Prindi mund të kërkojë seancë dëgjimore të përshpejtuar **vetëm** nëse prindi nuk bie dakord me vendimin në lidhje me vendosjen për largimet disiplinore ose nuk bie dakord me përcaktimin e manifestimit. Agjencia lokale e arsimit (LEA) mund të kërkojë seancë të përshpejtuar dëgjimore **vetëm** nëse LEA mendon se mbajtja e fëmijës aty ku është ka gjasa të forta që të rezultojë në lëndimin e fëmijës ose të të tjerëve. **Seanca dëgjimore e përshpejtuar nuk duhet të kërkohet për asnjë arsye tjetër.**
12. *Dorëzimi i kërkesës:* Dërgojani palës tjetër kërkesën origjinale të plotësuar, si dhe dërgoni një kopje te Ministria e Arsimit, në adresën: Ohio Department of Education, Office for Exceptional Children, Procedural Safeguards, 25 South Front Street, Columbus, Ohio 43215-4183 ose dërgoni një kopje me faks te (614) 728-1097.

Shënim: Përdorimi i këtij formulari nuk është i detyruar. Në vend që të përdorni këtë formular, mund të paraqisni një kërkesë tuajën të procesit të rregullt ligjor, por kërkesa juaj duhet të përfshijë të gjithë informacionin e kërkuar nga rregulli federal 34 CFR § 300.508.

July 1, 2008

Faqja 1 nga 4

Ekujt është kjo IDEA? Udhëzues për prindërit në lidhje me ligjin e vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi

**ANKESË E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR DHE KËRKESË PËR SEANCË DËGJIMORE
TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR**


EMRI I FËMIJËS NË EMRIN E TË CILIT PO KËRKOHEM SEANCA DËGJIMORE	DITËLINDJA E FËMIJËS <i>(Muaji/Data/Viti)</i>	KLASA
KATEGORIA E PAAFTËSISË		
ADRESA E BANIMIT TË FËMIJËS, OSE NË RASTIN E NJË FËMIJE OSE TË RIU TË PASTREHË, INFORMACIONI I DISPONUESHËM I KONTAKTIT		
EMRI DHE ADRESA E SHKOLLËS QË NDJEK FËMIJA		
EMRI I PRINDIT DHE ADRESA, NËSE ADRESA ËSHTË E NDRYSHME NGA AJO E FËMIJËS. NË RASTIN E NJË FËMIJE OSE TË RIU TË PASTREHË, INFORMACIONI I DISPONUESHËM I KONTAKTIT TË FËMIJËS.	NUMRI I TELEFONIT ()	
	NUMRI I TELEFONIT GJATË DITËS ()	
KËRKOHEM PËRKTHYES I GJUHËS SHQIPE OSE I GJUHËS ME SHENJA <input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO NËSE PO , cilësoni gjuhën/mënyrën e komunikimit		
EMRI I SHEFIT DHE I DISTRIKTIT SHKOLLOR TË VENDBANIMIT		
NDËRMJETËSIMI <input type="checkbox"/> PO <input type="checkbox"/> JO Jam i interesuar në ndërmjetësim.		
PËRSHKRIMI I PROBLEMIT <i>(Përshkruani natyrën e problemit të fëmijës që ka lidhje me një nismë të propozuar ose me ndryshim të vendosjes ose sigurimin e edukimit falas të përshtatshëm publik). (Bashkëngjisni faqe shtesë nëse është e nevojshme).</i>		



ANKESË E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR DHE KËRKESË PËR SEANCË DËGJIMORE TË PROCESIT
TË RREGULLT LIGJOR (vazhdim)
PËRSHKRIMI I PROBLEMIT (vazhdim)

FAKTE (Jepni fakte që kanë lidhje me problemin e përshkruar më sipër). (Bashkëngjisni faqe shtesë nëse është e nevojshme).

PËRSHKRIMI I ZGJIDHJES SË PROPOZUAR QË PO KËRKONI (Jepni zgjidhjen e propozuar të problemit, me aq sa dini dhe që është në dispozicion të palës në atë kohë). (Bashkëngjisni faqe shtesë nëse është e nevojshme).



ANKESË E PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR DHE KËRKESË PËR SEANCË DËGJIMORE TË PROCESIT TË RREGULLT LIGJOR (vazhdim)

EMRI DHE ADRESA E AVOKATIT OSE PËRFAQËSUESIT PËR PRINDIN/KUJDESTARIN OSE LEA-N. *Nëse e plotësoni këtë pjesë, i gjithë informacioni dhe korrespondenca në lidhje me kërkesën e procesit të rregullt ligjor do t'i dërgohet avokatit ose përfaqësuesit dhe jo prindit ose LEA-s.*

NUMRI I TELEFONIT

()

NUMRI I FAKSIT

()

PALA QË KËRKON SEANCËN DËGJIMORE (Shënoni njërën):

_____ Prindi/kujdestari i fëmijës në emër të të cilit po kërkohet seanca dëgjimore

_____ Distrikti shkollor i vendbanimit (shefi)

_____ Agjenci edukative tjetër (Emri):

_____ Nxënës me paaftësi, që është të paktën 18 vjeç, po jo më shumë se 21 vjeç

Emri (me shkronja shtypi) i palës që kërkon seancën dëgjimore

Nënshkrimi i palës që kërkon seancën dëgjimore

Data e nënshkrimit

KËRKESË PËR SEANCË DËGJIMORE TË PËRSHPEJTUAR (PLOTËSOJENI KËTË PJESË VETËM NËSE PO KËRKONI SEANCË DËGJIMORE TË PËRSHPEJTUAR)

SEANCA DËGJIMORE E PËRSHPEJTUAR MUND TË KËRKOHE TË VETËM NËSE KA LIDHJE ME NJËRËN NGA ARSYET E MËPOSHTME.

Prindi: Si prind/kujdestar i nxënësit, po kërkoj një seancë dëgjimore të përshpejtuar sepse (Shënoni një nga pikat e mëposhtme):

_____ Nuk jam dakord me vendimin në lidhje me vendosjen për largime disiplinore; ose

_____ Nuk jam dakord me përcaktimin e manifestimit.

Distrikti shkollor: Si distrikt shkollor, po kërkoj një seancë dëgjimore të përshpejtuar sepse:

_____ Mendoj se mbajtja e fëmijës aty ku është tani ka gjasa të forta që të rezultojë në lëndimin e fëmijës ose të të tjerëve.

Dorëzimi i kërkesës: Dërgojani palës tjetër kërkesën origjinale të plotësuar, si dhe dërgoni një kopje te Ministria e Arsimit, në adresën: Ohio Department of Education, Office for Exceptional Children, Procedural Safeguards, 25 South Front Street, Columbus, Ohio 43215-4183 ose dërgoni një kopje me faks te (614) 728-1097. **Shënim:** Përdorimi i këtij formulari nuk është i detyruar. Në vend që të përdorni këtë formular, mund të paraqisni një kërkesë tuajën të procesit të rregullt ligjor, por kërkesa juaj duhet të përfshijë të gjithë informacionin e kërkuar nga rregulli federal 34 C.F.R. § 300.508. **Shihni faqen një për udhëzime.**

TËRHEQJA

**Formular i tërheqjes nga procesi i rregullt ligjor dhe/ose ankesa
Duhet plotësuar vetëm për tërheqjen nga ankesa dhe/ose procesi i rregullt ligjor**

NUMRI I ÇËSHTJES: _____

TËRHEQJE NGA ANKESA

TËRHEQJE NGA PROCESI I RREGULLT LIGJOR

Kjo konfirmon se ndërmjetësimi ose marrëveshja midis _____
dhe _____, që këtu e tutje do të quhen "palët",
rezultoi në marrëveshje të përbashkët midis palëve. Si rezultat i kësaj marrëveshjeje,
_____ në këtë mënyrë tërheq ankesën
kundër _____
që u paraqit më _____.

Nënshkrimi i prindit: _____ Data: _____

Nënshkrimi i përfaqësuesit të distriktit: _____ Data: _____

Nënshkrimi i dëshmitarit: _____ Data: _____

Lutemi postojeni dhe/ose dërgojeni me faks tek:

Ohio Department of Education
Office for Exceptional Children
Mediation Coordinator
25 South Front Street, Mail Stop 202
Columbus, OH 43231-4183
Telefoni: (614) 752-1679
Faksi: (614) 728-1097

Hyn në fuqi më 1 korrik 2008

July 1, 2008

Faqja 1 nga 1

Ekujt është kjo IDEA? Udhëzues për prindërit në lidhje me ligjin e vitit 2004 mbi përmirësimin e edukimit për individët me paaftësi